

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje Europiane dhe të sigurisë - 15

ÇËSHITJE EUROPIANE
DHE TË SIGURISË

*EUROPEAN
AND SECURITY AFFAIRS*

Revistë e përtremuajshme

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BORDI BOTUES:**Kryetar:**

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Anëtarë të Bordit, Rrjeti i Menaxhimit të Sigurisë:

Arian Dyrmishi, MA

Agron Sojati, MA

Gjergji Vurmo, MA

Mariola Qesaraku, MA

Besnik Baka, MA

Elona Dhëmbo, Kandidate për Dr

Edlira Peço, Kandidate për Dr

Besar Likmeta

Genc Kojdheli, MA

Eurona Leka, MA

Geron Kamberi, MA

Konsulentë:

Artan Karini – Kandidat për Dr., Universiteti i Manchester (UK)

Arshi Cela, Dr

Redaktor përgjegjës:

Mariola Qesaraku – MA

Ndihmuan në përgatitje:

Besiana Kuçi

Egest Gjokutaj

Marsida Bandilli

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** në Bruksel dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI

PËRMBAJTJA

Koncepti i ri strategjik i NATO-s: Një këndvështrim nga Ballkani Perëndimor	7
Jean Jacques De Dardiel Për ku po shkon partneriteti Euro-Atlantik? Partneriteti dhe koncepti i ri strategjik i NATO-s	17
Thomas Renard & Sven Biscop Nevoja për strategji në një botë multipolare: Rekomandimet për BE-në pas Lisbonës	42
Florence Gaub Nato: Paqeruajtja në tokën e shenjtë? Nje studim fizibiliteti	52
Trine Flockhart Nato dhe (ri) përcaktimi i roleve: “Vetvetja”, “Ne” dhe “Tjetri”. ..	69
Can buharalý, Edam Marrëdhënie më të mira NATO-BE kërkojnë më tepër sinqeritet	98
Daniel Korski, Daniel Serwer dhe Megan Chabalowski Një axhendë e re e bashkëpunimit SHBA-BE për sigurinë ..	107
Summary	129

KONCEPTI I RI STRATEGJIK I NATO-S: NJË KËNDVËSHTRIM NGA BALLKANI PERËNDIMOR

Raport mbi gjetjet kryesore të Sondazhit rajonal të IDN
në vendet e Ballkanit Perëndimor

Mirënjohje

IDN dëshiron të shprehë mirënjohjen e saj dhe të përgëzojë partnerët e saj rajonalë – Qendrën për Studime të Sigurisë (Sarajevë), Analytica (Shkup), Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (Prishtinë), CEDEM (Podgoricë), Këshillin Atlantik të Kroacisë (Zagreb) dhe Këshillin Atlantik të Serbisë (Beograd) – që kanë kryer sondazhet në vendet e tyre përkatëse duke treguar një nivel të lartë përkushtimi dhe profesionalizimi. Gjithashtu, falënderime të veçanta shkojnë për Divizionin e Diplomacisë Publike të NATO-s që mbështeti këtë përpjekje, që synon të ofrojë material jo vetëm për pjesëmarrësit në konferencën rajonale në Tiranë (11 – 12 Mars 2010), por gjithashtu për debatin e përgjithshëm mbi Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s.

Në kuadër të Konferencës Rajonale mbi “**KONCEPTIN E RI STRATEGJIK TË NATO-s. Një këndvështrim nga Ballkani Perëndimor**”, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) në bashkëpunim me partnerët e tij rajonalë në Ballkanin Perëndimor - (Qendra për Studime të Sigurisë (Sarajevë), Analytica (Shkup), Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (Prishtinë), CEDEM (Podgoricë), Këshilli Atlantik i Kroacisë (Zagreb) dhe Këshilli Atlantik i Serbisë (Beograd)- zhvilloi një seri mini-sondazhesh me përafërsisht 233 të anketuar. Kampioni i studimit përfshin përfaqësues të lartë të medias, akademikë dhe

përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të strukturave vendimmarrëse dhe politikë-bërëse, sektorin e biznesit, ekspertë qeveritarë dhe të pavarur, të cilët kanë njohuri të gjera ose janë të përfshirë në debatin publik dhe atë të specializuar mbi sfidat e transformimit të NATO-s dhe Konceptin e Ri të Sigurisë.

Sondazhi u realizua në shtatë vendet gjatë periudhës Janar – Shkurt 2010 me mesatarisht 30 – 40 të anketuar në secilin vend. Duke pasur parasysh përbërjen e kampionit të studimit të përzgjedhur, të dhënat e sondazhit mund të interpretohen si tregues vetëm përsa i përket grupeve të opinionistëve, shoqërisë civile dhe akademikëve, politikë bërësve dhe vendimmarrësve.

Gjetjet kryesore

Të anketuarit mbështesin gjerësisht nevojën për t'iu përshtatur ndryshimeve të dinamikave dhe zhvillimeve globale (81.55%) në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) për sa i përket detyrave thelbësore aktuale të NATO-s. Ndërsa përafërsisht 11.2% e të pyeturve mendojnë se Aleanca duhet të përqendrohet te detyrat aktuale. (Shih Figurën 1.)




Figura 1. Detyrat kryesore aktuale të NATO-s

Shumica e elitave përfaqësuese të vendeve të BP e perceptojnë NATO-n si një institucion të rëndësishëm për shkak se ajo garanton sigurinë në hapësirën Euro-Atlantike (66.09%) ose sepse përbën një forum efektiv për dialogun Trans-Atlantik (17.6%). Vetëm 7.3% e të anketuarve e sheh NATO-n si një mekanizëm për të luftuar terrorizmin. (Shih Figurën 2)




Figura 2. Pse e konsideroni ju NATO-n një institucion të rëndësishëm?

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e dialogut Trans-Atlantik, të anketuarit u pyetën gjithashtu për të vënë në dukje organizatën që i shërben më mirë këtij qëllimi. Ashtu siç tregohet në Figurën 3, NATO merr vendin e parë me 58% të anketuarve,




Figura 3.

me një distancë dukshëm më të lartë në përqindje krahasuar me organizatën e dytë – (21%). Pavarësisht anëtarësimit global, OKB shihet si “garantuesi” i fundit në këtë kontekst (7%).

Pyetje: Cila nga organizatat e mëposhtme siguron konsultime dhe dialog më të mirë transatlantik?

Shih figurën 3.

E njëjta renditje vërehet për organizatat e mësipërme edhe kur të anketuarit pyeten nëse: “*Sipas opinionit tuaj, cila nga organizatat e mëposhtme garanton më shumë sigurinë dhe stabilitetin rajonal në Ballkanin Perëndimor?*”. Pra, 66.09% e të anketuarve zgjedhin NATO-n, ndjekur nga 26.61% e atyre që besojnë se BE po shfaqet më mirë në këtë kontekst, ndërkohë në vendet e fundit janë OSBE dhe OKB me përkatësisht 3.86% dhe 0.86%.

Përsa u përket planeve të zgjerimit të Aleancës në Ballkanin Perëndimor, duket se të anketuarit përgjithësisht nuk kanë frikë se transformimi i NATO-s dhe sfidat që lidhen me Konceptin e Ri Strategjik mund të ulin ndjeshëm vëmendjen ndaj rajonit.

Pyetje: Mendoni ju se sfidat që kanë lidhje me transformimin e NATO-s dhe Konceptin e Ri Strategjik do të ulin ndjeshëm vëmendjen ndaj zgjerimit të mëtejshëm të NATO-s duke përfshirë Ballkanin Perëndimor?

Ashtu siç tregohet në Figurën 4, pothuajse 51.5% e të pyeturve nuk përgjigjen për këtë pyetje, ndërsa rreth 43% deklarojnë “Po” ose “Deri diku”.

A do të ndikojnë sfidat që lidhen me transformimin e NATO-s në zgjerimet e mëtejshme (përfshirë BP)?




Figura 4. Ndikimi i transformimit të NATO-s dhe Koncepti i Ri Strategjik në zgjerimet e mëtejshme

Grafiku i mëposhtëm (Shih figurën 5) tregon se të anketuarit mendojnë ndryshe kur pyeten lidhur me zgjedhjen që duhet të bëjë NATO, në lidhje me pozicionin e fortë të Rusisë në politikën e NATO kundrejt vendeve Lindore dhe për kërcënimet aktuale të sigurisë energjike. Një numër i konsiderueshëm i tyre nuk kanë mendim në lidhje me këtë çështje (23.18%), ndërsa për ata që shprehen, përgjigja mbizotëruese është që Aleanca duhet të fokusohet në çështjet dhe tendencat Euro-Atlantike.




Figura 5.

Të anketuarit gjithashtu u pyetën për të zgjedhur “një nga prioritetet më të rëndësishme” të NATO-s midis katër pohimeve. Edhe mbi këtë temë duket se ata janë të pavendosur se cilat mund të jenë pasojat e mungesës së debatit të informuar dhe njohjes me çështjet dhe sfidat aktuale të NATO-s. Shumica e të anketuarve (41%) i japin rëndësinë më të madhe si një prioritet “Mbrotjtjes kolektive dhe sigurisë së anëtarëve”, ndërsa më pak mbështetës ka prioriteti i “Zhvillimit të një përqasje të qartë politike drejt fqinjëve të saj Lindorë (Rusia)” me 12% të përgjigjeve totale. (Shih Figurën 6).

Në ndryshim nga pyetjet e mëparshme, të anketuarit duket se janë të qartë dhe të sigurt kur pyeten për zonat ku NATO duhet të vazhdojë të fokusohet. Kështu, sipas Figurës 7, mbizotëron opinionin se Aleanca duhet t’i konsiderojë të dyja, si operacionet ushtarake ashtu edhe menaxhimin e krizave. Tek ata që kanë bërë një “zgjedhje të vetme” është interesante të shohësh që ka më shumë të anketuar (19.7%), të cilët e shohin




Figura 6.

NATO-n të fokusuar në menaxhimin e krizave sesa ata që e shohin atë “të fokusuar vetëm në operacionet ushtarake” (16.7%). (Shih figurën 7)




Figura 7.

Imazhi relativisht pozitiv për NATO-n dhe BE-në konfirmohet nga të anketuarit edhe kur ata pyeten për kapacitetin dhe besueshmërinë e këtyre organizatave për të ndihmuar në ndërtimin demokratik dhe ekonomik. Gjithnjë e më shumë, përgjigjet e të anketuarve tregojnë të njëjtën renditje të organizatave si në Figurën 3 më lart.

Pyetje: Ju lutem, vlerësoni në një shkallë nga 1 (shumë efektive) në shkallën 5 (tërësisht joefektive), kapacitetet operacionale dhe besueshmërinë e organizatave të mëposhtme, për të adresuar sfidat e ndërtimit demokratik dhe ekonomik në shtetet e pazhvilluara? (Shih figurën 8).

Kapacitetet & kredibiliteti për të adresuar sfidat e rindërtimit demokratik & ekonomik shtete të dështuara. -Shqipëria-




Figura 8. Kapacitetet dhe Besueshmëria e Organizatave Ndërkombëtare për të ndihmuar shtetet e pazhvilluara

Ndryshe nga rasti i ndikimit të transformimit të NATO-s në politikën e zgjerimit të mëtejshëm (Shih Figurën 4, lart), shumica e të anketuarve shqetësohen se një vëmendje më e madhe në çështjet dhe kërcënimet globale do të ulë vëmendjen në çështje të rëndësishme të sigurisë në rajonin trans-atlantik.

Pyetje: Mendoni ju se rritja e fokusit të NATO-s në çështjet dhe kërcënimet globale do të ulë vëmendjen në çështje të rëndësishme të sigurisë në rajonin transatlantik?

Pothuajse 53% e të anketuarve konfirmojnë këtë pohim me një përgjigje “Po” (12.02%) dhe “Deri diku” (41.63%). (Shih figurën 9.)

Rritja e fokusit të NATO-s në çështjet & kërcënimet globale do të ulë vëmendjen në çështje të rëndësishme të sigurisë në rajonin transatlantik?




Figura 9.

Shumica dërmuese e të anketuarve – përafërsisht 92% - besojnë se ekziston hapësira për më tepër dialog dhe konsultim thelbësor midis dy organizatave më të vlerësuara – NATO dhe BE – në luftën kundër kërcënimeve globale të sigurisë. Midis të anketuarve të këtij “grupi”, 68% besojnë plotësisht në këtë pohim ndërsa 24% përgjigjen “Deri diku”. (Shih Figurën 10).




Figura 10.

Në po të njëjtin kontekst, të anketuarit janë pyetur edhe mbi ndikimin e mundshëm të anëtarësimit global në Aleancë, që mund të reflektojë në statusin dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare si OKB. Siç tregohet në Figurën 11, i vetmi qëndrim i përbashkët mes të anketuarve është se ata kanë tendencën që të mos pajtohen, me shumicën e përgjigjeve, duke ndryshuar nga “JO” (38.2%) dhe “Deri diku” (36.48%). (Shih Figurën 11).

Do të ulë anëtarësia globale në NATO rolin e organizatave të tjera qeveritare si (OKB)?




Figura 11.

Mbështetja publike ndaj misioneve dhe operacioneve të NATO-s në nivel global përfaqëson një tjetër temë kryesore, në të cilën janë pyetur të anketuarit në vendet e BP. Përgjithësisht, ka një përqindje të lartë të anketuarish (73.39%) që pohojnë se vendet e tyre duhet të kontribuojnë (me trupa, pajisje ushtarake & infrastrukturë ushtarake etj.) në operacionet dhe misionet globale të NATO-s, kundrejt vetëm 18.03% që kundërshtojnë dhe 8.58% që nuk kanë asnjë mendim mbi këtë çështje.

Gjithashtu, më shumë se 80% e të anketuarve nga vendet e BP e konsiderojnë si të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm suksesin e misionit të NATO-s në Afganistan. (Shih Figurën 12).

E konsideroni suksesin e NATO's ne Afganistan si...




Figura. 12

Për më tepër, kjo shumicë e të anketuarve që janë deri diku është dakord në lidhje me rolin e Aleancës në Afganistan, nuk shprehen qartë kur pyeten në sondazh për strategjinë e ardhshme të NATO-s në këtë vend. Më saktë, e tregon Figura 13 për ata që janë të paqartë mbi këtë çështje dhe, ndoshta, e vetmja çështje në të cilën më tepër së gjysma e tyre është dakord është që NATO duhet të vazhdojë përfshirjen e saj në Afganistan, për më tepër “Duke dërguar më shumë trupa” (40.34%) ose duke “Mos ndryshuar fare strategjinë e saj” (18.45%). (Shih Figurën 13 më poshtë).




Figura 13. Përfshirja e NATO-s në Afganistan

Jean Jacques de Dardiel

PËR KU PO SHKON PARTNERITETI EURO-ATLANTIK? PARTNERITETI DHE KONCEPTI I RI STRATEGJIK I NATO-S

Në korrik të vitit 2009, NATO filloi një proces i cili duhej të çonte në implementimin e një Koncepti të ri Strategjik. Gjatë përcaktimit të kuadrit referues të saj për të ardhmen, Aleanca pa dyshim që do të fokusohet tek tendencat aktuale, si për shembull globalizimi gjithnjë e më i shpejtë i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zgjerimi i spektrit të krizave. Gjatë marrjes parasysh të këtyre zhvillimeve, do të ishte mirë që të rriteshin përpjekjet për shtimin e fleksibilitetit dhe pragmatizmit, në vend që të përqij të përcaktohej një kuadër i ngushtë veprimi, i cili do të vjetërohej shpejt duke qenë se ngjarjet e paparashikuara kërkojnë ndryshime të vazhdueshme. Aleanca duhet të hartojë plotësisht përqasjen e saj të plotë, në mënyrë që ajo të ndërveprojë në koherencë me organizatat ndërkombëtare, shtetet partnere dhe shoqërinë civile. Vetëm kështu ajo do të mund të grumbullojë mbështetje të gjerë për operacionet e saj dhe do të arrijë të vendosë parakushtet për strategjitë e duhura dalëse. Duke u përpjekur të bëjë këtë, NATO mund të ndërtohet bazuar mbi asetet e zhvilluara në kuadër të Partneritetit për Paqe dhe kuadrit të tij institucional dhe politik, Këshillit të Partneritetit Euro Atlantik (KPEA). Pra, shtetet anëtare të KPEA-së mund të kontribuojnë me një sërë mënyrash për të siguruar paqen, sigurinë, dhe ri-ndërtimin e pas-konfliktit, dobishmëria e të cilave (që nuk duhet të vlerësohet vetëm në terma të aseteve ushtarake), duhet të rritet duke qenë se sfidat e sigurisë ndërkombëtare po marrin forma gjithnjë e më të ndryshme. Prandaj, NATO nuk duhet të shkrijë kuadrin e KPEA/PpP-së, i cili ka dhënë prova se është i suksesshëm, duke mbledhur gjithë

vendet e tjera që asociohen, në një mënyrë ose një tjetër, me punët dhe operacionet e NATO-s në një Forum të Ri Partneriteti me përbërje të shumëllojshme. Në vend të kësaj, NATO duhet të diferencojë llojet e ndryshme të partnerëve, duke u fokusuar gjithnjë e më shumë tek vlera e shtuar dhe tek mundësitë e nënvleftësuar të partneritetit. Pra, në qendër të ambicieve të NATO-s duhet të jetë partneriteti, dhe nuk duhet të shihet vetëm si një shfaqje e lodhshme dhe e mjegullt.

Drejt një Koncepti të Ri Strategjik

*“Njëzet vjet më parë, një valë historike ndryshimesh demokratike përfshiu Evropën Qëndrore dhe Lindore. NATO e përdori këtë mundësi për të angazhuar vendet përtej hapësirës Euro-Atlantike në partneritet dhe bashkëpunim duke synuar që të forconte sigurinë, stabilitetin dhe transformimin demokratik. Ne theksojmë përkushtimin tonë për të zhvilluar më tej Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA) dhe Partneritetin për Paqe (PpP) si kuadri esencial për zhvillimin e dialogut të pavarur politik dhe bashkëpunimit praktik, duke përfshirë intensifikimin e ndërveprimit ushtarak. (...) Ne falenderojmë partnerët tanë për kontributet domethënëse që kanë dhënë në operacionet tona. Ne do të vazhdojmë të zhvillojmë iniciativat politike të KPEA-së”.*¹

Duke iu referuar një kënge të papërsëritshme të Beatles-ve, fati i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut duket të jetë “Nën Joshjen e Numrit Nëntë” (Under the Spell of Number Nine): 1949, 1989, 1999, 2009... janë të gjitha vitet kur rruga e Aleancës ka marrë një kthesë kryesore, kur ajo u konceptua, kur qëndroi triumfuese por mesa duket pa kuptim, kur iu dha më vonë një drejtim i ri strategjik dhe që po ri-orientohet tashmë për t’u përballur me një botë të re e në ndryshim...

Është e qartë se viti 2009 nuk shënon në vetvete një ndryshim kryesor në udhën e Aleancës. Megjithatë, përtej simbolizmit të Samitit të 60 vjetorit të saj, mbajtur në prill në Francë e Gjermani, ky takim i krerëve të shteteve shënoi hedhjen e një ri-vlerësimi të strategjisë dhe vetë-përcaktimit të NATO-s. Pra, samiti, ndërpreu në mes një sërë nyjesh gordiane alternativash dhe vendosi mbi domosdoshmërinë e një Koncepti të Ri Strategjik, i cili do të hartohet nën mbikqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm të sapoemëruar. Ndërsa, deri atëherë, kishte patur thirrje prej

¹ Deklarata e Samitit të Strasburg/Kehl-it, § 36, 4 Prill 2009.

shumë anëtarëve për një rishikim thelbësor të kuadrit referues strategjik të NATO-s, shumë të tjerë kishin hedhur poshtë kërkimin e një doktrine tërësisht të re dhe, si rrjedhojë, ky kërkim ishte shtyrë për shkak të kundërshtive që ekzistonin mbi efektet e mundshme negative të mungesës së një vizioni të përbashkët të objektivave dhe qëllimit të Aleancës.

Menjëherë pas Samitit të Strasburg/Kehl-it, fillimi i një procesi intelektual – në kontrast me negociimet politike – që duhet të çonte drejt një Koncepti të Ri Strategjik për Aleancën, u prezantua në Bruksel në 7 korrik të vitit 2009 në një konferencë të madhe, dhe e hapur dhe e drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm që po largohej Jaap de Hoop Scheffer. Kjo ishte mbyllja e duhur e mandatit nga një figurë kryesore, që kishte bërë thirrje për një azhornim të tillë për më shumë se tre vjet. Kjo mënyrë linçimi, duke qenë një shfaqje e madhe transparence, tregoi që në fillimet e saj se pritshmëritë ishin të larta, por shpesh edhe kontradiktore. Palët e jashtme kishin axhenda të ndryshme, të brendshmit kishin shqetësime specifike, dhe analistët dhe nëpunësit civilë prireshin që t'i shihnin problemet dhe sfidat, në rastin më të mirë, nga kënde të ndryshme stimuluese. Por, ndërsa disa prej këtyre aktorëve të jashtëm mund të mos jenë familjarizuar mjaftueshëm me përsiatjen për një organizim politiko-ushtarak të pozitës së NATO-s, vetë Aleanca ka terren të ri të mjaftueshëm për të ecur, duke mos injoruar që prej fillimit të gjitha pikëpamjet që vijnë nga elementë të ndryshëm të shoqërisë civile, të cilat mund të çojnë në shumë raste në propozime konstruktive .

Shfaqja e interesit të NATO-s për pikëpamjet e jashtme nuk duhet keqinterpretuar si një formë shpërbërjeje, pavlefshmërie konceptuale dhe mungese qëllimi ndërmjet Aleatëve. Pavarësisht se sa të interesuar janë në idetë e reja ose jo-konvencionale, shumica e aktorëve të brendshëm janë dakord mbi pikat kryesore që duhet të adresohen në Konceptin e Ri Strategjik.² Kjo është e vërtetë, sidomos përse i përket domosdoshmërisë së ri-përkufizimit të kuptimit dhe qëllimit të Nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, i cili thekson se:

“Palët bien dakord se një sulm i armatosur drejtuar kundër njërit ose më shumë prej tyre, në Evropë ose në Amerikën e

² Për një diskutim mbi temat ku duhet të fokusohet Koncepti Strategjik shiko për shembull: Klaus Wittman “Towards a New Strategic Concept for NATO.” NATO Defense College, NDC Forum, Paper no 10, Shtator 2009 si edhe Zibgniew Brzezinski “What Next for NATO?.” in Foreign Affairs, Shtator/Tetor 2009 fq.3.

Veriut, do të konsiderohet si sulm kundër të gjithëve, dhe si rrjedhojë ata bien dakord se në rast se ndodh një sulm i tillë secili prej tyre (...) do të ndihmojë Palën ose Palët e sulmuara nëpërmjet ndërmarrjes së menjëhershme të iniciativave individuale dhe në sinkronizim me Palët e tjera, veprimin që ajo e quan të nevojshëm, duke përfshirë përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur dhe ruajtur sigurinë në Zonën e Atlantikut të Veriut.³⁷

Duke patur parasysh shumëllojshmërinë e rreziqeve, sfidave të reja dhe metodave të reja të agresionit, shumica prej të cilave mund të mos jenë “të armatosura”, në kuptimin tradicional të fjalës, si dhe mundësitë në rritje për sulme të gjera kundër interesit kombëtar që burojnë nga jashtë territorit të shtetit të sulmuar, mendimet e reja që mund të vijnë lidhur me nxitjen e solidaritetit të Aleancës do të kishin rëndësi parësore. Anëtarët e NATO-s padyshim do t’i kushtojnë më shumë vëmendje çështjeve të tilla të pa-evitueshme dhe thelbësore si ri-organizimi i mjeteve dhe metodave të punës si përgjigje ndaj operacioneve në vazhdim në Afganistan dhe nevojës për ri-orientimin e tyre, cilësisë dhe drejtimit të marrëdhënieve NATO-Rusi, mënyrës së trajtimit të rreziqeve aktuale bërthamore, kuptimit dhe praktikimit të një përmbajtjeje praktike; po ashtu edhe çështjeve praktike si pyetjet e pazgjidhura që i përkasin marrëdhënieve NATO-BE, për të theksuar vetëm disa çështje kryesore. E gjitha kjo duhet formuluar në një koncept strategjik, mundësisht më të shkurtër dhe më të fokusuar, sesa ai i vitit 1999.

Pjesa kryesore e punës konceptuale hapëse i është besuar dymbëdhjetë burrave dhe grave të mençur, të udhëhequr prej ish Sekretares Amerikane të Shtetit, Medlin Ollbrajt (Madeleine Allbright), i cili do të ndërmarrë seanca dëgjimore dhe konsultime dhe do t’i raportojë rezultatet e tyre tek Sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. Ai do të vlerësojë raportin e grupit dhe më pas do t’ia dërgojë kryetarëve të shteteve që do të miratojnë Konceptin e Ri Strategjik. Në fund, NATO-s do t’i duhet të përshtasë imputet, të mbështetet në idetë e një sërë analistëve dhe kuadrove me eksperiencë, të bëjë përputhjen realiste të ambicieve me burimet në dispozicion, të mbetet e

³ Fjalët dhe frazat e nënvizuara tregojnë elementët e nenit 5, të cilat mund të kenë nevojë për rishikim duke qenë se konteksti ka ndryshuar rrënjësisht. Aq sa në pamje të parë duket se ato lënë hapur dyert për të gjitha opsionet, duke përfshirë veprimin ushtarak, sot ato mund të interpretohen si koncepte që kanë një nivel jo të duhur kufizimesh dhe që lejojnë përdorimin e klauzolave përjashtuese të panevojshme.

fokusuar dhe të forcojë lidhjen e saj në fushën e saj specifike të sigurisë së lartë, duke qenë organizata kryesore dhe e pazëvendësueshme që përbën shtyllën e sigurisë së përbashkët Euro Atlantike.

Por ky propozim i thjeshtë, duke qenë se dëshiron që ta mbajë NATO-n plotësisht të lidhur me shtetet e saj anëtare, mbart një kuptim të ri në vetvete. Ai mbështet prirjen që në botën e sotme të globalizuar, një organizatë me ndikimin dhe fushën e veprimit si të NATO-s, nuk mund të vlerësohet më vetëm në terma tërësisht të mbrojtjes kolektive. Rruga e ardhme për Aleancën duhet përcaktuar nga kërkesa për siguri të përbashkët dhe jo vetëm nga mbrojtja kolektive, duke pasur parasysh gjerësinë e shumëllojshmërisë së sfidave që janë shfaqur që prej shpërbërjes së Traktatit të Varshavës, me agimin e hiper terrorizmit⁴ në 11 shtator të vitit 2001, dhe më gjerësisht me shumëfishimin dhe përforcimin e sfidave nëpër etapat e globalizimit.

Është e vërtetë që rivalitetet tradicionale gjeopolitike që kanë "helmuar" shekujt e fundit kanë ende peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Konfliktet lokale ose rajonale për territorin dhe kufijtë kërcënojnë ende që të shpërthejnë në të gjithë kontinentet, nga Amerika Latine në Azi dhe nga Evropa Lindore në Afrikë. Megjithatë, duke pasur parasysh ndërveprimin në rritje të të gjitha ekonomive dhe shoqërive me njëra-tjetrën, të zgjeruar edhe më tej nga ndërthurja e të gjitha aspekteve të spektrit të plotë të marrëdhënieve ndërkombëtare, efekti flutur i secilës krizë është i tillë që sfidat e sigurisë të disave, janë më pas shqetësimi i të gjithëve. Kështu, siguria aktuale, është një koncept i plotë: ajo përfshin dimensione jo vetëm ushtarake, por edhe humane dhe ekonomike si edhe presupozon një sjellje relativisht të përgjegjshme nga secili aktor, në secilën prej këtyre tre fushave.⁵

Pikërisht, duke kuptuar ndërveprimin e dimensioneve të ndryshme të fuqisë, administrata Obama ka zgjedhur të rifokusojë politikën e jashtme amerikane drejt përfundimit të fuqisë së mençur, e cilësuar nga disa prej përkrahësve të saj si p.sh Joseph Nye, i cili pohon se:

"Fuqia sot shpërndahet ndërmjet vendeve në një mënyrë që i përngjan një loje shahu tre-dimensionale e komplekse. Në fushën e parë (që përfaqëson kontekstin e parë në të cilin mund

⁴ Duke përdorur termin që u krijua nga media pas sulmeve të 11 shtatorit dhe që u kthye për përdorim të vazhdueshëm prej François Heisbourg në: "Hyperterrorisme: La Nouvelle Guerre", Odile Jacob, 2001.

⁵ Eastwest Institute, "Euro Atlantic Security: One vision, three paths", Brussels. Moscow, New York, Qershor 2009, fq.3.

të analizohen burimet e fuqisë), fuqia ushtarake është kryesisht një polare. Por në fushën e mesit, fuqia ekonomike ndërmjet shteteve është pothuajse multipolare... Fusha e fundit është sfera e marrëdhënieve ndërkombëtare, që përfshin aktorë që i kalojnë kufijtë e kontrollit të qeverisë... Kjo i shton një dimension të ri çështjeve të sigurisë dhe rrezikut, dhe përfshin çështje për të cilat instrumentet ushtarake që dominojnë fushën e parë janë qartësisht të pamjaftueshme. Në fushën e fundit, fuqia shpërndahet gjerësisht, dhe prandaj ka kuptim të flitet për një polaritet, multipolaritet ose hegjemoni. Pikërisht, prej kësaj fushe të fundit dalin sfidat më të rëndësishme të sigurisë.⁶

Sidoqoftë, këto sfida të fushës së fundit, por tërësisht mbizotëruese, janë larg të qenit të kontrollueshme. Në fakt, ato janë të pa-parashikueshme, duke qenë se kanë tendencë që të kenë një mëvetësi e cila varet nga rrethanat lokale, dhe ndonjëherë personale. Kjo nuk do të thotë se këto vatra tensioni mbikëqyren vazhdimisht, dhe se nuk mund të parashikohet asnjë krizë. Por, në praktikë, proceset vendimarrëse nuk mund të marrin parasysh parashikimet e pa lidhura individuale, të pjesshme ose konfliktuale ndërmjet tyre, dhe eksperiencia tregon se pasi shpërthen plotësisht një krizë, ajo ka tendencë që të zërë në befasi shumicën e aktorëve dhe vëzhguesve të një niveli ose një tjetri.

Në kontrast me këtë panoramë, duket e drejtë që të shtrohet pyetja: A është NATO e aftë të parashikojë të ardhmen më mirë se të tjerët, në angazhimin e saj për të mbajtur dhe garantuar sigurinë e anëtarëve të saj? Nëse përgjigjia është jo, ose më pak se po: përse duhet të lodhemi me hartimin e një koncepti strategjik që prej një viti e gjysëm tashmë⁷, kur dimë se aktualiteti i tij do të zgjasë të shumtën disa vjet, dhe se do të sfidohet me shumë mundësi prej ngjarjesh të papritura? A nuk do të ishte më e dobishme të përqëndroheshim në synimin për të rregulluar problemet e identifikuar tashmë, në vend që të fillonim një proces që mund të na rezultojë shumë më kompleks dhe konsumues i kohës se çdo gjë tjetër? Me fjalë të tjera, si mund ta evitojmë që NATO, edhe pse është e zënë si zakonisht me arbitrimet ushtarake në pasiguritë kombëtare, të përgatisë veten për sfidat që janë të përcaktuara dhe që do të konsideroheshin

⁶ Joseph S. Nye "Recovering American Leadership" in Survival, Shkurt-Mars 2008, fq.58.

⁷ Mesa kuptohet Koncepti i Ri Strategjik presupozohet të prezantohet dhe miratohet në samitin e ardhshëm të NATO-s i planifikuar të zhvillohet në Lisbonë në fund të vitit 2010.

përfundimisht si lufta e së djeshmes, kur urgjencat e papritura të dalin edhe nëse ajo përpiqet të rregullojë perceptimin për të ardhmen? A nuk do të ishte më mirë për Aleancën që të përqendrohej në mënyrë më modeste në përshtatjen e kapaciteteve fleksibël dhe të metodave të punës me përshtatshmëri të lartë, në mënyrë që të ishte e aftë që t'i përgjigjej të gjitha llojeve të krizave?

Lufta e së djeshmes

Kur shikohet e ardhmja për t'u përgatitur për pasiguritë, këshillohet gjithmonë që të vështrohet mbrapa dhe të konsiderohen zhvillimet e fundit. Por çfarë shikojmë, nëse vlerësojmë në mënyrë kritike të shkuarën e NATO-s? Një përshtatje deri diku i pa-sjellshëm i historisë së Aleancës së Atlantikut të Veriut do të nënvijëzonte se NATO asnjëherë nuk arriti të përfundonte atë për të cilën ishte e përgatitur të bënte, por edhe që ajo ishte e detyruar të vepronte në një mënyrë të papritur. Në fakt, ajo u përgatit gjatë për Luftën e Tretë Botërore, por kurrë nuk qëlloi një gjuajtje të vetme kundër armikut të identifikuar që mbante nën shënjestër. Kur ajo zbrazti armët e saj për herë të parë në Ballkan, ajo veproi në një gjendje relative të papërgatitshmërisë ligjore, kundër një armiku që ajo nuk e kishte konsideruar deri atëherë si një armik. Sa herë që veproi, kjo ndodhi jashtë qëllimit territorial që ajo i kishte vënë si objektiv parësor vetvetes. Kur Aleanca u rrit gjatë studeve të saj të mëvonshme, kjo ndodhi kryesisht përmes përfshirjes së armiqve të djeshëm, për të cilët ajo nuk kishte menduar kurrë që do t'i mirëpriste në mesin e saj. Megjithatë ajo u përgatit gjithmonë për të luftuar kundër një armiku të fortë, ajo po vrapon aktualisht kundër Talebanëve të pakapshëm, duke marrë disa ndihma dytësore prej armikut të saj kryesor të mëparshëm, si dhe po dërgon luftanijet kundër piratëve të vjetër që sulmojnë anijet me shkallë, në të njëjtën mënyrë që veprohej me kështjellat gjatë Mesjetës.

Nga ana tjetër, një këndvështrim më pak ironik, do të theksonte se NATO, ose "aleanca më e suksesshme ushtarake në histori", siç iu pëlqen ta quajnë avokatët e saj, doli më e fortë nga Samiti i 60 vjetorit të saj, me një lidhje trans-Atlantike të ri-aktivizuar, me perspektiva më të mira përplotësuese ndërmjet NATO-s dhe BE-së, si dhe me një analizë të përbashkët të situatës dhe strategjinë bazë që do të aplikohet në Afganistan, duke pritur vendimet e mëtejshme të Presidentit Obama për ri-orientimin e

konfliktit dhe për mënyrat e përfundimit të fazës së tij të hapur ushtarake. Për më tepër, siç i pëlqente të thoshte dhe ish Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer: "Shumë prej aspekteve të Konceptit Strategjik të vitit 1999 duket se janë ende të dobishme dhe të zbatueshme sot, çka do të thotë se në një kuadër të caktuar dhe në të gjitha ndryshimet e kontekstit strategjik, të menduarit themelor dhe të bazuar në eksperiencë çon në rezultate solide."

Pra, duke pasur parasysh mësimet kundërshtuese të së kaluarës, cila janë perspektivat e një NATO-je të rinovuar, e cila do të bëjë përdorimin më të mirë të ushtrimit të Konceptit të ri Strategjik? Gjatë tentativës për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, së pari do të ishte me vend që të identifikoheshin disa prej sfidave të sigurisë që shtrihen përpara nesh.

Sfida të mundshme

Çdo vëzhgues mund të identifikojë, nga pikëpamja gjeografike, zonat aktuale problematike dhe situatat e paqëndrueshme që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi NATO-n. Beteja civile dhe ushtarake që vazhdon në Afganistan, mund të mundësojë një tërheqje të forcave të huaja nga vendi në të ardhmen. Por atje mund të devijojë situata në mënyra të cilat do të kenë me siguri ndikim mbi NATO-n dhe sistemin e sigurisë në tërësi. Pakistani, një vend fqinj me Afganistanin, dhe i lidhur pashmangshmërisht me të, është sot një nga vendet më të paqëndrueshme dhe përbën një pol shqetësues vëmendjeje në zonat tribale të cilat, më e pakta, përzihen me ambientin ku vepron Misioni Ndërkombëtar i Ndihmës për Sigurinë i drejtuar nga NATO (ISAF). Ndoshta, Gjeorgjia e kaloi luftën e saj me Rusinë. Por, duke patur parasysh synimet e saj të palëkundura për të hyrë në NATO dhe sigurinë që ajo ka marrë në lidhje me këtë, një ulje e dukshme e tensioneve nuk do të mund të arrihej brenda një kohë të shkurtër. Në terma më të përgjithshme, Kaukazi Verior dhe Jugor, siç tregon edhe çdo hartë historike ose etnike e këtij djepi të hershëm të civilizimit, do të përbëjë për një kohë të gjatë mundësi potenciale për episode konfliktuale, të cilat do të futin në lojë, në një mënyrë ose në një tjetër, edhe Aleancën.

Teherani do të konsiderohej si një faktor i paparashikueshëm për të ardhmen, duke patur parasysh rrezikun e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe paqëndrueshmërinë relative aktuale të tij. Impakti i tij aktual mbi skemat e mbrojtjes raketore, kryesisht për sa i përket vendosjes së planifikuar dhe, së fundmi,

të anuluar të sistemit të Mbrojtjes kundër Raketave Balistike në Poloni dhe në Republikën Çeke, si dhe mbi përmbajtjen e përhapjes bërthamore, peshojnë shumë në sjelljen nukleare dhe në të konceptuarit e mbrojtjes të Aleancës. Më tej, shtetet e dështuara dhe të brishta në kontinentin Afrikan, si Somalia dhe Sudani, do të vazhdojnë të jenë për një kohë të gjatë burime të destabilitetit, që sjellin një sërë efektesh si p.sh migrimin masiv dhe prurjet e migrantëve, të cilat janë shfaqur aty dhe tjetërkund me kalimin e kohës. Dhe, duke qenë se këto territore kontrollojnë disa prej rrugëve kryesore detare, Aleanca nuk do të jetë e nuk do të mund të shmangë përqëndrimin e vëmendjes së saj në zona të tilla.

Pjesë të tjera të Afrikës, që përbëjnë shqetësim kryesor për një sërë aleatësh të NATO-s,⁸ si dhe Lindja e Mesme, sidomos Izraeli dhe disa prej fqinjëve të tij të afërt, do të mbeten gjithashtu zona të nxehta të shpërthimeve të paparashikueshme, me pasoja të zgjatura.⁹

Më rastësisht, asnjë ekuacion modern i sigurisë nuk mund të lërë mënjanë mundësitë për shpërthimin e luftës për energjinë dhe për resurset në shtet. Vëmendja e fundit që po drejtohet nga Veriu i Largët¹⁰, shërben për të rikujtuar se gara për burimet natyrore dhe rrugët e furnizimit është e tillë që mund të gjenerojë tensione të rrezikshme, për shkak të efekteve të dëmshme të

⁸ Nëse disa zona përbëjnë shqetësim për disa shtete anëtare të NATO-s, për shkak të lidhjeve historike, një grup i ri problemesh duhet të përbëjë shqetësim për të gjithë. "Për shembull koltani, (lënda e parë për metalin e rrallë talanium, i cili është kryesor për prodhimin e celularëve dhe kompjuterave portabël) nxirret ilegalisht në Kongon e Veriut dhe kontrabandohet nga milicistë rebelë. Në Nigeri dhe Sierra Leone burime të rralla natyrore kontrollohen prej bandave dhe rebelëve, që do të thotë se këto grupe kanë një impakt potencial global.

Klaus Naumann, John Shalikhvili, Lord Inge, Jaques Lanxade, Henk Van Den Breemen, "Towards a Great Strategy for an Uncertain World. Renewing Trans-Atlantic Partnership.", Noaber Foundation, Lunteren, fq. 49.

⁹Ne po listojmë vetëm tensionet që ndodhen brenda zonës Euro-Atlantike dhe në kufijtë e jashtëm të partneriteteve kryesore të NATO-s. Por zonat e krizave shtrihen edhe në vende të tjera, siç tregohet nga tensionet për kufijtë në Ande, në Amazonë dhe në Amerikën Qendrore, në Azinë Juglindore ose rreth rrajoneve specifike si p.sh në Kashmir ose Korenë e Veriut, për të mos përmendur pastaj Burmën, Xingjian-in, Tibetin ose Tajvanin, dhe zona të ndërkombëtare trazirash që kanë potencial të ndikojnë marrëdhëniet ndërkombëtare.

¹⁰ Shiko për shembull Margaret Blunden "The new problem of Arctic Stability" in Survival, Tetor-Nëntor 2009, fq. 121-141.

ndryshimeve klimatike, duke qenë se harta globale e aksesit është riskuar në përshtatje të avancimeve teknologjike.¹¹ Fundamentalizmat dhe terrorizmi siç e njohim ne, si dhe format e reja të mundshme të sulmeve të terrorit duhet, fatkeqësisht, që të vendosen këtu, qoftë edhe për shkak të mënyrave moderne të komunikimit që janë në dispozicion të demagogjive, të kombinuara me shtrirjen demografike, vendosjen e resurseve dhe pabarazitë pasurore. Edhe pse terrorizmi nuk është aspak një fenomen modern, ai është zhvilluar dhe ndërkombëtarizuar në mënyrë të tillë që qëllimi i tij i veprimit lidhet me të përgjithshmen, edhe kur ai synon të ndikojë vetëm në një situatë lokale. Në një nivel tjetër, mallkimet pandemike të ampifikuara prej udhëtimeve të gjata dhe prej potencialit të tyre shkatërrues, për të mos folur për efektet e dëmshme të krizave ekonomike, të mbivendosura ndaj shqetësimeve kryesore të sigurisë, dhe nuk mund të konsiderohen thjesht si çështje me të cilat duhet të merren vetëm ekspertët e shëndetësisë ose financës, si dhe ata të biznesit.

Së fundmi, nga ana funksionale, mund të fokusohemi tek sfidat e sigurisë që shtrohen si rrjedhojë e sulmeve *cybernetike*, piraterisë (sidomos asaj në det të hapur, por edhe asaj në tokë), tek marrja peng prej kriminelëve dhe tek shtete të prirur për të luajtur me zjarrin, tek krimi dhe trafiku ndërkombëtar, si dhe tek rreziku që vjen prej shteteve të falimentuara, i cili mund të përfshijë të gjitha më sipër.

Por, ndërsa mund të thuhet se janë të njohura tashmë shumë kriza të mundshme dhe raste për t'u shqetësuar, efektet e tyre të plota dhe të paparashikueshme do të vendosin, pjesërisht në vështirësi, edhe më largpamësin. Për më tepër, siç ka ndodhur vazhdimisht edhe në të shkuarën, është pothuasje e sigurt që në të ardhmen do të shfaqen më shumë zona të trazuara. Kriza energjetike që goditi në mënyrë të përsëritur Evropën Lindore mund të jetë përkeqësuar edhe më tej dhe mund të shpërthejë sërish. Sulmi i vetëm *cybernetik* që u lëshua mbi Estoninë në 2007, megjithëse u limitua vetëm në një vend të vogël, përbën një alarm serioz. Të tilla sulme mund të vijnë ngado, pa paralajmërim, siç kanë treguar tashmë një sërë sulmesh më të limituara, drejtuar kompanive të mëdha dhe institucioneve qeveritare nëpër botë. Lufta Gjeorgjiane, në verë të vitit 2008,

¹¹ Lançimi i shpallur së fundmi i një projekti kolosal të shfrytëzimit të energjisë diellore në shkretëtirat e Afrikës së Veriut nga një konsorcium kompanish private, do të ketë me siguri implikime për të gjithë vendet e përfshira në të.

shkaktoi veprime dhe reagime të paparashikuara më parë në terren dhe në zyrat kryesore ushtarake dhe politike, dhe kjo pati një ndikim të madh në kursin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Është e qartë që kriza financiare dhe ekonomike që ne po kalojmë aktualisht, ka përmasa më të mëdha sesa çdo lloj plani emergjence i planifikuar më parë, dhe që mund të merret parasysh. Kjo krizë nuk do të jetë e fundit, duke qenë se ciklet ekonomike kanë një zhvillim të pavarur të tyrin.

Nga ana tjetër, është e sigurt se ndërsa rivalitetet gjeografike luajnë ende një rol të rëndësishëm, sfidat e sigurisë zgjerohen dhe, në disa raste, përshpejtohen nga fenomeni i globalizimit. Me fjalë të tjera, e vetmja gjë që është e parashikueshme është se NATO, ashtu si edhe organizatat dhe qeveritë e tjera, do t'i duhet të përballet me forca dhe ngjarje kontradiktore që ndryshojnë me shpejtësi, për të cilat ajo nuk do të jetë tërësisht e përgatitur. Kjo tendencë është njohur mirë tashmë prej organizatës, ku Projekti i saj i Shumpërdorimeve mbi të Ardhmen, në trajtimin e zhvillimeve të mundshme deri në vitin 2030, thekson se "Ambienti i sigurisë do të vazhdojë të evoluojë dhe të influencohet prej një sërë zhvillimesh të paparashikueshme dhe dinamike politike, sociale, teknologjike dhe ushtarake. Konflikti do të bëhet gjithnjë e më tepër kompleks, i paparashikueshëm dhe më i vështirë për t'u kontrolluar."¹² Për të cituar një tjetër grup autoritetesh të larta të NATO-s:

"Natyra e këtyre sfidave të rrezikshme dhe komplekse nuk mund të trajtohetohet vetëm me mjete ushtarake. Bota perëndimore dhe aleatët e saj duhet të bien dakord për një strategji të re të bashkërenduar, e cila të përfshijë përdorimin e të gjithë instrumenteve të mundshëm, dhe që do të mundësojë përgatitjen e kapaciteteve të saj për këto sfida globale dhe rajonale që mund, po ashtu dhe që nuk mund t'i parashikojmë."¹³

Prandaj mund të argumentohet se interesi më i mirë i NATO-s në lidhje me përgatitjen për të ardhmen, qëndron në një përjasje që duhet të jetë sa më shumë pragmatiste. Duke marrë parasysh faktin se strukturat duhet të ndjekin përbërjen dhe jo e kundërta, ajo çka sugjerohet është, mbi të gjitha, një përshtatshmëri e re e institucioneve të Aleancës me strukturat operative. NATO duhet të sigurohet se mund të jetë mjaftueshëm fleksibël për të vendosur kapacitetet e duhura të të gjitha llojeve

¹² Supreme Allied Commander Transformation "Finding and Recommendations", NATO Multiple Future Projects, Norfolk, Virginia, Prill2009, fq.3.

¹³ Klaus Neuman et al. Op. Cit, fq. 44-45.

në çdo lloj skenari teatral të krizave pasardhëse, qoftë ky skenar gjeografik ose funksional. Gjatë këtij procesi, organizata duhet ta konsiderojë si avantazh zhvillimin e instrumenteve të bashkëpunimit, në kushte optimale me partnerët e saj, në mënyrë që të sigurohet që përzjerja e duhur e kapaciteteve të përfshihet në një grupim sa më të gjerë të mundshëm burimesh civile dhe ushtarake.

Kjo e vërtetë buron edhe nga realitetet operacionale. Me zbehjen e mundësive dhe rreziqeve për konflikte ndërmjet blloqeve, dhe kur procesi i integritit evropian po shtrin efektin e tij stabilizues në pjesë më të gjera të kontinentit Evropian, duket qartë se operacionet e Aleancës janë të kufizuara në ndërmarrjen e formës së aktiviteve të karakterit të ekspeditës, sesa thjesht një parapozicionim të fushave përkatëse dhe forcimin e mbrojtjes. Pra, edhe kur mbrojtja territoriale lokale duket se është bërë e domosdoshme nga rreziqet e perceptuara të krizave të mundshme lokale në zonën tashmë të zgjeruar të Aleancës, një parapërgatitje e mbrojtjes nuk nënkupton një përgjigje fleksibël dhe aktivitete ekspeditash brenda kufijve të Aleancës, një konkluzion ky që është nxjerrë tashmë prej NATO-s gjatë përcaktimit të misioneve për Forcën për Përgjigje të NATO-s (NATO Response Force, NRF).

Megjithatë, të gjitha veprimet zbuluese duhet të mbështeten, që në fillim, në një strategji të përgjithshme koherente, duke përfshirë dhe kalimin në një paqe të qëndrueshme dhe një strategji realiste për daljen, nëse duan të evitojnë të futen në situata të komplikuar dhe të pazgjidhshme. Në këmbim, strategjitë për daljen kërkojnë asete shtesë, mbështetje jo ushtarake dhe faktorë të tjerë, aftësi dhe përjasje të ndryshme. Gjithashtu, ato duhet që të mbështeten tek ndërtimi i shtetit dhe institucioneve, të cilët duhet të synojnë të rilidhin plotësisht zonën që sapo ka kaluar krizën me pjesën tjetër të botës. Në këtë kuptim, asnjë strategji dalëse e përdorur për një zonë konflikti të stabilizuar, mundësisht prej ndërhyrjes së NATO-s, nuk mund të ketë sukses pa përfshirjen në të, të një sërë vendesh dhe organizatash që ndodhen përtej kufijve të vendosur të Aleancës. Pra, ndërveprimi dhe thjeshtësimi i qëllimit të përfshirjes së organizatave të tjera ndërkombëtare dhe të vendeve partnere të rezolutës janë kryesore, nëse konsiderohet zgjatja e sigurisë së përgjithshme, dhe jo vetëm trazirat e rastit.

Përsa i përket organizatave partnere, si BE-ja dhe OKB-ja, një çështje e rëndësishme që duhet zgjidhur në këtë kontekst, është ajo e lidhjes ndërmjet mjeteve ushtarake dhe forcave civile, sigurisë dhe sigurisë njerëzore, forcimit të paqes dhe ndërtimit

të shtetit. Kjo duhet të çojë drejt zhvillimit të një doktrine të bashkëpunimit dhe të ndarjes së përgjegjësive ndërmjet organizatave të ndryshme rajonale dhe botërore, ose thënë në gjuhën e NATO-s, zhvillimin e një “përqasjeje gjithëpërfshirëse”. Me fjalë të tjera, nëse Afganistani kërkon sot një përqasje shumëkahëshe dhe mekanizma fleksibël, e njëjta gjë duhet të ndodhë me krizat e ardhshme, sidomos kur ne nuk mund të dimë më përpara se cilat mund të jenë saktësisht rrotullimet dhe kthesat e tyre.

Mbi rolin e partnerëve

Gjetja e mënyrave më të mira për të bashkëpunuar me organizatat dhe vendet partnere nuk duhet parë as si një shfaqje e dobët dhe as si një detyrë dekurajuese. Strukturat e zhvilluara që nga vitet ‘1990, në kuadër të Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik dhe të Partneritetit për Paqe, përbëjnë asete shumë të vlefshme dhe të mirëvendosura në këtë kontekst. Prandaj, është shumë i çuditshëm fakti që KPEA dhe PpP u shpërfillën për një farë kohe, kur Aleanca po përgatitej për Samitin që shënoi gjashtëdhjetë vjetorin e saj. Pra, gjatë një periudhe të caktuar, edhe pse disa vende partnere mbetën të vendosura për një partneritet aktiv, ato institucione nuk duket se përdoren me të gjithë potencialin e tyre nga shtetet anëtare të NATO-s, të cilat i shpërfillin me vetëdije këto forume. Kjo etapë ngjarjesh doli në pah nga një sërë propozimesh, për të cilat u ra dakord gjatë Samiteve të mëparshme të Rigës dhe Bukureshtit, kur i jepej ende rëndësi e pakundërshtueshme forcimit të Partneritetit Euro-Atlantik.¹⁴ Por, ndërsa këto takime të hershme ritheksuan vlerën e partneritetit, vendet partnere as që u ftuan në Samitin e Strasburg/Kehl-it, me pretekstin e mungesës së hapësirës në punimet e konferencës...

Është e kuptueshme që të argumentohet, se Aleanca ishte e fokusuar në marrëdhënien e saj të vështirë me Rusinë në fundin e krizës Gjeorgjiane, po ashtu edhe për faktin se ajo kuptoi që ishte e nevojshme që të merrej me vështirësitë e politikës së saj të zgjerimit, përtej dyerve të mbyllura, me dykuptimshmërinë e brendshme mbi lidhjet e saj me Bashkimi Evropian si dhe me vështirësinë në rritje në operacionet e saj kryesore në

¹⁴ “Riga Summit Declaration issued by the Heads of State and Government participating in the Meeting of the North Atlantic Council in Riga”, 29 Nëntor 2006.

Afganistan. Për më tepër, mund të thuhet se ngjarjet e Gjeorgjisë kanë theksuar ri-ngjalljen e ndarjes së vjetër *“Lindje-Perëndim”* në të menduarit strategjik. Ato institucione shumëpalëshe që duhet të kishin parandaluar ose ndihmuar në zgjidhjen e kësaj krize, përkatësisht Këshilli i Sigurimit të OKB-së, Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Këshilli NATO-Rusi,¹⁵ dështuan në funksionin e tyre. Për më tepër, duke qenë se situata nuk është tejkaluar ende edhe pas një viti e gjysëm pas luftës, si edhe që nuk ka shanse që kjo të ndodhë së shpejti, kjo ka kontribuar në zhvlerësimin e nocionit të bashkëpunimit ndërmjet ndarjes së ringjallur *Lindje-Perëndim*.¹⁶ Në kundësttim të këtij skenari të disa muajve pas konfliktit, një zgjerim i fjalëve kundëstuese në rrethin e jashtëm të vendeve partnere, duke përfshirë dhe ata që janë palë kundëstuese në çështje të diskutueshme, mund të duken të panevojshme dhe si humbje kohe, për të mos thënë tërësisht jo produktive.

Nga ana tjetër, mund të thuhet se gjithnjë e më shpesh ka prirje për të vlerësuar vendet partnere, bazuar mbi kontributin e pastër ushtarak që ata ofrojnë për operacionet. Një vlerë direkte kjo, që përbën një përqsasje logjike dhe tërësisht të kuptueshme, sidomos duke konsideruar faktin që këto operacione shërbejnë për sigurinë e përbashkët të të gjithë kombeve të lidhura me Aleancën, në një mënyrë ose në një tjetër. Por, megjithatë, një vlerësim i kontributeve të partnerëve, bazuar tërësisht në komponentin ushtarak, rezulton të jetë shumë dritëshkurtër. Në fakt, asetet e partnerëve duhen parë përmes lenteve të mëdha – *‘syri i peshkut’* siç thuhet – të nevojave të sigurisë globale, të përqsajes së domosdoshme gjithëpërfshirëse dhe të pa kundërshtueshme që theksuam më lart, si dhe të strategjisë së mundshme dalëse. Dhe duke dëshmuar ringjalljen e ndarjes së vjetër *“Lindje-Perëndim”*, që u përmend më sipër, mund të nevojitet kujdes për të evituar të menduarit tërësisht centrik të NATO-s dhe të logjikës së pandërgjegjshme, që e kanë fillimin në epokën e para Partneritetit...

Në këtë kontekst, mund të argumentohet se ndërsa NATO ka bërë një kthesë për më mirë, duke bërë thirrje për një “përqsasje

¹⁵ *“Ironia e dukshme këtu ishte se (...) [Këshilli NATO-Rusi u përkufizua si më i dobishëm nga NATO e Rusia si një shënjuer simbolik dhe si një mjet për sinjalizimin strategjik, sesa si një mjet për qëllimin e saj primar dhe të pretenduar (dmth një forum për të diskutuar çështjet e një rëndësie strategjike ndërmjet partnerëve).”* P. Herd dhe Daniel A. Flesch, “The Georgia crisis: Implications for the Partnership for Peace” in Connections, The Quarterly Journal Winter 2008, fq.4.

¹⁶ EastWest Institute, “Euro-Atlantic security: One vision, three paths”, fq. 1.

gjithëpërfshirëse”, ajo duhet të shmangë veprimin, për arsye që nuk janë të pranueshme tërësisht. Fillimisht, një rol kryesor për sjelljen e kësaj hapje të re, ka luajtur një nevojë e perceptuar për asete ushtarake shtesë në operacionet në vijim në Afganistan. Në fakt, përballë vështirësive gjithnjë e në rritje në terren, kjo hapje u nxit edhe nga një interes i ri për të mbledhur resurse ushtarake nga jashtë grupit të vendosur të burimeve të Aleancës. Pastaj, me zgjerimin e fokusit të përgjithshëm të problematikës në Afganistan, asetet jo ushtarake u panë si shumë të përshtatshme. Por, përtej situatës në Afganistan, një përjasje e tillë duhet të synojë një shpërndarje më të plotë rolesh ndërmjet aktorëve të ndryshëm, jo vetëm për synimin e grumbullimit të burimeve ushtarake më të shumta, por për një menaxhim të përbashkët të përgjithshëm afatgjatë të të gjithë situatave të krizave, që çon në një tranzicion më të butë nga stabilizimi drejt fazave të rindërtimit dhe të ndërtimit të shtetit.

Në vazhdim, një strategji e tillë e qartë, duke përfshirë dhe një strategji të duhur për daljen, duhet të mbështetet në mjetet diplomatike, në mbështetjen ekonomike dhe financiare, inputet industriale dhe angazhimin e bizneseve, në ndihmën për zhvillim dhe bashkëpunim në terren, në përpjekjet e qëndrueshme të llojeve të ndryshme për ndërtimin e shtetit, logjistikën dhe në ofrimin e ekspertizës së shumë fushave si edhe, më e rëndësishmja, tek burimet njerëzore, trajnimin dhe mbështetjen në fushën e policisë dhe zbatimit të ligjit, të cilat janë gjithnjë e më shumë esenciale, si mbështetje për luftën dhe për riorganizimin e vendit. Të gjitha këto janë çështje ku vendet partnere kanë asete, njohuri dhe, në disa raste, marrëdhënie të veçanta me një zonë të caktuar krize, që mund të kenë vlerë të paçmueshme, sidomos kur kuptohen më mirë rrethanat për një zgjidhje më afatgjatë.¹⁷

Në këtë kontekst, duhet theksuar se Partneriteti për Paqe dhe Këshilli për Parteritet Euro-Atlantik janë, në vetvete, instrumente për promovimin e vlerave dhe parimeve të përbashkëta të NATO-s dhe vendeve të saj partnere, si dhe inkurajimin e besimit ndërmjet të gjitha vendeve pjesëmarrëse

¹⁷Ndryshimet e kahjeve të fokusit të politikave që lidhen me kultivimin e opiumit dhe kontrollin e drogës, ndërtimin e ushtrisë kombëtare dhe atë të forcave të policisë lokale në Afganistan, ndërveprimi me popullsinë lokale dhe llojet e kontrollit të territorit etj., të gjitha këto tregojnë një evolucion të kuptimit të domosdoshmërive të konfliktit Afgan. Kuptimi se çdo zgjidhje permanente për vendin duhet të mbështetet në impute më të gjera, sesa në mjetet tërësisht ushtarake, po konsolidon pozitat me ndryshimin e fokusit drejt ndërveprimit ndërmjet asetëve ushtarake dhe atyre civile.

të këtij komuniteti të gjerë. KPEA-ja vlerëson, në nivelin politik dhe diplomatik, aktivitetet dhe punën e bërë në PpP. Ai është forumi më i përshtatshëm për të ndërmarrë dialog politik në çështje të sigurisë së lartë.¹⁸ Le të kujtojmë këtu se çdo arkitekturë e re e sigurisë për Evropën, në kuptimin më të gjerë, siç propozohet prej Ruisë, do të duhet të përfshijë jo vetëm shtetet (përveç NATO-s), por edhe organizatat ndërkombëtare si OSBE-në, BE-në dhe, në një nivel më të caktuar, edhe Organizatën e Traktatit të Sigurisë Kolektive (OTSK). Kur të vijë koha, sigurisht që do të jetë më mirë për NATO-n që të forcojë dhe të mbajë lidhje pune më të shpeshta dhe më të gjera me partnerët e saj institucionalë, në vend që t'i lirojë këto lidhje në një mënyrë pak a shumë spontane.

Për më tepër, KPEA-ja përfshin liderët politikë të vendeve partnere, dhe prandaj ka një impakt pozitiv mbi proceset kombëtare vendimmarrëse, të cilat janë të rëndësishme si për vendet partnere, ashtu edhe për anëtarët e vjetër ose të rinj të NATO-s, duke qenë se opinionet publike janë zakonisht të ndjeshëm kudo ndaj thirrjeve për përfshirje të mëtejshme të zonat e krizave.

Në fakt, NATO kupton gjithnjë e më tepër nevojat urgjente të diplomacisë publike, si një veprim për të marrë në konsideratë opinionin publik. Por ky veprim duhet të drejtohet si ndaj opinionëve publike të pavendosura të vendeve partnere që influencojnë mjedisin strategjik të NATO-s, – të cilët konsiderohen si miqësorë dhe të besueshëm, - ashtu dhe ndaj vendeve që mbeten më të përmbajtura dhe të vështira për t'u bindur, ose për të ndërvepruar me to. Sigurisht që kjo është një thirrje për vendosjen e lidhjeve më të ngushta (jo lidhjeve të zakonshme dhe që mund të humbasin) me qeveritë partnere, parlamentet dhe institucionet.

Por partneriteti Euro-Atlantik përbën më shumë sesa një mënyrë për të promovuar vlerat e përbashkëta dhe pikëpamjet në nivel qeverisës të politikëbërjes. Ky ishte burimi kryesor për procesin e zgjerimit dhe për kontributin e partnerëve në operacionet e drejtuara nga NATO. Kjo ka sjellë ndërveprueshmëri në nivele të panjohura deri më sot, si edhe ka ndikuar në politikat

¹⁸Edhe pse duket të jetë e modës në disa rrethe që KPEA-ja të përkufizohet si jo-funksionale dhe si jo-substanciale, nuk duhet krijuar asnjë iluzion mbi qëllimin e dialogut politik të mundësuar prej saj. Përtej takimeve të veçanta mujore të ambasadorëve dhe takimeve pasuese vjetore të Ministrave të Punëve të Jashtme dhe atyre të Mbrojtjes, ndërmerrret dialogu në baza javore dhe disa herë ditore, duke qenë se të gjithë anëtarët e misionëve ndërveprojnë sipas kalendarit të një sërë takimesh të komiteve dhe kontakteve informale.

e kualifikimit dhe ato të prokurimit. Kjo shërben si pikënisje për shumë iniciativa si Qendra Euro-Atlantike për Reduktimin e Shkatërrimeve dhe Iniciativa për Ndërtimin e Integritetit, si edhe për një sërë fondesh të besimit, për kuadrin politik ushtarak (KPU), ose për diskutimet politike si implementimi i rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kjo ka lidhur parlamentarë dhe opinion-bërës të të gjitha vendeve dhe përkatësive politike, nëpërmjet Asamblesë Parlamentare të zgjeruar të NATO-s. Kjo ka mbledhur bashkë mijëra zyrtarë, ekspertë, akademikë dhe ushtarakë të nivelit të lartë, nëpërmjet Konsorciumit të Akademive të Mbrojtjes dhe Instituteve të Studimeve të Sigurisë të PpP-së.¹⁹

Gjithashtu, ajo mundëson mekanizma qendrorë për rajonet e Evropës Juglindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore. Mbi të gjitha, parë nga perspektiva e vendeve partnere që nuk synojnë anëtarësimin, ajo i lejon çdo vendi vendosjen e marrëdhënieve të institucionalizuara me NATO-n dhe vetëdiferencimin e tyre. Vetëdiferencimi, një princip i përfshirë në dokumentin themelues të Partneritetit (në Aneksin 1, fq.42), u hartua qëllimisht për t'iu përgjigjur dhe për t'i korresponduar ndryshimeve të rëndësishme ndërmjet partnerëve të rinj. Si e tillë, ajo provoi se ishte struktura më parashikuese dhe pragmatike, prandaj mbi këtë bazë, NATO shihet si një strukturë pranuese e ndryshimeve, idiosinkreze të ndryshme dhe veçantive të vendeve partnere, në kundërshtim me të qenit shumë kërkuese dhe vulnerabël ndaj presionit.

Është e qartë se vendet partnere janë një ekip i shumëllojshëm, që shtrihet nga vendet e KPEA-së tek Rusia dhe Malta, nga Azia Qendrore dhe vendet anëtare të OSTK-së tek vendet e Evropës Perëndimore dhe ato anëtare të BE-së. Por kjo shumëllojshmëri nuk është një fatkeqësi. Në fakt, tërësia e burimeve të një grupi kaq të ndryshëm duhet konsideruar si gjithnjë e më tepër tërheqës dhe i dobishëm për NATO-n dhe për të gjitha përpjekjet për të siguruar paqen dhe stabilitetin. Kështu që, vendet partnerë të KPEA-së që praktikojnë qindra aktivitete të PpP-së çdo vit, i përafrohen NATO-s dhe njëri-tjetrit me hapa të ndryshëm, por nëpërmjet të njëjtës mënyrë.

Me të gjitha këto cilësi, KPEA/PpP përbën qartësisht një model të provuar dhe të testuar për lloje të tjera partneriteti si p.sh Dialogu Mesdhetar (DM)²⁰, Iniciativa e Bashkëpunimit të

¹⁹ Për një përmbajtje të arritjeve të Konsorciumit shiko: Connections, Summer Supplement, 2008, Publikuar në dhjetë vjetorin e Konsorciumit.

²⁰ Vendet e Dialogut Mesdhetar përfshijnë Algjerinë, Egjiptin, Izraelin, Jordaninë, Mauritaninë, Marokun dhe Tunizinë.

Stambollit (IBS)²¹ dhe për lidhjet e NATO-s me të ashtuquajturit partnerë rreth globit, si Australia, Zelanda e Re, Korea e Jugut dhe Japonia. Në disa raste, si për shembull në operacionet ushtarake, partnerë të tillë i ofrojnë Aleancës më shumë mbështetje, sesa ofrojnë vetë aleatët. Prandaj është normale që NATO dhe anëtarët e saj të fokusohen gjithnjë e më shumë tek këta partnerë të largët gjeografikisht, dhe të largët në marrëdhënie; dhe është bërë e zakonshme tashmë që kur mendohet se si të riorganizohet skema e partneriteteve të NATO-s, të shihet mundësia e përfshirjes së tyre duke përmbledhur të gjitha asocimet e ndryshme, aktuale dhe të ardhshme, në një strukturë më të gjerë siç është Iniciativa e Re për Partneritet Global. Në fakt, në një nivel teorik, duket e kënaqshme që të bësh atë që duket si një ndarje dhe përpjestim i tepruar i grupeve dhe strukturave të ndryshme. Megjithatë, nevojat, interesat dhe ambiciet e këtyre kategorive të ndryshme të partnerëve, nuk janë aspak të ngjashme dhe, si rrjedhojë, kërkohen zgjidhje krijuese për të përshtatur pasiguritë e ndryshme.

Në të njëjtin vit kur u krijua PpP-ja, u formua edhe Dialogu Mesdhetar. Si rrjedhim, kjo iniciativë ka patur të njëjtën periudhë kohore në dispozicion për të lulëzuar, afërsisht një gjysëm brezi. Megjithatë, ky Dialog ka treguar se është më pak efikas sesa ishte shpresuar²², duke qenë se si publiku, ashtu edhe elitat e zonës së Mesdheut, duket se janë thellësisht dyshues për NATO-n; dhe, poashtu, duke qenë se konflikti Izraelito-Palestinez nuk mund të bëjë tjetër veçse të përvijojë mbi perceptimet dhe qëllimet më të mëdha. Pra, DM nuk ka qenë e aftë të thellojë partneritetin ndërmjet vetë vendeve të Mesdheut, siç ka ndodhur vazhdimisht ndërmjet vendeve të PpP-së. Gjithashtu, dyshohet se një gjykim i tillë *a priori* do të zhduket lehtësisht, nëse këto vende do të bëheshin pjesë e përhershme e KPEA-së ose të organizatës së saj pasardhëse. Përsa i përket IBS-së, ajo u krijua dhjetë vjet më vonë, pra në 2004 dhe ndoshta nuk e ka patur deri tani kohën e nevojshme për të zhvilluar potencialin e saj të plotë. Por, “ndërsa qëllimi kryesor i iniciativës ishte të përfshihej

²¹ IBS-ja përfshin katër vende të gadishullit Arabik, anëtarë të Këshillit të Bashkëpunimit të Gjirit Persik: Bahreini, Kuvajti, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, Omani dhe Arabia Saudite u ftuan por ata preferuan vetë që të mos merrnin pjesë.

²² Për një diskutim mbi paaftësitë dhe mosarritjet e të gjithë skemave të partneriteteve përveç KEAP/PpP-së shiko Graeme, P. Herd and Daniel Knight “Future visions of NATO partnerships and cooperation programmes” in Connections, Fall 2007, fq. 1-9.

në sfidat e sigurisë së lartë në rajon, deri tani kjo strukturë ka vepruar vetëm në nivel politik. Kjo pengesë, vjen kryesisht prej kushteve aktuale të pafavorshme për paqe dhe dialog në Lindjen e Mesme.²³

Kjo nuk nënkupton se nuk është e mundur të kemi një thellim të marrëdhënieve në kuadër të dy iniciativave të mësipërme, apo ndërmjet grupeve të tjera të shteteve. Në fakt, kjo dëshirohet në nivele të ndryshme, dhe meriton të inkurajohet për qasja nga poshtë lart e bazuar në nevojat dhe interesat që janë identifikuar prej vendeve të DM-së dhe IBS-së. Bazuar në eksperiencat më të mira të procesit të PpP-së, një riorganizim i këtyre dy modeleve të partneritetit Mesdhetar dhe Arab do të ishin patjetër ndërmjet kartave të përdorura, me kusht që kjo të mos pengojë rritjen e cilësisë dhe intensitetit të konstruktit aktual të PpP-së dhe të KPEA-së.

Kjo është një fushë ku Koncepti Strategjik mund dhe duhet të sjellë përgjigje konkrete sa i përket rolit që NATO do t'i atribuojë partnerëve të saj institucionalë, duke u fokusuar tek fusha e parë e veprimit që i përket strukturave të PpP-së dhe KPEA-së dhe më pas tek rrethi i jashtëm i vendeve partnere, që mbahen në nivele më pak të institucionalizuara ose jo të institucionalizuara, të cilat mund të zgjerohen sërish në një numër më të madh, sesa në rastin e sotëm. Kjo do të thotë llogaritje që në fillim të vlerës së shtuar të përgjithshme dhe të asaj për secilin rast të vendeve jo-anëtare, si dhe të atyre që u përkasin nën-grupeve rajonale. Për të ecur përpara me këtë çështje, mund të kërkohet një ndryshim i predispozitave intelektuale të NATO-s: kjo do të përfshinte fillimin e një fokusimi më të theksuar në varietetin e gjerë të partnerëve dhe cilësive të tyre të shumta, në vend që t'i lëshohesh tundimit për të lehtësuar detyrën, duke u dhënë të gjithë vendeve një status të njëjtë, pavarësisht faktit sesa jo koherente mund të jetë një njehsim i tillë. Një nivelim i tillë do të sillte pashmangshmërisht fokusimin e të gjithë Partneritetin në emëruesin e përbashkët më të ulët, në vend që t'a bazonte atë mbi pikat më të forta të përbashkëta.

Megjithatë, në terma afatgjatë, ky ndryshim sjelljeje është i rëndësishëm duke patur parasysh faktin se NATO do të ketë nevojë gjithnjë e më tepër për konsultime me partnerët në të gjithë rajonet e botës, dhe mund të mbështetet eventualisht edhe në përfshirjen e partnerëve në struktura fleksibël, si Forcat e Reagimit të NATO-s (FRN). Duke patur parasysh vështirësinë në rritje të NATO-s për të arritur konsensusin e 28 anëtarëve të

²³ Graemer P. Heird and Daniel Knight op. cit. fq.7.

saj, disa aleatë mund të duan të mbështeten gjithnjë e më tepër në koalicionet me përfshirjen e vullnetshme të partnerëve – me politikën e mirë, por pa shoshitur pengesat e disa aleatëve të tjerë²⁴, si p.sh në rastin e KFOR-it, në të cilin përfshihen një sërë partnerësh, por vetëm 24 aleatë nga të 28. Për më tepër, për NATO-n duket njësoj e rëndësishme që të arrijë të komunikojë me disa partnerë të zgjedhur, kur bëhet fjalë për mbledhjen e mbështetjes politike të nevojshme në çështje të caktuara, sidomos sa i përket marrëdhënieve të saj me Bashkimin Evropian, Organizatën e Kombeve të Bashkuara, dhe me vendet që ndodhen afër zonave të krizave.

Për më tepër, duhet të kompletohet një tjetër ndryshim në sjellje, për të eliminuar një tjetër dykuptimësi të vazhdueshme që lidhet me partneritetet. Edhe pse një nga përsiatjet kryesore të Partneritetit për Paqen, dhe të zanafillës së tij, ishte të lehtësonte rrugën për shtetet e reja aspiruese, duhet thënë se me zhvillimin e tij, ky partneritet ka siguruar një funksionim të pavarur. Sigurisht, nevojitet të njihet fakti që partneriteti nuk duhet kuptuar domosdoshmërisht si një stad që i paraprin anëtarësimin në NATO. Ashtu siç edhe vetë Aleanca u zhvillua përtej qëllimit të saj fillestar²⁵, po ashtu edhe PpP-ja dhe KEAP-ja zhvilluan një qëllim të pavarur, duke qenë se këto kanë një efekt ngacmues tek partnerët dhe tek shtimi i sjelljes së tyre bashkëpunuese. Prandaj, NATO do të bënte mirë të përqëndrohej në meritat e brendshme të partneritetit, dhe të mos e konsideronte atë vetëm si një fazë tranzitore.

Zgjidhjet institucionale

NATO përballet me një dilemë gjatë përpjekjeve për të afruar vendet partnere më afër procesit të saj vendim-marrës, si dhe operacioneve të saj. Të qenit i hapur dhe transparent me gjithë

²⁴ Në fakt NATO-s dhe anëtarëve të saj më aktivë mund t'ju duket e dobishme që të mbështeten tek partneriteti dhe tek angazhimi i shteteve partnere të Aleancës, duke qenë se “Do të ishte e vështirë që të menaxhohej një situatë ku disa prej partnerëve të NATO-s kontribuojnë më shumë në operacionet Aleancë, sesa disa anëtarë me të drejta të plota të saj.” Karl Heinz Kamp “The way to NATO-s New Strategic Concept.” NATO Defense College, Research Paper No. 46, Qershor2009.

²⁵ Edhe pse NATO u hartua kryesisht për të garantuar siguri kundrejt kërcënimit të rritje Sovjetik, efekti i saj politik në Evropën Perëndimore ishte të promovonte ripajtimin me ish-fuqitë e Boshtit, Gjermaninë dhe Italinë, duke forcuar një përkatësi afatgjatë ndërveprimi Euro-Atlantik.” Zbigniew Brzezinski. Op. cit.fq.5.

partnerët e saj, shton përfshirjen dhe pranueshmërinë e NATO-s në komunitetin ndërkombëtar, po në të njëjtën kohë kjo mbart rrezikun e një vendim-marrjeje të ngadalshme ose edhe deri në bllokim. Për shembull, kriza në Gjeorgji tregoi, në të njëjtën kohë, rëndësinë e KPEA-së si një forum për dialogun politik – tek e fundit kjo ishte skena e fundit politike, ku NATO shkoi për të takuar dhe biseduar me Rusinë – por dëmtoi qëllimet e mira të NATO-s për të ndarë më tepër debatet e brendshme me partnerët e saj. Është e vërtetë që kur flitet për operacione, partnerët që kontribuojnë me trupa janë asociuar gjithnjë e më shumë gjatë hartimit të vendimeve të Aleancës falë procesit të Kuadrit Politik-Usharak. Megjithatë, këta partnerë shpesh konsultohen me vonesë dhe pa iu dhënë mundësia reale për të influencuar proceset.

Një shembull i thjeshtë i kësaj mospërputhjeje në të kaluarën gjendet, kur flitet lidhur me vendimin aktual për pakësimin e numrit të trupave të Forcës së Kosovës (KFOR). Me formësimin e një mendimi të ri mbi këtë çështje, u bë e qartë për ata që ishin brenda, se një pikë kryesore diskutimi për takimin e Ministrave të Mbrojtjes në 11-12 Qershor 2009, do të ishte çështja e tranzicionit drejt një uljeje të Prezencës së garantimit të Sigurisë. Sërisht, në atë rast nuk u organizua asnjë takim ministrash, sipas formatit të KFOR-it, edhe pse do të ishte shumë normale që gjatë marrjes së një vendimi të tillë të rëndësishëm, të përfshiheshin edhe vendet kontribuuese me trupa. Një grup i Partnerëve të Evropës Perëndimore (PEP), më konkretisht Austria, Finlanda, Irlanda, Suedia dhe Zvicra, ndanë shqetësimin e tyre për këtë dhe NATO, më në fund, vendosi të organizonte një takim për ndarje-informacioni të KAV-së me partnerët e KFOR-it, një javë pasi ishte marrë vendimi prej takimit ministerial. Për më tepër, edhe pse dokumentet domethënëse u qarkulluan tek partnerët përkatës pak përpara takimit ministerial të sipër përmendur, partnerët patën shumë pak kohë në dispozicion për të reaguar.

Shpesh herë, partnerët janë përballur me situatën e vendosjes para një "*fait accompli*" (fakti të përfunduar) edhe për çështje që u përkasin direkt atyre. Sigurisht, kjo nuk është mënyra më e mirë për përfshirjen e partnerëve dhe për ofrimin e një sensi përkatësie. Në këtë kontekst, mund të përmenden disa shembuj të tjerë, të cilët renditen që nga debati mbi përqasjen gjithëpërfshirëse deri tek çështjet e sigurisë, po ashtu edhe për planin e emergjencave civile.

Çfarë rrezikohet kur flitet për një përfshirje më të madhe të partnerëve? Mesa duket, ka dy pika kryesore që bllokojnë një ndarje

më të madhe informacioni me shtetet që nuk janë anëtarë të Organizatës. E para është se, kur aleatët nuk bien dakord për një çështje të caktuar, ata hezitojnë që të ndajnë debatin me të tjerët, duke qenë se ata kanë frikë se mos diferencat e tyre mund të shfrytëzohen prej jo anëtarëve. Arsyeja e dytë është se, për arsye politike dhe/ose të sigurisë, aleatët ndoshta do të binin dakord të ndanin informacionin e tyre me disa prej partnerëve, por jo me të gjithë ata. Ndërsa të dy këto shpjegime janë mëse të legjitimuara, mbetet të arrihet objektivi për përmirësimin e kësaj çështje delikate, çka do të ishte në fund me përfitim edhe për vetë NATO-n. Kjo sepse, në fund të fundit, partnerët i sjellin një vlerë shtesë NATO-s dhe sepse është në të mirë të Aleancës që të afrojnë sa më shumë që të jetë e mundur partnerët më të dobishëm dhe më të vendosur.²⁶ Çfarë mund të propozojë NATO në dobi të kësaj çështjeje të Konceptit të saj të Ri Strategjik? Përgjigjia më e thjeshtë do të ishte përfshirja e mundësisë për të ndarë informacionin me partnerët, edhe nëse nuk ka marrëveshje ndërmjet aleatëve, ose të fillohet një diskutim mbi një çështje specifike në kuadër të KPEA-së, ose edhe në një kontekst më të gjerë, në mënyrë që të merren parasysh, që në fillim, të gjitha pikëpamjet. Me shumë mundësi, kjo ka ndodhur gjatë lançimit të procesit të Konceptit të Ri Strategjik, në një konference me pjesëmarrje të gjerë që u zhvillua në Bruksel, në 7 korrik të vitit 2009.

Një tjetër mundësi e përmendur në shumë raste prej aleatëve do të ishte “kategorizimi” i KPEA-së në grupe të ndryshme (Partnerët e Evropës Perëndimore, të Kaukazit, të Azisë Qendrore etj...) sipas nevojave të secilit prej grupeve në fjalë – dhe siç u parashikua faktikisht prej dokumentit bazë të Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik të vitit 1997 (Aneksi 1, fq.47), i cili krjoi hapësirën për takime të një formati të limituar ndërmjet Aleancës dhe grupeve të partnerëve. Kjo përjasje është në disa mënyra tashmë në fuqi për Rusinë, Ukrainën dhe Gjeorgjinë në kuadrin e KAV+1, ose në një nivel tjetër përsa i përket Dialogut Mesdhetar. Gjithashtu, kjo është tashmë në veprim nëpërmjet Procesit të Rishikimit të Partneritetit (PARP), i cili përfshin një numër të përzgjedhur partnerësh, përveç 28 vendeve anëtare të NATO-s dhe të vendit partner që është në procesin e rishikimit.

²⁶ “... në ambjentin e ri të sigurisë, partnerët tanë përbëjnë një kontribut kritik për objektivat tona të përbashkëta. Kjo është arsyeja pse lidhjet me vendet tona partnere (...) përbëjnë një aset strategjik të vërtetë. Ne kemi nevojë të sigurohemi se kemi partneritetin më të afërt të mundshëm me këto vende që mundet dhe dëshirojnë të na ndihmojnë të mbrojmë vlerat tona të përbashkëta”. Jaap de Hoop Scheffer, Speech at the 42-nd Munich Conference on Security Policy, 4 Shkurt 2006.

Gjithashtu, NATO ka patur në disa raste takime me vendet e Azisë Qendrore dhe Kaukazit. Ky model NATO + N ka avantazhin e efikasitetit dhe koherencës dhe mund të vendoset në përdorim më shpesh. Megjithatë, disavantazhi i madh i intensifikimit të lidhjeve të një natyre të tillë, krahasuar me formatin e takimeve të KPEA-së, është humbja e ndjenjës së përkatësisë në një komunitet sigurie që ndan të njëjtat vlera dhe principe, dhe humbja e efektit të ndërtimit të besimit që ka një strukturë e tillë. Dhe kjo ndjenjë e pasjes së një tipari dhe qëllimi të përbashkët, nuk duhet vlerësuar tërësisht si një luks konsumues i kohës. Me fjalë të tjera, çdo lëvizje drejt kategorizimit duhet të sigurohet që të mos çenojë thelbin e KPEA-së së sotme: takimet specifike të grupeve të vendeve me mendime ose pozicione të njëjta duhet të jenë si një vazhdimësi dhe nuk duhet të zëvendësojnë tërësisht kuadrin e KPEA-së.

Një mundësi e tretë do të ishte përshtatja e strukturave aktuale të KPEA-së, mbi një bazë *ad hoc*, për të mbledhur herë pas herë partnerët nga i gjithë globi, sipas pikave të axhendës, ndoshta edhe me anë të organizimit të takimeve të ndryshme të ambasadorëve, përtej takimeve të zakonshme të përmuajshme të KPEA-së. Të treja këto opsione janë instrumente të mundshme në dispozicion të NATO-s dhe që nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Rruga përpara

A do të jetë ndonjëherë e mundur për NATO-n që të përmbushë të gjithë pritshmëritë e ndryshme të vendeve partnere, disa prej të cilëve dëshirojnë të anëtarësohen, disa të tjera që parashikojnë lëvizjen dhe disa të tjerë të pozicionuar si të jashtëm e mbetur? Përveç kësaj, tashmë ekziston një vështirësi e brendshme për të sjellë në një marrëveshje të përbashkët të 28 aleatët, duke përfshirë këtu, siç u përmend dhe në hyrje, edhe rastin kur flitet për vetë rrugën që do të udhëheqë në Konceptin e Ri Strategjik²⁷. Megjithatë, mbetet të theksohet që sipas pikëpamjes tonë, një element përcaktues për të ardhmen

²⁷ Një fakt që u shtrua haptazi nga brenda vetë NATO-s: “Ekzistonte shqetësimi se, një diskutim strategjik i mbajtur në publik, mund të nxirrte në pah sa e pabashkuar ishte NATO përse i përket çështjeve kryesore mbi rolin e ardhshëm të Aleancës. Sipas këtij këndvështrimi, një rishikim i Konceptit Strategjik mund të thellonte më tej shpërbërjen e kohezionit tashmë të thërrmuar të NATO-s dhe mund të ishte një përpjekje kundër-produktive”. Karl, Heniz Kamp op. cit. fq.1.

e NATO-s do të jetë konsultimi me partnerët, qofshin këta vende ose organizata ndërkombëtare. Si e tillë, nuk mund të shtrohet pyetja nëse duhet të konsultohemi ose jo, por më saktë sesi të përcaktohen mënyrat më të mira të konsultimit dhe të bashkërendimit të plotë me një sërë partnerësh.

Drejt Konceptit Strategjik final, do të na udhëheqë një e dhënë treguese, për sa i përket rëndësisë që i jepet konsultimeve dhe pikëpamjeve të jashtme. Shenjat e para në këtë drejtim janë inkurajuese. Grupi i personave të mençur që do të punojnë pranë Sekretarit të Përgjithshëm Anders Fogh Rasmussen, do të ndërmarrë pa dyshim konsultime me ekspertë të tjerë dhe do të përpiqet të marrë në konsideratë një sërë pikëpamjesh. Tashmë janë propozuar disa takime të përgjithshme, si të hapura për partnerët dhe për disa organizata ndërkombëtare, të cilave iu është kërkuar që të parashtrojnë pikëpamjet e tyre. Dhe një efekt përfundimtar është se do të shtjellohen një sërë rekomandimesh dhe idesh, pak a shumë novatore, në të njëjtën mënyrë si në samitet e kaluara, ku kërkoheshin dokumente përmbyllës për forcimin e lidhjeve ndërmjet aleatëve dhe partnerëve.

Ka shumë pak gjasa që partnerët dhe partneritetet të anashkalohen dukshëm duke u konsideruar si instrumente të vjetëruar, të pavolitshëm ose kryesisht si instrumente “të bukura vetëm për t’u patur”, që shtyhen deri sa të mbarohet trajtimi i çështjeve më urgjente dhe më të rëndësishme.

Gjithashtu, Projekti i Shumëpërdorimeve mbi të Ardhmen i NATO-s thekson (mund të vihet re me kujdes: tek rekomandimet për implikimet ushtarake të tij) se “Bashkëpunimet dhe ndërveprimet me shtetet jo-anëtare të NATO-s dhe me aktorë të tjerë ndërkombëtarë janë të nevojshme për të krijuar mundësitë që Aleanca të shtojë sigurinë dhe stabilitetin.” Më pas rekomandohet: “Ri-vlerësimi i mekanizmave të ndryshëm të partneritetit të Aleancës për të siguruar përfshirjen më të drejtpërdrejtë të partnerëve në iniciativat e politikës së mbrojtjes së NATO-s, sidomos sa i përket Dialogut Mesdhetar dhe Iniciativës së Bashkëpunimit të Stambollit, si edhe në partneritetet rreth globit.²⁸” Ndërkohë, vendet partnere, pa dyshim, do të vazhdojnë të parashtrojnë qëndrimet e tyre, duke ofruar ide për dokumente të qëllimta për t’u diskutuar në nivelin KPEA-së dhe ndoshta, gjithashtu, edhe në mbledhjet e seminareve që do të fokusohen në çështje të caktuara dhe të rëndësishme për grupe

²⁸Supreme Allied Commander Transformation, “Multiple Future Project, Findings and Recommendations”, fq. 10-11.

të caktuara, ose për të gjithë. Megjithatë, çfarëdo që të jetë procesi dhe imputet që mund të konsiderohen, ajo që është më e rëndësishmja është se çfarë shtrihet përpara: A do të pajtohet NATO me të vërtetë me një shpirt të riorganizuar të bashkëpunimit të jashtëm apo do të mbyllet në mosmarrëveshjet e brendshme që limitojnë nivelin e të qenit të hapur të saj dhe të disponueshmërisë së saj për konsultime të jashtme?

Kjo përbën dhe rëndësinë e qëllimit kryesor të Konceptit të Ri Strategjik: nëse ai do të limitohet vetëm në përpjekjet për të parashikuar krizën ose tensionet e radhës dhe të përgatitet për to, ai mund të rrezikojë të bjerë shpesh në një irrelevancë relative. Nga ana tjetër, nëse ai synon t'i japë NATO-s të gjithë fleksibilitetin e nevojshëm për t'u përshtatur sa më shpejt të jetë e mundur me rrethanat në ndryshim e sipër, atëherë ai do të mbështetet me siguri në virtytet e shtuara, duke përfshirë dhe vendosjen e partneriteteve në thelb të së ardhmes të NATO-s, përfshirë NATO-n, ashtu siç ato janë në ambientin e saj strategjik. Është e qartë se të menduarit mbi zonat e krizave, operacioneve thelbësore dhe rreziqeve në rritje duhet të fokusohen në kockat dhe mishin e kërkesave për siguri²⁹. Megjithatë, ashtu sikurse bakteret mund të helmojnë një vakt të tërë, ajo mund të hyjë edhe në një nga pjatat e anës, dhe jo vetëm direkt në rosto; aroma e plotë e pjatës i detyrohet më së shumti asocimit të saj me salcat dhe erëzat.

Dr Jean-Jacques de Dardel është aktualisht Ambasadori i Zvicrës në NATO dhe në Belgjikë. Më parë ai ka qenë Drejtor i Divizionit të Çështjeve Politike tek Departamenti i Punëve të Jashtme të Zvicrës, mbasi themeloi Qendrën për Politika Ndërkombëtare të Sigurisë, në 2001.

²⁹"NATO-s do t'i nevojiten patjetër partnerët për të qenë e suksesshme në të ardhmen, dhe ajo do të vazhdojë të ketë nevojë për partneritete të ndryshme që të arrijë objektiva të ndryshëm, ashtu sikundër edhe vetë partnerët e saj. Rruga e kujdesshme që duhet të marrë Aleanca është që ajo të ndërtohet bazuar mbi fleksibilitetin dhe qëllimet e arritshme dhe praktike gjatë këtyre partneriteteve, të trajtojë secilin rast në baza individuale dhe, në radhë të parë, të përzgjedhë me kujdes partnerët. Graeme P. Heard and Daniel Knight op.cit. fq.9.

Thomas Renard & Sven Biscop

NEVOJA PËR STRATEGJI NË NJË BOTË MULTIPOLARE: REKOMANDIMET PËR BE-NË PAS LISBONËS

Tani që Traktati i Lisbonës ka hyrë në fuqi, është koha që BE-ja t'i rikthehet punës dhe, në mënyrë të veçantë, të fokusohet në politikën e saj të jashtme. Në një botë që është gjithnjë e më shumë komplekse dhe multipolare, BE-ja duhet të veprojë në mënyrë strategjike. Për të mënjanuar shndërrimin e saj në një aktor ndërkombëtar të parëndësishëm, Brukseli duhet të (1) zhvillojë një strategji kyçe për të përcaktuar synimin e vërtetë të politikës së saj të jashtme; (2) të krijojë partneritete strategjike të forta me aktorët kryesorë globalë; dhe (3) të kontribuojë në ndërtimin e një sistemi të ri efektiv multilateral, që merr parasysht strukturën e re globale të pushtetit.

Tani që Catherine Ashton është caktuar përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe që Herman van Rompy është bërë Presidenti i parë i përhershëm i Këshillit Evropian, shtrohet një pyetje më themelore: cilën strategji të politikës së jashtme do të ndjekin ata?

Në Strategjinë Evropiane të Sigurisë të 2003 (SSE), BE-ja ka zhvilluar një strategji kyçe, që përfshin të gjithë instrumentet dhe burimet e politikës së jashtme në dispozicion të BE-së dhe shteteve anëtare, por në mënyrë të pjesshme. SSE-ja na tregon si t'i bëjmë gjërat – në një rrugë parandaluese, holistike dhe multilaterale – por është shumë e paqartë në atë se çfarë duhet të bëjmë: cilat janë prioritetet e politikës së jashtme për BE-në?

Debati i fundit për SSE-në, që u reflektua në Raportin e 2008-ës mbi Zbatimin e Strategjisë Evropiane të Sigurisë, dështoi t'i përgjigjej kësaj pyetje. Meqë ofron pak në drejtim të rekomandimeve për të ardhmen, Raporti krijon përshtypjen e një çështje të

papërfunduar që BE-ja e përballon me vështirësi, tani që Traktati i Lisbonës ka forcuar rregullimin institucional. NATO ka nisur një debat strategjik, në të cilin kontributi i BE-së është thelbësor dhe BE-ja rrezikon të lihet nën hije nga fuqi të reja që po lindin.

Nevojitet një rishikim i plotë strategjik për të kompletuar SEE-në. Rregulli i parë i bërjes së strategjisë është ta njohësh vetë. Është e dukshme se BE-ja aktualisht nuk është shumë e qartë se cilat vlera dhe interesa kërkon të ruajë dhe çfarë aktori ndërkombëtar synon të bëhet. Kështu, BE-ja duhet të nisë rishikimin e objektivave të saj strategjik, duke shikuar tek vetja e saj dhe duke u përpjekur të identifikojë qëllimin e politikës së jashtme. Por ka shumë rreziqe nëse ndalet shumë duke parë vetveten dhe, për më tepër, BE-ja nuk mund të pretendojë të bëhet një aktor strategjik nëse ajo vazhdon të injorojë aktorët e tjerë strategjik. Kjo nuk do të thotë të njohësh armikun tënd (ndoshta BE-ja nuk ka armiq të drejtpërdrejtë, edhe pse surprizat strategjike nuk duhet të përjashtohen asnjëherë³⁰), por të njohësh “tjetrin”. Së fundmi, një parim i fundit i bërjes së strategjisë mund të ishte: njohja e mjedisit tënd, ose thënë me fjalë të tjera, njohja e rregullave të lojës. Nëse BE-ja shpreson të bëhet një fuqi globale, ajo duhet të kuptojë – ose më saktë të formësojë – rregullat që përcaktojnë marrëdhëniet e jashtme.

Nevoja për një Strategji kyçe

Cilat vlera dhe interesa duhet të ruajë strategjia jonë kyçe? Evropa ka një model shumë të veçantë social, në të cilin ndërthuren demokracia, ekonomia e tregut dhe ndërhyrja e madhe e shtetit. Objektivi themelor për BE-në, si aktor i brendshëm dhe global, është të ruajë dhe forcojë këtë kontratë sociale të brendshme ndërmjet BE-së dhe qytetarëve të saj, duke u garantuar atyre sigurinë, prosperitetin ekonomik, lirinë politike dhe mirëqenien sociale. Kushtet që duhet të plotësohen për ta bërë të mundur këtë, përbëjnë interesat tona jetësore: mbrojtja kundër ndonjë kërcënimi ushtarak; hapja e linjave të tregut dhe komunikimit (në hapësirën fizike po aq edhe në hapësirën kibernetike); furnizimi i sigurt me energji dhe burime të tjera natyrore jetësore; një mjedis të qëndrueshëm; rrjedhje migruese të menaxhueshme; respektimi i ligjit ndërkombëtar dhe garantimi i të drejtave universale; autonomia e politikë-bërjes së BE-së.

³⁰ Colin S. Gray, “Mjedisi i Sigurisë në shek. 21 dhe Lufta e Ardhshme”. *Parameters*, vol. 38:4 (2008), fq. 14-26.

Për të garantuar këto interesa, BE-ja duhet të jetë një fuqi, p.sh. një aktor strategjik që në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të qëllimtë të përkufizojë objektivat afatgjatë, të ndjek ato në mënyrë aktive, dhe kërkon mjetet e nevojshme për këtë qëllim. Lloji i fuqisë që BE-ja zgjedh të jetë është pjesërisht i kushtëzuar nga mjedisi ndërkombëtar. I shënuar si ndër-polaritet, i përcaktuar si “multi-polaritet në kohën e ndërvarësisë”³¹, ky mjedis është shumë sfidues, por në të njëjtën kohë i jep BE-së mundësinë për të ndjekur një strategji kyçe të dallueshme. Kjo strategji është e dallueshme në kuptimin që theksi vihet në një qasje holistike, duke vënë në përdorim gamën e plotë të instrumenteve, përmes partneriteteve dhe institucioneve multilaterale, për një politikë të përhershme në parandalimin dhe stabilitet. Në drejtim të kundërt me strategjinë kyçe të ShBA-së, BE-ja favorizon multi-lateralizmin, e bazuar në rregulla; pra jo çdo formë të multi-lateralizmit. Dhe ajo promovon vlerat e saj në mënyrë globale, por nuk përpiqet t'i imponojë ato.

Qasja që ka ndjekur deri tani BE-ja është në të njëjtën linjë me këtë strategji kyçe, por praktika ka treguar një tërësi kufizimesh. Strategjia klasike e “kushtëzimit pozitiv” të BE-së, p.sh. ofrimin të përfitimeve në këmbim të bashkëpunimit për sigurinë dhe reformave politike, sociale dhe ekonomike, ka qenë më tepër e pasuksesshme, veçanërisht përballë aktorëve të tjerë global. Ndërvarësia dhe gama e gjërave është shumë e madhe për BE-në që të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm. Në të kundërt, retorika pa vepruar shërben vetëm për të minuar fuqinë e butë të BE-së.

Nevoja për Partneritete Strategjike të Vërteta

Në një botë që është gjithnjë e më tepër multipolare dhe e ndërvarur – pra, thënë ndryshe, ndërpolare – BE-ja nuk mund të vazhdojë t'i afrohet fuqive globale, që lindin pa një strategji të qartë. Kështu që BE-ja ka krijuar një instrument të ri për t'u angazhuar me aktorët e tjerë global: partneritetet strategjike. Megjithatë, strategjia aktuale përtej tyre është larg të qenit e qartë.

Një problem i parë dhe madhor është mungesa e kuptimit të konceptit të partneritetit strategjik. Ai nuk është përkufizuar kurrë dhe, për pasojë, është parë dhe interpretuar në mënyra të ndryshme nga shumë aktorë brenda BE-së, pa përmendur ata jashtë BE-së.

³¹ Giovanni Grevi, *Bota Ndërpolare: Një Skenar i Ri* Paper 79, Paris: EUISS, 2009, fq. 9.

Një problem tjetër madhor lidhet me vendet që kualifikohen për një partneritet strategjik. Ekzistojnë pak kritere themeltare, me përjashtim që partneritetet mund të nënshkruhen me “vende të treta dhe organizatat ndërkombëtare, rajonale ose globale, të cilat ndajnë parimet [e demokracisë, sundimit të ligjit, universalitetit dhe pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, respektit për dinjitetin njerëzor, parimet e barazisë dhe solidaritetit, respektit për parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe ligjit ndërkombëtar]” (Traktati i Lisbonës, Neni 22), dhe që “statusi i partnerit strategjik është menduar të rrjedhë në mënyrë të veçantë nga kapaciteti i një vendi për të ushtruar një influencë domethënëse mbi çështjet globale”.³² Në këtë pikë, duke mos llogaritur marrëdhëniet me ShBA-në, Kanadanë dhe NATO-n, BE-ja ka ose është duke negociuar shtatë partneritete strategjike me shtete të tjera (Brazilin, Kinën, Indinë, Japoninë, Meksikën, Rusinë, dhe Afrikën e Jugut), dhe një me një organizatë ndërkombëtare (Unioni Afrikan). Duket shumë qartë se asnjë prej tyre nuk është strategjik në mënyrë të barabartë. Shumica e këtyre vendeve në mënyrë të pamohueshme ushtrojnë udhëheqje rajonale ose janë aktorë domethënës për një çështje specifike globale. Kjo i bën ata strategjik në lidhje me një rajon, ose një çështje. Por a është ky një kusht i mjaftueshëm për t'i bërë ata një partner strategjik? A mund të vendoset Meksika dhe Afrika e Jugut në të njëjtin nivel me Kinën, Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara?

Rreziku është në tejzgjatjen e konceptit, duke çuar në një amalgam ndërmjet marrëdhënieve të rëndësishme dhe marrëdhënieve strategjike. Kjo tejzgjatje krijon konfuzion si brenda BE-së, por edhe në sytë e partnerëve të saj, dhe në mënyrën sesi ata i interpretojnë ambiciet e Evropës. Në një mënyrë, ne kemi qenë shumë të suksesshëm në ngatërrimin e partnerëve tanë dhe duke u bërë edhe më pak strategjik ndaj tyre.

Kështu, si mundemi aktualisht t'i bëjmë partneritetet e BE-së strategjike? Një strategji e vërtetë e përdorimit të partneriteteve strategjike, p.sh në funksion të politikës së jashtme të BE-së, duhet të fillojë nga vlerësimi i plotë i interesave të BE-së në rajone të ndryshme të globit dhe në një përkufizim më të qartë të objektivave të saj drejt tyre. Në të njëjtën kohë, është në rend vendosja e prioriteteve të veprimeve që do të ndërmerren për të sfiduar kërcënimet globale, në funksion të interesave jetësore të Bashkimit. Në shumicën e këtyre çështjeve – klimës, migrimit,

³² “Drejt një Partneriteti Strategjik BE-Meksikë”, COM(2008) 447, Bruksel, 15 Korrik 2008.

energjisë – BE-ja ka përpunuar tashmë politika. Ato duhet të integrohen në strukturën e gjerë të politikës së saj të jashtme.

Partneritetet strategjike, më tepër se objektiva të mirëfillta, janë instrumente për të zgjeruar “multilaterizmin efektiv”. BE-ja mund të identifikojë interesa të përbashkëta me secilin prej partnerëve të saj strategjik, për të vendosur në një sërë fushash politike prioritare, bashkëpunim praktik efektiv me ata partnerë strategjikë që ndajnë interesat e BE-së në atë fushë specifike, me synimin përfundimtar të institucionalizimit të këtyre formave të bashkëpunimit dhe lidhjes së tyre me institucionet e përhershme multilaterale. Një qasje e tillë pragmatike e ndërtimit të koalicionit dhe bashkëpunimit praktik, për çështje shumë të veçanta fillimisht, mund të zgjerohet në fusha më të mëdha, duke përfshirë vlerat. Nëse p.sh nuk ka gjasa që ne të shohim Kinën në ballë të promovimit të demokracisë, ajo ka një interes ekonomik në promovimin e sundimit të ligjit, qoftë edhe vetëm për të siguruar që koncesionet për nxjerrjen e mineraleve që merr, nuk i janë ofruar në të njëjtën kohë dikujt tjetër.

Në vend që të pyesë se me cilin shtet ose organizatë duhet përfunduar një partneritet strategjik, BE-ja duhet të shikojë përtej atyre që tashmë ekzistojnë dhe të përfshijë aktorë për një bashkëpunim konstruktiv, në funksion të fuqisë së tyre, të përqendruara në fusha specifike. Në praktikë, mund të shfaqen dy tipologji partnerësh: ata me të cilët BE-ja vendos të bashkëpunojë në një hapësirë të gjerë gjithëpërfshirëse – ndoshta të paktën Rusia, Kina dhe India, nëse ata do të jenë të prirur për një bashkëpunim të tillë, dhe sigurisht ShBA-ja, - dhe atyre me të cilët bashkëpunimi fokusohet në një gamë më të kufizuar të çështjeve ose rajoneve.

Për të punuar me partnerët strategjikë, BE-ja duhet të flasë me një zë – aktorët e tjerë globalë janë të aftë vetëm në kundërvënien e një shteti anëtar ndaj një tjetri. “Vetëndarja dhe të qenit mbi rregullin” nuk është një strategji që, detyrimisht, i shërben interesave Evropiane. Në fund të fundit, shtetet anëtare duhet të pajtohen me rregullat e transparencës dhe automatikisht të informojnë BE-në, në një fazë të hershme, për të gjitha marrëveshjet e rëndësishme të ndërsjellta me partnerët strategjikë, në mënyrë që të lejojnë debatin në institucionet e BE-së dhe dekonfliktimin e interesave, potencialisht konkurruese. Idealisht, mbi çështjet kyçe, partneritetet strategjike mund ta shfaqin BE-në si një bashkëbisedues unik për një sërë çështjesh të rëndësishme, duke kufizuar kështu fushën e manovrimit të shteteve anëtare individuale.

Me zbatimin e Traktatit të Lisbonës, mund t'i atribuohet një rol më i madh EEAS (European External Action Service/ Shërbimi

i Jashtëm i Veprimit Evropian) – në vend të Komisionit që deri më sot është përgjithësisht përgjegjës për partneritetet strategjike – për centralizimin dhe koordinimin e partneriteteve të ndryshme strategjike, duke i lidhur ato me një politikë të jashtme koherente. Pa strategji, partneritetet strategjike do të bëhen shumë shpejt të parëndësishme. Me një strategji, ato mund të bëhen potencialisht instrumente efektivë të një politike të bashkuar të jashtme Evropiane.

Nevoja për një Multi-lateralizëm të Reformuar

Partneritetet strategjike bilaterale nuk do të jenë të mjaftueshme për të formësuar të ardhmen e rendit global, megjithatë, arkitektura multilaterale si e tillë duhet të reformohet gjithashtu. Nëse bota është duke u bërë gjithnjë e më tepër multipolare – ose madje ndërpolare – është ende e paqartë nëse ky multipolaritet do çojë në një bashkëpunim apo konkurrim më të madh. Historia na mësoi se shfaqja e fuqive të reja që sfidojnë rendin e vjetër mund të çojë në skenarë të ndryshëm, në varësi të aftësisë së aktorëve për t'u përshtatur me njëri-tjetrin dhe me mjedisin e tyre. Ne duhet gjithashtu të mësojmë nga historia që ndërpolariteti nuk është qenësisht i drejtuar nga bashkëpunimi, ashtu siç ilustron nga gara në shekullin e 19 mes fuqive të mëdha, në një botë që tashmë ishte multipolare dhe e ndërvarur (edhe më e ndërvarur sesa është sot, në përputhje me disa tregues të tillë si tregu ose GDP, ose rrjedhja e kapitalit³³).

Është e mirënjohur preferenca e BE-së për një formë bashkëpunimi të multipolaritetit, duke qenë se ajo promovon në mënyrë konstante një rend ndërkombëtar të bazuar në multilateralizëm sistemik dhe multilateralizëm, me rregulla bazë, të referuar në zhargonin e Brukselit si “multilateralizëm efektiv”. Kjo preferencë i kushtohet një strategjie afatgjatë për promovimin e paqes dhe bashkëpunimit multilateral, bazuar në një bindje të fortë historike, që multilateralizmi është rruga më e mirë drejt paqes.

Një reformë globale e multilateralizmit është qartazi në interes të BE-së, e cila “nuk do të fitonte asgjë dhe do të humbiste gjithçka, nëse ajo vepron në një botë të qeverisur nga fuqi të

³³ Shih Richard E. Baldwin, Philippe Martin, *Dy Valët e Globalizimit: Ngjashmëritë Sipërfaqësore, Ndryshimet Thelbësore*. NBER Working Paper 6904, Cambridge: National Bureau of Economic Research, Janar 1999.

paqëndrueshme, që konkurrojnë lojtarët e fuqishëm”³⁴. Por një reformë e multi-lateralizmit do të ishte, gjithashtu, në interes të përgjithshëm, sepse ne të gjithë kemi për të humbur gjithçka dhe asgjë për të fituar nga një botë të qeverisur nga loja e fuqive të paqëndrueshme, nëse ajo çon në një paralizë në zgjidhjen e kërcënimeve kryesore globale, të tilla si ndryshimi klimatik dhe përhapja bërthamore, për të gjithë sistemin që është njësoj i kërcënuar në fund.

Siç u tha në 2003 SSE: “në një botë të kërcënimeve globale, tregjeve globale dhe medias globale, siguria dhe prosperiteti ynë varen gjithnjë e më tepër nga një sistem multilateral efektiv.” Dhe kështu që “objektivi ynë është zhvillimi i një shoqërie të fuqishme ndërkombëtare, institucioneve ndërkombëtare mirë funksionuese dhe një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla. (...) Ne duam që organizatat ndërkombëtare, regjimet dhe traktatet të jenë efektive në përballjen e kërcënimeve të paqes ndërkombëtare dhe sigurisë, dhe kështu duhet të jenë gati të veprojnë kur thyhen rregullat e tyre.”³⁵

Megjithatë, pavarësisht faktit se BE-ja ndoshta favorizon një qasje multilaterale në marrëdhëniet ndërkombëtare³⁶, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha format e multilateralizmit janë të favorshme për BE-në. Për shembull, formimi i aleancave bilaterale dhe multilaterale *ad hoc* – veçanërisht ato me përjashtim të BE-së – mund të jenë potencialisht të dëmshme për Evropën; p.sh. një G-2 midis Kinës dhe Amerikës mund ta bëjë ShBA-në të orientohet në mënyrë të ngadaltë por të pashmangshme drejt Azisë, dhe ta bëjë Evropën gjithnjë e më tepër të parëndësishme.

Për më tepër, edhe kur bota është bashkëpunuese, është vetëm e parregullt, dhe në një mënyrë të pastrukturuar në të. Epoka jonë bashkëkohore mund të cilësohet si epoka e multi-multilateralizmit, e përkufizuar si forcimi i një procesi bashkëpunimi asimetrik dhe dinamik në të cilin (1) vendet po bëhen anëtare të një larmishmërie institucionesh të mbivendosura, duke krijuar një mozaik të ri të ndërveprimeve multilaterale; (2) shtetet takohen

³⁴Alvaro de Vasconcelos, “Multipolariteti Multilateralizues”, në Giovanni Grevi and Alvaro de Vasconcelos (ed.), *Partneritetet për Multilateralizëm Efektiv: Marrëdhëniet e BE me Brazilin, Kinën, Indinë, dhe Rusinë*. Chaillot Paper 109, Paris: EU Institute for Security Studies, Maj 2008, p. 24.

³⁵ *Një Evropë më e Sigurt në një Botë më të Mirë – Strategjia e Sigurisë Evropiane*, Bruksel, 12 Dhjetor 2003, p. 9.

³⁶ Ne themi “ndoshta” sepse retorika e BE promovon multilateralizmin efektiv, por veprimet e saj ndoshta mund të shihen nga palë të tjera – të drejta ose të gabuara – si jo besnike ndaj këtij parimi.

vazhdimisht në forume të shumta duke rritur kështu densitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare; (3) institucionet formale (p.sh. OKB) bashkëjetojnë me forumet informale (p.sh. G20) në një konfigurim të lëvizshëm dhe mbivendosës.³⁷ Megjithatë, edhe në epokën e multilateralizmit, bashkëpunimi ndërmjet aktorëve global mbetet i kushtëzuar dhe sigurisht jo automatik.

Kështu që, pyetja është e qartë: si të arrijmë në një rend multilateral efektiv? Sigurisht, nuk ekziston një përgjigje e qartë për këtë pyetje, por intuita jonë na tregon se duhet të fillojmë me atë që ne kemi tashmë, me një vëmendje të veçantë për zhvillimet më të fundit, duke përfshirë ngritjen e fundit të G20 nga niveli ministror në nivelin e krerëve të shteteve, shihet kryesisht si mesazh pozitiv për vendet në zhvillim, që tregon se ato konsiderohen tani si aktorë kryesorë në trajtimin e sfidave globale. Kjo njohje u mirëprit më tepër në New Dehli, Beijing dhe Brasilia.

Ky zëvendësim i G8 me G20 ishte disi pozitiv për BE-në, të paktën për dy arsye. Së pari, Brukseli është zyrtarisht anëtari i 20-të i G20, ndërsa ishte vetëm anëtari i 9-të i G8. Për disa, kjo mund të jetë vetëm një ngjyrim simbolik, ashtu si në të dyja rastet BE-ja ka të njëjtat “të drejta” dhe “detyrime”, ashtu si shtetet e tjera minus të drejtën e kryesimit dhe mbajtjes së samiteve, pra jo kapacitet për të formësuar plotësisht axhendën. Por në politikën ndërkombëtare, retorika dhe zgjedhja e fjalëve nuk janë asnjëherë të rastësishme; kështu që, në një mënyrë, G20 është ndoshta një njohje e “zhvillimit” ose e statusit të “fuqisë globale” të BE-së në çështjet ndërkombëtare po ashtu si dhe Kina, India ose Brazili.

Së dyti, BE-ja mund të tregojë një front më të bashkuar brenda G20 sesa brenda G8, sepse përvoja e mëparshme ka treguar që bashkëpunimi dhe koordinimi para-samitit ishte më i madh përpara tek G20 sesa samitet e G8.³⁸ Qëkur niveli i takimeve u ngrit në nivelin e krerëve të shteteve dhe u zgjerua axhenda, ekziston edhe një prirje më e dukshme drejt një bashkëpunimi më të brendshëm, e bazuar në idenë se një zë më i fuqishëm Evropian nevojitet në një forum ku Evropa përfaqëson vetëm

³⁷ Thomas Renard, *Një BRIC në Botë: Vendet në Zhvillim, Evropa, dhe Rendi që po Vjen*. Egmont Paper 31, Bruksel: Egmont – The Royal Institute for International Relations, Tetor 2009, f. 15.

³⁸ Skander Nasra, Dries Lesage, Jan Orbie, Thijs Van de Graaf, Mattias Vermeiren, *BE në Sistemin e G8: Vlerësimi i Përfshirjes së shteteve anëtare*. EUI Working Paper RSCAS 2009/45, San Domenico: European University Institute, Shtator 2009.

një të pestën e pjesëmarrësve (në krahasim me gjysmën në G8). Në të vërtetë përpara samitit të Pittsburgh-ut, BE-ja dha një shenjë pozitive kur lëshoi një komunikatë që theksonte “gjuhën e përbashkët” për Samitin, që përmbante gjithashtu deklarata mbi zhvillimin, ndryshimin klimatik dhe sigurinë energjitike, si p.sh. pë çështjet që pasqyronin një axhendë më të zgjeruar për G20. Një front Evropian më i fuqishëm dhe më i bashkuar do të dërgojë një sinjal pozitiv për partnerët tanë strategjikë.

Megjithatë, në përputhje me rolin e BE-së në G20, mbeten të hapura dy pyetje të rëndësishme:

(1) Kush do të përfaqësojë BE-në në Samitin e ardhshëm të G20 në Toronto, Qershorin e ardhshëm? Në fakt, Traktati i Lisbonës nuk është i qartë në lidhje me atë që do të zëvendësojë Presidentin e Komisionit dhe Presidencën e rradhës. Nëse është Van Rompuy ose Ashton që do të shoqërojnë José Manuel Barroso-n në Toronto, mund të dërgojë një mesazh simbolik. Por, cilido qoftë caktuar, duhet të forcojë bashkëpunimin Evropian brenda G20 dhe të sigurojë bashkëpunimin me EEAS, që duhet të marrë më shumë autoritet në çështjet e planifikimit të politikës së jashtme, duke përfshirë trajtimin e sfidave globale dhe partneritetet strategjike.

(2) Si mund ta lidhim G20 e re me një multilateralizëm efektiv? Në fakt, fuqizimi i G20 ishte një opsion i mirë, për të bërë të mundur që vendet në zhvillim të ndihen të përfshira në zgjidhjen e kërcënimeve të sotme globale. Kjo mund të jetë vetëm një fazë kalimtare, që varet nga një reformë më e gjerë e arkitekturës multilaterale globale. Nëse ne duam që Rusia, Kina, India ose Brazili t’u binden rregullave të OBT-së, FMN-së, dhe OKB-së, ne duhet të forcojmë (dhe eventualisht të riformësojmë) këto institucione. Megjithatë, një reformë e tillë do të kërkojë kohë dhe shumë vendime të rëndësishme politike. Ndërkohë, G20 mund të përdoret si një përfaqësues i organizatave formale, me kusht që të pranohet globalisht që është vetëm një rregullim i përkohshëm, dhe që nuk zëvendëson por plotëson Këshillin e Sigurimit të OKB.

Zhvillimi i G20, si një përfaqësues i përkohshëm për institucionet globale, është një përjashtim i domosdoshëm i “multilateralizmit efektiv”, sepse në botën e sotme ndërpolare shumica e çështjeve janë të ndërlidhura globalisht, duke kërkuar kështu bashkëpunim më të madh dhe koordinim midis vendeve në mbarë botën. Për shkak të kësaj përbërje (të gjitha vendet me rëndësi të veçantë janë të përfaqësuara) G20 themelon aktualisht forumin më të mirë të mundshëm për të diskutuar në mënyrë efektive kërcënimet globale dhe mënyrat e zgjidhjes së

tyre. Megjithatë, BE-ja duhet të sigurohet se vendimet e marra gjatë G20 pajtohen me rregullat ndërkombëtare dhe janë të lidhura dhe të zbatuara përmes organizatave ndërkombëtare të përhershme, si p.sh. agjencitë e OKB.

Përfundim

Jean-Paul Sartre shkroi se “ferri janë të tjerët” (“l’enfer c’est les autres”), duke nënkuptuar se ne e përkufizojmë identitetin tonë bazuar në perceptimet dhe marrëdhënien tonë me palë të tjera. Nëse Sartri do të vëzhgonte BE-në e sotme, që po bëhet gjithnjë e më pak e rëndësishme në sytë e të tjerëve të saj domethënës, ai do të mund të arrinte mjaft mirë në konkluzionin se ai ka përshkruar padashur pozicionin e BE-së në sistemin ndërkombëtar...

Por e ardhmja bazohet në shpresë, jo në dëshpërim. BE-ja duhet të fillojë të veprojë në mënyrë strategjike tani, në mënyrë që të gjejë vendin e saj në një botë të karakterizuar nga lëvizja jo simetrike e multipolaritetit dhe multi-multipolarizmit. Sigurisht, nëse BE-ja dëshiron realisht të kalojë nga të qenit një aktor global (e përcaktuar nga prezenca globale), për të qenë fuqi globale (e përcaktuar nga ndikimi global), asaj i duhet një strategji globale. Asaj i duhet një strategji kyçe.

Kjo strategji do të kushtëzohet në mënyrë të pashmangshme nga mjedisi global (ndërpolariteti), por nuk duhet të varet tërësisht nga ky mjedis, p.sh. strategjia jonë duhet të synojë formësimin e mjedisit global aq sa ai duhet të formësohet prej saj dhe të shmangë kurthin e reaktivitetit të thjeshtë që ka përcaktuar politikën e jashtme të BE-së deri më tani. Me fjalët e Gjen. Brig. Jo Coelmont, “ndërsa BE-ja është duke luajtur ping-pong, të tjerët janë duke luajtur shah”. Me Van Rompuy dhe Ashton, Evropës iu ofrua një Mbret i ri dhe një Mbretëreshë e re. Kështu që le të luajmë shah!

Thomas Renard është Kërkues i Lartë Shkencor dhe Sven Biscop është Drejtor në Programin e Sigurisë dhe Qeverisjes Globale në Egmont.

Florence Gaub

NATO: PAQERUAJTJA NË TOKËN E SHENJTË? NJE STUDIM FIZIBILITETI

Presidenti Klinton, në vitin 2000, propozoi praninë e një force ndërkombëtare për të mbikëqyrur sigurinë, pas marrëveshjes së paqes Izrael-Palestinë³⁹. Sipas Thomas Friedman, kjo mund të jetë një forcë e NATO-s. Ideja e tij u përtëri në 2008 nga Këshilltari për Sigurinë Kombëtare i Presidentit Obama, James Jones⁴⁰. Propozimi i një prezence të NATO-s në Lindjen e Mesme nxiti një debat që deri tani është rrotulluar rreth një morie aspektesh: avantazhet dhe disavantazhet, koordinimi, aktorët e një angazhimi të tillë të NATO-s⁴¹, parakushtet e mundshme dhe rrjedhojat, dhe ka nxitur gjithashtu një debat në Gjermani, nëse administrimi i patrullimeve në afërsi të Izraelit do të pajtohet me të kaluarën e Gjermanisë⁴². Megjithatë,

³⁹ PLO Negotiations Affairs Departament, "The Clinton Parameters", http://www.nad-plo.org/inner.php?view=nego_nego_clinton_nclinton&title=security

⁴⁰ Thomas L. Friedman, "How about sending NATO somewhere important?", New York Times, September 4, 2001, <http://www.nytimes.com/2001/09/04/opinion/foreign-affairs-how-about-sending-nato-somewhere-important.html>; Kevin Peraino, "NATO in the west Bank", Newsweek, December 6, 2008, <http://www.newsweek.com/id/172638>

⁴¹ Robert Kagan, "Can NATO patrol Palestine?", Washington Post, April 18, 2002, <http://www.newamericancentury.org/kagan-041802.htm>; Amir Oren "Divided they stand", Haaretz, December 3, 2006, http://www.nato.int/med-dial/articles/english/2006/061203_en_riga_israel_haaretz.pdf; Robert Dreyfuss, "NATO in Palestine? Not a good idea", The nation, December 17, 2008; http://www.thenation.com/blogs/dreyfuss/390581/nato_in_palestine_not_a_good_idea. Ted Galen Carpenter, "NATO's West Bank nightmare", National Interest, February 20, 2008.

⁴² Zeit Online: Nahost-Konflikt: Deutsche Soldaten Fur Gaza-Friedenstruppe? January 8, 2009; <http://www.zeit.de/online/2009/02/gaza-deutsche-soldaten>

çështjet praktike të fizibilitetit, objektivat e fushatës dhe implikimet e sigurisë nuk u ngritën asnjëherë, sikur këto çështje do të zgjidheshin vetë, sapo marrëveshja e munguar e paqes të ishte në tavolinë. Por gjërat nuk janë kaq të thjeshta, dhe siç na ka mësuar Afganistani, sigurimi i një zone të mundshme armiqësore, veçimi i kundërshtarëve dhe ndërtimi i shtetit, janë çështje që NATO është ende duke i mësuar. Ky shkrim argumenton që një mision i tillë, edhe pse do te perpiqet për të qenë i suksesshëm, ka shumë mundësi të dështojë. Megjithëse ideja është tërheqëse për disa që duan të provojnë kapacitetet paqeruajtëse globale të NATO-s, shanset janë që kjo përpjekje nuk do të funksionojë dhe do të prishi imazhin e NATO-s në shumë drejtime. Aktualisht, NATO nuk është gati të ndër marrë këtë lloj misioni, dhe mund të mos jetë kurrë.

Analiza e kujdesshme e implikimeve të një force të mundshme stabilizuese të NATO-s në Palestinë (duke përjashtuar angazhime të mundshme në Golan ose në Liban, sepse ato do të tejkalonin qëllimin e këtij shkrimi) – meqenëse, siç argumenton analiza e mëposhtme, një forcë e thjeshtë paqeruajtëse nuk do të jetë zgjidhja, – është thelbësore për sukses; keqkuptimet dhe përfundimet e nxituara mund të jenë katastrofike. Ky shkrim përpiqet të hedhë dritë mbi fizibilitetin operativ (për të mos thënë rreziqet) e një misioni të tillë, dhe nëse ai mund të arrihet me një numër të arsyeshëm trupash brenda një intervali kohor të arsyeshëm, dhe arrin në një përfundim negativ. Në supozimin që sukcesi do të jetë e vetmja alternativë nëse NATO dëshiron të angazhohet në zgjidhjen e një konflikti më të vjetër se vetja, analiza përqendrohet më tepër tek ana operative sesa në fizibilitetin politik. Arsyeja për këtë nuk është shpërfillja e aspekteve politike, të cilët janë me sa duket vendimtare: qëllimi i këtij shkrimi është ana operative, dhe tashmë ka shumë publikime që mbulojnë kuadrin politik të paqes në Lindjen e Mesme.

Gjërat e mira vijnë treshe: Parakushtet për t'u përmbushur

Në Janar 2009, ish-Sekretari i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer përsëriti që tri parakushte duhet të përmbushen para se të mendohet për një rol të NATO-s në Palestinë. Këto janë: një marrëveshje paqeje bashkëkohore, miratimi i palëve dhe një mandat i Kombeve të Bashkuara – pa përmendur konsensusin

e NATO-s⁴³. Ndonëse është e vërtetë që perspektivat janë të pashpresa që këto kushte mund të përmbushen në ndonjë moment së shpejti, apo ndonjëherë, megjithatë është e arsyeshme për ta çuar diskutimin një hap më tej, si dhe përfytyrimin e një situatë në të cilën ato janë përmbushur dhe NATO e pranon një mision të tillë. Si do të duket kjo situatë?

Për shkak të analizës, ky shkrim ngrihet mbi supozimin që Marrveshja e Oslos, si dhe Direktivat, janë pikënisjet për një zgjidhje dy-shtetërore. Shumë prej pjesëve të lëvizshme të këtij skenari tepër kompleks duhet të fiksohen, në një farë mënyre, për të lejuar një analizë të arsyeshme. Në praktikë, kjo do të thotë që ky shkrim (përveç parakushteve të sipërpërmendura të shtruar nga ish-Sekretari i Përgjithshëm) supozon një situatë që është rasti i mëposhtëm: a) Izraeli tërhiqet plotësisht nga Bregu Perëndimor dhe Gaza; b) vendbanimet izraelite, siç janë ato sot, të mbeten të pandryshuara për momentin; c) ekziston një qeveri e bashkuar palestineze; d) kufijtë midis dy shteteve janë të hapura dhe njerëzit mund dhe do të lëvizin lirisht midis Izraelit dhe Palestinës. Analiza bazohet në këtë strukturë dhe lë jashtë elementë të tjerë të mundshëm (p.sh. shembjen e vendbanimeve dhe mbylljen e plotë të kufirit, kthimin e refugjatëve) për arsyen e thjeshtë se marrëveshjet e kaluara ose e shtynin zgjidhjen e tyre, ose vendosnin për të mos i përmendur ato. Zgjidhja e këtyre çështjeve nuk do të ndikojë në rolin e NATO-s. Megjithatë, lënia e tyre jashtë kësaj analize nuk nënkupton që ato nuk janë çështje të rëndësishme.

Kjo strukturë nuk është domosdoshmërisht struktura përfundimtare dhe më e përshtatshme, por vendos një pikënisje që bazohet mbi një fakt të kryer sesa në ëndërra me sy hapur. Me pak fjalë, objektivi i misionit do të jetë monitorimi i marrëveshjes së paqes dhe në fund mbikëqyrja e krijimit të një shteti të qëndrueshëm Palestinez pranë Izraelit, që mund të marrë përgjegjësitë e sigurisë së vet. Lartësitë e Golanit, si dhe zona e debatuar e fermave të Shebaa-s, janë përjashtuar nga kjo analizë.

Skenari i rastit më të mirë dhe i rastit më të keq

Një mision i NATO-s në Palestinë mund të përballet me skenarin e rastit më të mirë, dhe të rastit më të keq – me një

⁴³ Fjalimi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s në një event të përbashkët organizuar nga Instituti për Studime të Sigurisë Kombëtare dhe Forumi Atlantik i Izraelit, January 11, 2009, http://www.nato.int/cps/en/SID-FA832B39-70CC352E/natolive/opinions_496673.htm?selectedLocale=en

sërë alternativash të ndërmjetme, të bashkuara me një shkallë territoriale minimaliste dhe maksimaliste. Skenari i rastit më të mirë supozon një mjedis mjaft të paqtë pas marrëveshjes së paqes, duke përfshirë një popullsi miqësore dhe shmangien e dhunës nga ana e grupeve militante palestineze. Një mjedis i tillë tolerant do të shkaktojë kërcënime më të vogla.

Megjithatë, skenari i rastit më të keq dhe më i mundshmi është refuzuar shpesh nga diskutimi, sepse është supozuar që një marrëveshje paqeje paraprake do ta përjashtojë efektivisht atë. Kjo është e rrezikshme, duke marrë parasysh faktin që negociatat e kaluara të paqes ndërmjet Izraelitëve dhe Palestinezëve kanë ngecur në pika të ndjeshme, pavarësisht marrëveshjeve të mëparshme. Dështimi i procesit të paqes mund të çojë pa dyshim në një mjedis armiqësor dhe gjysmë-tolerant, duke përfshirë mundësinë e një serie sulmesh dhe të një Intifade të tretë, që NATO-ja nuk mund thjesht të rrijë mënjanë dhe të kontrollojë nëse trupat e saj janë të pozicionuara. Angazhimi kundër palestinezëve mund të ndikojë seriozisht në pranimin e misionit në terren. Gjithashtu, terreni në Palestinë mund ta bëjë mjedisin gjysmë-tolerant dhe më të rrezikshëm në disa mënyra: jo vetëm se shumica e territorit është e dendur dhe urbane, por ekzistojnë gjithashtu kushte perfekte për kontrabandë armësh, vende për t'u fshehur, si dhe për rekrutimin e luftëtarëve. Organizatat militante me eksperiencë të madhe në luftën guerilase e njohin zonën dhe se si të luftojnë në të, më mirë sesa trupat e NATO-s. Kështu, duhet të përgatitet një mision realist i NATO-s për të dy skenarët (dhe për gjithçka tjetër), ose do të jetë i destinuar të dështojë.

Maksimaliste kundrejt Minimaliste

Skenarët për rastin më të mirë dhe më të keq duhet gjithashtu të konsiderohen në kontekstin e dy skicave territoriale të ndryshme, njëra maksimaliste dhe tjetra minimaliste. Qasja minimaliste do të përfshijë thjesht Bregun Perëndimor dhe Gazën, ajo maksimaliste do t'i shtojë asaj territorin e Izraelit. Natyrisht, zgjedhja e maksimalistes do të kërkonte më shumë trupa dhe do të çojë në një situatë më komplekse. Qasja maksimaliste është e pamundur politikisht, sepse miratimi i Izraelit për një mision të tillë duket i paimagjinueshëm.

Sidoqoftë, nga ana tjetër, qasja maksimaliste do të garantonte një rrjet sigurie më të ngushtë, veçanërisht në parandalimin e përplasjeve të mundshme midis forcave të sigurisë izraelite,

izraelitëve arabë dhe palestinezëve, duke kontribuar kështu në arritjen e objektivave të misionit. Megjithëse qasja maksimaliste është e pamundur politikisht, ne do të shqyrtojmë dy alternativa, thjesht sepse siguria e Izraelit dhe Palestinës janë kaq të ndërthurura sa që është e pamundur të konsiderojmë njërin pa tjetrën.

Në varësi të shtrirjes territoriale të misionit si dhe tolerancës së mjedisit, detyrat e forcave të NATO-s do të jenë mjaft të ndryshme. Në një mënyrë apo tjetër, situata do të jetë e ndërvarur për arsyen e thjeshtë se siguria e Izraelit dhe Palestinës kanë qenë, dhe do të vazhdojnë të jenë, shumë të ndërlidhura. Sipas qasjes minimaliste, në një mjedis tolerant, miqësor detyrat e misionit do të përfshijnë mbikëqyrjen e tërheqjes së forcave të Izraelit, patrullimin e kufijve të vendosur rishtasi të Palestinës (467 km kufi tokësor), të vepruarit si xhandarmëri (*gendarmerie*), parandalimin e rebelimeve, asistencën e forcave të sigurisë palestineze dhe garantimin e sigurisë së kolonëve izraelitë në Bregun Perëndimor. Në vetvete, zgjidhja minimaliste përmban kështu disa elementë me të cilat NATO është familjarizuar, si kontrolli i kufirit dhe asistencë e forcave lokale. Ky skenar implikon detyrat e policimit që do të përfshijnë pajisjen me një mbulojë sigurie, nën të cilën Palestina mund të zhvillojë strukturën e saj të sigurisë dhe të krijojë veten si shtet. NATO do të vendosë, apo do të ruajë, ligjin dhe rendin, do të mbrojë popullsinë dhe do të garantojë lirinë e lëvizjes, dhe ndoshta do të çmobilizojë njësitë paraushtarake. Ajo do të ndihmojë në monitorimin e pikave të kalimit të kufirit, pikave të kontrollit, portet dhe korridorin e mundshëm midis Bregut Perëndimor dhe Gazës. Gjithashtu, ajo mund të mbikëqyrë shembjen e vendbanimeve Izraelite, nëse vendoset kjo.

Megjithatë, zgjidhja minimaliste në një mjedis armiqësor, gjysmë-tolerant, mund të shkaktojë rebelime ose të tjera kërcënime më ekstreme të paqes së sapo vendosur. Një skenar i tillë do të rrezikonte jo vetëm detyrat ekzistuese, por i shton kësaj liste masat kundër rebelëve. Ndonëse NATO mund të përdorë eksperiencën në Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë kur bëhet fjalë për forcimin e paqes pas-konfliktit, nuk ka aspak eksperiencë kur bëhet fjalë për një shpërthim të mundshëm të dhunës midis dy fraksioneve që supozohet të ndajnë, në këtë rast izraelitët dhe palestinezët ose palestinezët dhe palestinezët. Në fakt, NATO asistoi në momente dhune në Kosovë midis shqiptarëve dhe serbëve, ku megjithatë fuqia dhe forca goditëse relative e dhunës nuk është e krahasueshme me situatën në Izrael/Palestinë. Megjithëse ekziston një ngjashmëri strukturore

me Bosnjën, NATO-s asnjëherë nuk iu desh të merrte masa për dhunën midis fraksioneve të kundërta dhe, si rrjedhim, nuk ka asnjë eksperiencë në një situatë të tillë. Megjithatë mund të përbëjë skenarin më të keq të mundshëm, duhet të merren parasysh mundësia e përplasjes midis dy grupeve antagoniste dhe kundërshtimet ndaj përzgjedhjes së NATO-s si një garantues force në këtë mjedis. Në rastin e qasjes maksimaliste dhe një mjedisi tolerant, roli i NATO-s në territorin Izraelit do të ketë nevojë, veç detyrave të përmendura më sipër, për patrullim të përbashkët si një masë e sigurisë së dukshme, dhe ndoshta sigurimin e përbashkët të kolonëve Izraelitë në Bregun Perëndimor.

Megjithatë, situata mund të keqësohet në një mjedis gjysmë-tolerant. Dikush nuk duhet thjesht të supozojë që një traktat paqeje, së pari, do t'i japë fund të gjithë dhunës; përkundrazi, marrëveshja e Oslos, për shembull, nuk fitoi mbështetje të plotë nga ana Palestineze dhe Izraelite, dhe sulmet mbi Izraelitët vazhduan edhe pas nënshkrimit në 1993 dhe negociatave të vazhdueshme⁴⁴. Situata sot, shumë larg marrëveshjeve si ajo e Oslos, duket mjaft e zymtë, me 38,9% të izraelitëve dhe 32.2% të palestinezëve që deklarojnë se ata janë kundër zgjidhjes me dy shtete (dy-shtetërore), e cila mund të çojë në dhunë politike sapo kjo zgjidhje të vihet në jetë⁴⁵.

Sulmet vetëvrasëse (kamikaze) në Izrael kanë shoqëruar në të kaluarën ndryshimet e humorit politik dhe kanë çuar disa herë në ndërprerjen e bisedimeve për paqen. Mundësia që ato të ndodhin nuk mund të përjashtohet për disa arsye. Këto përfshijnë eksperiencën e Intifadës së dytë, gjatë të cilës sulmet vetëvrasëse (kamikaze) ishin një mjet i përdorur gjërësisht – 140 sulme të tilla midis 2000 dhe 2007 shkaktuan 542 persona të vrarë vetëm në Izrael, duke penguar seriozisht procesin e paqes⁴⁶ – krimet u kryen si nga izraelitët arabë ashtu dhe palestinezët. Kështu që, edhe një mbyllje përfundimtare e kufirit nuk mund të konsiderohet një garanci për sigurinë kundër sulmeve kamikaze.

⁴⁴ Shembujt janë Masakra e Beit Lid në një kryqëzim në Izrael në 1995, duke vrarë 21 vetë, e cila u duartrokit nga publiku Palestinez, ose sulmi në Dizengoff Center (përpara një marketi) në 1996.

⁴⁵ Harry S. Truman Institute for Peace: Israeli-Palestinian Poll N. 28 June 2009, <http://www.truman.huji.ac.il/polls.asp>

⁴⁶ Israel Ministry of Foreign Affairs: Suicide and other bombing attacks in Israel since the Declaration of Principles (Sept. 1993), <http://www.mfa.gov.il/MFA/Terrorism-%20Obstacle%20to%20Peace/Palestinian%20terror%20since%202000/Suicide%20and%20Other%20Bombing%20Attacks%20In%20Israel%20Since>

Gjithashtu, kufijtë e hapur siç ishin para Intifadës së Dytë çuan në 150,000 palestinezë që punonin përditë në Izrael dhe tek vendbanimet⁴⁷. Megjithëse sot ky numër ka rënë në 10,000, pritet të rritet pas marrëveshjes së paqes në mënyrë që të kontribuojë në ekonominë e Palestinës dhe Izraelit dhe të promovojë më tej marrëdhëniet paqësore. Të dy ekonomitë ishin, dhe janë, shumë të ndërthurura. Megjithatë, kjo situatë do të rrisë potencialin e ekspozimit të Izraelit. Kjo vajtje dhe ardhje, e shoqëruar me ndryshimin e humorit politik – p.sh perceptimi negativ i marrëveshjes së paqes, zhgënjimi nga zhvillimet që nga traktati i paqes, etj. – ose mospajtimi i përgjithshëm në radhë të parë me marrëveshjen, do të ndikojë pa dyshim në sigurinë brenda Izraelit dhe jo vetëm në territoret palestineze.

Ajo që është më e rëndësishme, përsëritja e sulmeve vetëvrasëse në të kaluarën ndikuan seriozisht në opinionin publik në Izrael dhe e çuan procesin e paqes në ndërprerjen përfundimtare. Kështu që, parandalimi i këtyre sulmeve do të jetë mjaft lart në axhendën e NATO-s, në kuadër të një misioni të tillë. Prandaj, një qasje maksimaliste bashkëkohore dhe më e gjerë do të jetë më e rekomandueshme, sepse ajo do t'i jepte NATO-s mundësinë për t'iu kundërpërgjigjur sulmeve të tilla në mënyrë më efektive dhe të veprojë me besim si një agjent i pavarur midis palëve.

Vendosje, Vendosje, Vendosje

Zona e Operacioneve të mundshme për një mision të NATO-s është jashtëzakonisht e ndërlikuar. Në thelb, misioni do t'i duhet të mbulojë dy, ndoshta tri zona shumë të ndryshme: Gazën dhe Bregun perëndimor në rastin e një skenari minimalist, dhe Izraelin përveç dy të tjerave në një skenar maksimalist. Të tri pjesët kërkojnë një planëzim shumë të ndryshëm. Lëvizja e lirë e njerëzve do të kontribuojë në kompleksitetin e situatës. Me pak fjalë, territori është ndërlikuar nga a) përzierja e popullsisë të Izraelit dhe Palestinës, Arabëve dhe Hebrenjve, në të gjithë territorin, b) kampe të mëdha refugjatësh dhe c) qytete të mëdha.

Në radhë të parë, Gaza ka një popullsi prej 1.4 milion palestinezë, më shumë se një e treta e të cilëve, p.sh 500.000, jetojnë në kampet e refugjatëve. Vetëm pesë kampet më të mëdha

⁴⁷ International Monetary Fund: West Bank and Gaza: Economic performance and reform under conflict conditions, Washington 2003, p. 14 <http://www.imf.org/external/pubs/ft/med/2003/eng/wbg/wbg.pdf>

janë sa qytetet Evropiane si Calais (Kale) ose Ekster, duke strehuar midis 60.000 dhe 110.000 njerëz. Dendësia e popullsisë është një nga më të lartat në botë, Gaza është dyfishi i madhësisë së Lihtenshtejnit dhe me 40 herë popullsinë e tij⁴⁸. Nuk ka më kolonë izraelitë në Gaza. Bregu Perëndimor përbëhet nga 2.4 milion palestinezë, nga të cilët afërsisht 8% (190,000) jetojnë në kampet me madhësinë e qyteteve të vogla deri në 23.600 njerëz⁴⁹. Të shpërndarë kudo në Bregun Perëndimor, 300.000 kolonë Izraelitë jetojnë në 150 vendbanime të cilat llogariten si 12,5% e popullsisë së përgjithshme të Bregut Perëndimor. Nga këto vendbanime, pesë kanë më shumë se 10.000 banorë⁵⁰. Në të kaluarën, kolonët kanë qenë shënjestra e sulmeve palestineze⁵¹, dhe anasjelltas, autorët e sulmeve kundër palestinezëve. Vetëm në 2008, kanë ndodhur 290 incidente të dhunshme drejtuar kolonëve në Bregun Perëndimor.⁵² Dy aspekte të lidhura me sigurinë shfaqen nga prezenca e kolonëve izraelitë në Bregun Perëndimor – duke supozuar që ato nuk do të zhvendosen në kuadër të një marrëveshje. Së pari, siguri i vendbanimeve do të jetë prioritet kryesor për të mos ndikuar opinionin publik të Izraelit në lidhje me marrëveshjen e paqes. Së dyti, ekstremistët izraelitë duhet të pengohen nga drejtimi i sulmeve në Palestinë.

Përzierja e popullsisë nuk përfundon këtu. Izraeli, më i madhi nga të tre territoret që mund të ketë nevojë të sigurohet, është i shpërndarë në popullsinë arabe. Ai ka 7.2 milion banorë, 20% e të cilëve, p.sh. 1.45 milion, janë me origjinë arabo-paltestineze. 52% e tyre janë grumbulluar në rajonin verior kodrinor të Izraelit, ndërsa pjesa tjetër jeton në lokalitete të tjera në të gjithë Izraelin.

⁴⁸ <http://www.un.org/unrwa/publications/Gaza.html>; <http://www.un.org/unrwa/refugees/gaza.html> Gerard -Francois Dumont: "De la population de Gaza a une prospective geopolitique", Outre Terre, Revue francaise de la geopolitique, 2009/2, n.22 pp.123-131.

⁴⁹ <http://www.un.org/unrwa/refugees/westbank.html>

⁵⁰ Foundation for Middle East Peace (2008): http://www.fmep.org/settlement_info/settlement-info-and-tables/stats-data/settlements-in-the-west-bank-1; Haaretz: IDF More than 300,000 settlers live in West Bank, July 27, 2009 <http://www.haaretz.com/hasen/spages/1103125.html>

⁵¹ Washington Post: "Young settler killed in West Bank attack", April 3, 2009. <http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2009/04/02/AR2009040200469.html>

⁵² United Nations: Report of the Commissioner-General of the United Nations relief and Works Agency for Palestine Refugees in the Near East, January 1- December 31 2008, General Assembly Official Records, Sixty-fourth Session, Supplement No. 13, New York 2009, p. 3. <http://www.un.org/unrwa/publications/index.html>

Nazareti për shembull përbëhet afërsisht nga 40,000 arabë dhe 25,000 izraelitë⁵³. Një prezencë e madhe arabësh mund të gjendet edhe në Haifa. Popullsitë e Izraelit si dhe ato të Bregut Perëndimor, janë shumë të ndërthurura dhe të vështira për t'u ndarë. E vetmja zonë që është kryesisht homogjene në termat e popullsisë është Gaza, e cila megjithatë paraqet shqetësime të tjera sigurie.

Prania e kampeve të mëdha dhe afatgjatë të refugjatëve të ngritur brenda Gazës, dhe deri diku në Bregun Perëndimor gjithashtu, meriton vëmendje të veçantë. Për shkak të strukturës së tyre delikate dhe në thelb të përkohshme, kampet e refugjatëve janë përgjithësisht në pararojë kur dhuna, krimi dhe anarkia marrin kontrollin. Atje ku shteti nuk funksionon siç duhet, kampet e refugjatëve mund të shndërrohen lehtësisht në strehëza të sigurta për aktivitetin kriminal, për depot e armëve dhe rekrutimin e grupeve të armatosura. Grupet e armatosura mund të përzihen lehtë me popullsinë e kampit, duke e bërë të vështirë veçimin e tyre. Ky është rasti veçanërisht në kampet palestineze që jo vetëm janë të mëdhenj në madhësi, por deri tani përbëjnë formën kryesore të jetesës për 18% të palestinezëve. Standardet e ulëta të jetesës shoqëruar me papunësinë – 42% e banorëve të Gazës janë të papunë⁵⁴ – i bëjnë kampet e refugjatëve, vendin perfekt të rekrutimit për grupet ekstremiste që mund të përpiqen të pengojnë procesin e paqes. Kështu, këto kampe përbëjnë një burim potencial shqetësimi për çdo forcë sigurie në vend. Kjo keqësohet më tej nga dendësia e skajshme e popullsisë në Gaza, shoqëruar me shtëpitë njëkatëshe, të cilat e vështirojnë lëvizjen e forcave të sigurisë përmes rrugëve të ngushta dhe të përdredhura. Përveç kësaj, edhe mungesa e familjaritetit me terrenin e bën të vështirë për të huajt, për të dalluar anëtarët e mundshëm të grupeve të armatosura nga popullata vendase.

Drita të shndritshme, qytet i madh

Qytetet janë përgjithësisht një burim i veçantë shqetësimi ushtarak për shkak të terrenit të tyre kompleks, numrit të lartë

⁵³ Central Bureau for Statistics: Israel in figures, 2008 http://www.cbs.gov.il/reader/cw_usr_view_folder?ID=141

⁵⁴ United Nations: Report of the Commissioner-General of the United Nations relief and Works Agency for Palestine Refugees in the Near East, January 1- December 31 2008, General Assembly Official Records, Sixty-fourth Session, Supplement No. 13, New York 2009, p. 2. <http://www.un.org/unrwa/publications/index.html>

të viktimave përgjatë historisë gjatë operacioneve në terrenin urban, nevoja për një numër më të madh ushtarësh për të mbuluar një zonë më të vogël, dhe mundësitë e shumta për vende “të fshehta” për rebelët dhe armët⁵⁵. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e Gazës, ku lufta guerilase urbane ka qenë forma mbizotëruese e luftës në dekadën e fundit⁵⁶. Rebelët e mundshëm i njohin mjetet dhe zonën e tyre, ndërsa forcat e NATO-s kanë eksperiencë të kufizuar në luftën guerilase urbane dhe shërbim sekret ushtarak të vogël në lidhje me qytetet palestineze apo izraelite. NATO do të mbështetet ose në burimet e Izraelit ose do të krijojë vetë një rrjet informatorësh, e cila duket jopraktike dhe e kushtueshme.

Izraeli ka 14 qytete me mbi 100.000 mijë banorë, nga të cilët të paktën pesë kanë mbi 200,000. Jeruzalemi është një rast i veçantë, që përfshin 750.000 banorë. Ai është i ndarë midis lindjes dhe perëndimit, arabëve dhe izraelitëve, dhe përbënte mollën e sherrit në negociatat e shkuara. 65% e banorëve të tij janë izraelitë, që jetojnë kryesisht në Jeruzalemin Perëndimor, megjithëse Jeruzalemi Lindor tani përfshin 190.000 izraelitë gjithashtu⁵⁷. Qyteti i Gazës ka mbi 410.000 banorë; në Gaza gjendet gjithashtu Khan Junis, me 180.000 banorë. Tri qytete në Bregun Perëndimor kanë rreth 120.000 dhe 166,000 banorë.

Çfarë sugjerojnë këto shifra? Forca e NATO-s nuk mund të veprojë thjesht si një mur ndarës pasiv midis dy palëve dikur kundërshtarë. Vendbanimet janë të ndërthurura, më përjashtim të rripit të Gazës, dhe do të vazhdojnë të jetë kështu edhe pas një marrëveshje paqeje. Gjithashtu, gjenden mbi 19 qytete me më shumë se 100,000 banorë. Në total, 4.2 milion banorë në këtë zonë jetojnë në qytete të këtij lloji, me më shumë se gjysëm milioni që jetojnë në kampe refugjatësh. Kjo në vetvete nënkupton dy gjëra: e para, depot e fshehta të armëve janë të vështira për t'u lokalizuar pa e njohur vendin, dhe kontrabanda e armëve lehtësohet shumë. Masat për çarmatimin do të ishin edhe më të vështira për t'u zaptuar sesa janë ato tani, në rrethana më të favorshme. E dyta, në rast të një Intifade të tretë

⁵⁵ Robert F. Hahn II & Bonne Jezior: “Urban warfare and the urban warfighter of 2025”, Parameters, Summer 1999, pp. 74-86.

⁵⁶ Sergio Catignani: “The strategic impasse in low-intensity conflict: The gap between Israely counter-insurgency strategy and tactics during the Al-Aqsa intifada”, The journal of strategic studies, Vol. 28, No.1, February 2005, p. 57.

⁵⁷ Foundation for Middle East Peace (2007); <http://www.fmep.org/> http://www.fmep.org/settlement_info/settlement-info-and-tables/stats-data/settlements-in-east-jerusalem

(p.sh nëse pjesa tjetër e procesit të paqes nuk zhvillohet siç shpresohet), operacionet urbane apo operacionet në kampet e refugjatëve, kërkojnë një njohuri që forcat e NATO-s sapo kanë filluar t'i përvetësojnë, dhe është akoma shumë e pazhvilluar⁵⁸. Forcat izraelite janë ndoshta të vetmet të mirëpërgatitura për rebelimet në qytetet palestineze dhe kampet e refugjatëve, por ndërhyrja e tyre e ashpër ka shkaktuar shpesh edhe më shumë dhunë. Problemi më i vështirë për t'u përballur do të ishte Jeruzalemi, pavarësisht se çfarë është rezultati përfundimtar i negociatave mbi statusin e qytetit, disa do të mbeten të pakënaqur. Kështu, Jeruzalemi vetë do të kërkojë një forcë parandaluese mjaft të madhe – e cila në këmbim mund të përballet me zemërimin e madh të disa kolonëve izraelitë në Jeruzalemin Lindor.

Pas një marrëveshje të mundshme paqeje, situata mund të përkeqësohet më tej nga prania e madhe e OJQ-ve dhe organizatave të Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, NATO-s i duhet të patrollojë kufijtë e Palestinës së re, e cila llogaritet me rreth 404 km e kufirit tokësor të Bregut Perëndimor (307 km me Izraelin dhe 97 km me Jordaninë) dhe 63 km për Gazën (11 km me Egjiptin, 52 km me Izraelin). Kjo nuk përfshin korridorin që mund të lidhë të dy territoret dhe që do të jetë midis 30 dhe 50 km i gjatë (60 – 100 km nëse do të jenë dy), në varësi të vendndodhjes së tij. Sipas skenarëve të ndryshëm, ky korridor mund të jetë një tunel, një urë ose një rrugë e mbyllur – secili variant implikon ndjeshmëri të lartë sigurie përderisa ai mund të bllokohet lehtësisht, duke mbyllur linjën midis dy gjysmave që do të përbëjnë Palestinën.

Implikimet për NATO-n

Disa përfundime mund të nxirren nga faktet e përshkuara më sipër. Së pari, territori, megjithëse me madhësi të vogël, është jashtëzakonisht i ndjeshëm politikisht dhe zakonisht shfaq reagime të menjëhershme ndaj turbullimeve të sigurisë. Përpjekjet e kaluara të paqes në Izrael/Palestinë dështuan kryesisht për shkak të shqetësimeve për sigurinë. Në këtë kontekst do të duhet të priset rrethi vicioz. Siç ka treguar eksperiencia, do të ishte e pamundur të arrihej një marrëveshje paqeje gjithëpërfshirëse, më tepër, një zgjidhje graduale që

⁵⁸ Gerald T. Sajer: "Control: A strategy for counterinsurgency", Of interest, Strategic Studies Institute, February 14, 2008.

zhvillohet me një avancim hap-pas-hapi të paqes duket më e mundshme. Kështu, do të ketë një fazë tranzicioni veçanërisht të rrezikshëm për shkak të sigurisë së dobët.

Prandaj, do të ketë pak vend për dështim të rastësishëm. Një sërë sulmesh të suksesshme, me sa duket, do të pengonin procesin e paqes, siç ka ndodhur në të kaluarën. Duhet pranuar se një mision i NATO-s në Palestinë mund të merret peng lehtësisht nga grupet militante dhe se siguria absolute është e paarrtshme, pavarësisht të qenit një qëllim politikisht tepër i rëndësishëm për të dyja palët. Kështu, ka shumë pak kapacitete kur bëhet fjalë për personelin, financimin dhe zgjedhjen e pajisjeve. Në thelb, NATO në Palestinë duhet të konsiderohet si një mision ku implikimet për dështim janë edhe më të mëdha se ato të pothuajse çdo misioni tjetër. Kjo është një konsideratë e rëndësishme për t'u marrë parasysh kur të shihen rekomandimet e mëposhtme.

Madhësia ka rëndësi

Pyetja e parë për t'u bërë ka të bëjë me faktin se çfarë madhësie duhet të ketë një forcë e përshtatshme. Përpjekja për të kaluar me minimumin e domosdoshëm do të jetë receta për dështim. Mësimet e nxjerra nga rastet si Timori Lindor, Kosova dhe Bosnje-Hercegovina kanë treguar që variabli kyç këtu nuk është as madhësia e territorit, as numri i mundshëm i kundërshtarëve, por popullsia në terren.⁵⁹

Në operacionet e suksesshme në të kaluarën janë dislokuar të paktën 1.150 ushtarë dhe policë për 100.000 banorë (1000 ushtarë dhe 150 policë ndërkombëtarë)⁶⁰, ndërsa disa studime rekomandojnë 2.000 për 100.000 banorë.⁶¹ Kur NATO hyri në Bosnje dhe Hercegovinë në 1995, forcat e saj arrinin në 2.260 ushtarë për 100.000 banorë, dhe numri i tyre ra pas 5 vitesh në raportin 1.000 ushtarë për 100.000 banorë. Në Kosovë, ky raport

⁵⁹ James T. Quinlivan, "Force requirements in stability operations", Parameters, Winter 1995, p. 60.

⁶⁰ Seth G. Jones/ Jeremy M. Wilson/ Andrew Rathmell / K. Jack Riley, Establishing law and order after conflict, Santa Monica: RAND Corporation 2005, p. 202.

⁶¹ James T. Quinlivan, "Burden of victory: the painful arithmetic of stability operations" Rand Review, Summer 2003, vol. 27, N. 2, <http://www.rand.org/publications/randreview/issues/summer2003/rr.summer2003.pdf&ei=42jw>

u rrit në 2.100 ushtarë dhe në Timorin Lindor në 1.100 në vitin e parë⁶². Në të kaluarën, misionet e suksesshme kanë pasur gjithmonë personel të mjaftueshëm të paktën për pesë vite. Megjithëse është e qartë që vetëm numrat nuk e bëjnë apo cënojnë sigurinë, sepse është e dukshme që personeli i pamjaftueshëm i misionit mund të rrezikojë seriozisht suksesin e tij. Ndonëse disa vende të NATO-s mund të jenë më të pranueshme se të tjerët, në këtë kontekst mund të jetë e këshillueshme që të kemi disa kombe të ndryshme që marrin pjesë në mision.

Ndonëse është e qartë që numri i trupave që nevojiten do të varet gjithashtu nga strukturat lokale të sigurisë, ky seksion supozon që forcat e sigurisë Palestineze fillimisht do të kenë nevojë për më shumë kohë dhe stërvitje, para se ata të mund të marrin përgjigjësi të plotë për sigurinë e brendshme në një Palestinë të pavarur, siç u ra dakord në marrëveshjen Gaza-Jericho në 1994.⁶³ Megjithatë, tani gjenden zyrtarisht 30.000 forca nën autoritetin palestinez, siç u ra dakord në Oslo II. Në të kaluarën të dhënat e tyre janë shënjuar nga korrupsioni dhe abuzimi me të drejtat e njeriut, rreshtimin rastësor me Fatah-un dhe përplasjet me Hamas-in.⁶⁴ Ndonëse 1.600 prej këtyre burrave janë stërvitur kohët e fundit nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadja,⁶⁵ kjo shtrirje u kufizua dhe do të nevojitet

⁶² James T. Quinlivan, "Force requirements in stability operations", *Parameters*, Winter 1995, p. 60. Seth G. Jones/ Jeremy M. Wilson/ Andrew Rathmell / K. Jack Riley, *Establishing law and order after conflict*, Santa Monica: RAND Corporation 2005, p. 202.

⁶³ Israel Ministry of Foreign Affairs: Agreement on the Gaza Strip and the Jericho area, May 4, 1994, <http://www.mfa.gov.il/MFAPeace%20Process%20Guide%20to%20the%20Peace%20Process%20Main%20Points%20of%20Gaza-Jericho%20Agreement>

⁶⁴ Husam Madhoun: *The Palestinian Security Services: Past and Present*, May 30, 2006, Miftah.org, The Palestinian initiative for the promotion of global dialogue and democracy, <http://www.miftah.org/Display/cm?DocId=10400&CategoryId=21>

⁶⁵ Naseem Khuri, "An enhanced engagement: Moving beyond security training for the Palestinian Authority", Policy Memo, Belfer Center for Science and International Affairs, Harvard Kennedy School, July 2009, http://www.belfercenter.ksg.harvard.edu/publication/19512/enhanced_engagement.html Shih gjithashtu Ethan Bronner: U.S. Helps Palestinian build Force for Security, *The New York Times*, February 27, 2009, <http://www.nytimes.com/2009/02/27/world/middleeast/27palestinians.html>

"U.S. Security Coordinator Keith Dayton Address Detailing the Mission and Accomplishments of the U.S. Security Coordinator, Israel and the Palestinian Authority, Washington, 7 May 2009", *Journal of Palestine Studies* Vol.38, No.4, Summer 2009, pp. 223-229.

stërvipte shtesë pas vendosjes së një Palestine tërësisht të pavarur. Është e rëndësishme të vihet re se numri i planifikuar prej 30.000 është i lartë sipas standardeve të policimit ndërkombëtar, të cilët llogarisin 200 trupa për 100.000 banorë në një shtet të stabilizuar – sipas llogaritjeve më të larta mendohet se mjaftojnë 25.940 policë.⁶⁶

Krijimi i strukturave të sigurisë së brendshme palestineze është një element kyç jo vetëm i çdo misioni të suksesshëm për stabilizimin e paqes, por gjithashtu për strategjinë e daljes së NATO-s apo të një force tjetër ndërkombëtare. Kapaciteti i forcave të sigurisë palestineze nuk duhet të matet vetëm me numra, por gjithashtu në cilësi, për të cilën stërvipta është një faktor kyç.⁶⁷ Në rastin e Palestinës problemi nuk është shumë rekrutimi i trupave, por më tepër për t'i stërvitur dhe pajisur ata, dhe për të larguar ata që nuk plotësojnë standardet ose që janë të panevojshëm.

Afërsisht 10.000 oficerë policie dhe 15.000 trupa të krahasueshëm me forcat e armatosura janë aktualisht prezent në Palestinë, megjithëse shifrat e tjera tregojnë norma më të larta.⁶⁸ Këto statistika nuk përfshijnë milicinë si Hamasi ose Brigadat Al Aqsa. Kjo do të thotë që raporti i popullsisë me forcat e sigurisë në Palestinë është 6.08 burra për 1.000 banorë (megjithëse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për t'a analizuar këtë për Gazën dhe Bregun Perëndimor). Gjithashtu, nuk është e qartë se cilat prej këtyre forcave lokale janë të besueshme; policia palestineze e ka reputacionin për korrupsion dhe njëanshmëri. Pjesë e misionit të NATO-s do të ishte garantimi i një ombrelle sigurie nën të cilën Palestina do të kishte mundësinë për t'u stërvitur dhe për të ngritur forcat e veta të sigurisë, siç u ra dakord në Marrëveshjen Gaza-Jericho apo çdo marrëveshje tjetër që çon në një mision të NATO-s.

⁶⁶ The RAND Palestinian State Study Team: Building a Successful Palestinian State, Santa Monica: RAND Corporation 2007, p. 48.

⁶⁷ Megjithatë, debati për llojin dhe kohëzgjatjen e stërviptjes që mendohet si i përshtatshëm vazhdon ende. Timori Lindor, për shembull, i kishte të gjithë oficerët të stërvitur pas tri vitesh, ndërsa në Kosovë ishte 90%.

⁶⁸ International Monetary Fund: West Bank and Gaza: Economic performance and reform under conflict conditions, Washington 2003, p. 92 <http://www.imf.org/external/pubs/ft/med/2003/eng/wbg/wbg.pdf>

Më pak nuk është më shumë, më pak është më pak

Pavarësisht forcave lokale të sigurisë, forcës së NATO-s në Palestinë (pra versioni minimalist), nëse ajo ndjek shembullin e rasteve të suksesshme të Kosovës dhe Bosnjës, do t'i nevojiten forca që variojnë nga 43.700 në 76.000 trupa, duke përfshirë forcat e policisë. Nga këto, midis 16.100 dhe 28.000 do të patrullojnë Gazën, dhe midis 27.600 dhe 48.000 Bregun Perëndimor. Këto shifra nuk llogarisin trupat që mund të shkojnë në një patrullim të përbashkët me forcat izraelite. Izraeli ka një forcë të armatosur prej 176.000, si dhe 30.000 policë dhe 70.000 roje civile. Kjo e çon raportin e ushtrisë me civilët në 24, dhe raportin e policëve me civilët në 13.8. Të dy numrat janë të lartë sipas standardeve ndërkombëtare dhe implikojnë që nuk do të nevojitet një forcë e fuqishme e NATO-s. Megjithatë, patrullimet e përbashkëta që sinjalizojnë prezencën e NATO-s dhe angazhimin e saj ndaj misionit, me siguri do të ndikojnë pozitivisht në opinionin publik në të dyja anët. Rekomandimi për trupa shtesë në territorin e Izraelit do ta çonte numrin e forcës së NATO-s në një minimum prej 50.000 dhe 80.000 trupash. Ndërkohë që forca për Siguri dhe Asistencë Ndërkombëtare e NATO-s ka afërsisht 81.000 trupa në Afganistan, kështu që çështja kryesore nuk do të jetë vetëm gatishmëria e aleatëve për të garantuar këto trupa, por disponueshmëria e tyre. Është e diskutueshme nëse numrat e nevojshëm do të jenë të disponueshëm nga aleatët, paralelisht me misionet në vazhdim në Afganistan, Kosovë, Bosnje dhe Irak. Tashmë ka kritika mbi shkurtimin e kohës midis dislokimit dhe ridislokimit të trupave, meqë po rëndon jo vetëm cilësinë e punës dhe jetës, por buxhetit gjithashtu.⁶⁹ Skemat e tanishme të operacioneve do të duhet të reduktohen në madhësi para se një mision i NATO-s në Palestinë me madhësi të përshtatshme të jetë gati, pa paraqitur ripozicionime më të gjata – diçka që shumë aleatë do të donin ta shmangnin.

Kush e bëri?

Misionet stabilizuese janë përgjithësisht misione këmbësorie. Kjo ndërlikohet në rastin tonë nga fakti që, në skenarin e rastit më të keq, detyrat do të përfshijnë luftën urbane dhe masat kundër rebelimeve, të cilat janë gjithashtu

⁶⁹ James T. Quinlivan, "Force requirements in stability operations", Parameters, Winter 1995, p. 64.

detyrat e rënda të këmbësorisë.⁷⁰ Gjithashtu, rasti jonë nuk do të kishte nevojë vetëm për këmbësorinë, por në një masë të madhe edhe për forcat e policisë. Siç sugjerojnë rastet e kaluara, *xhandarmëria* ose policia paraushtarake janë më mirë të pajisura për llojin e situatës së sigurisë së brendshme, që mund të ekzistojë në fillim në një Palestinë të pavarur, si dhe për ndalimin e krimit në mungesë të strukturave lokale të mjaftueshme të sigurisë. Sipas disa vlerësimeve, 57.000 nga 76.000 trupat do të preferonin të ishin policë civilë ndërkombëtarë ose pjesë e *xhandarmërisë*. Ky raport është ende kritik, 150 oficerë të policisë ndërkombëtare për 100.000 banorë duket, megjithatë, shumë i vështirë për t'u siguruar. Në vitin e dytë pas konfliktit, Timori Lindor kishte një raport prej 151, ndërsa Kosova e kishte 234. Megjithatë, vetëm tetë nga forcat e NATO-s kanë *xhandarmëri*, domethënë Italia, Franca, Bullgaria, Portugalia, Hollanda, Rumania, Turqia dhe Spanja. Nga këto, vetëm pak kanë eksperiencë në një mjedis pas-konfliktit. Kështu, nuk është e sigurtë nëse NATO do të jetë në gjendje të arrijë një *xhandarmëri* kaq të madhe.

Koha është para

Çdo misioni të suksesshëm do t'i nevojitet të qëndrojë për pesë vjet të paktën, mbase edhe më gjatë. Arsyeja është thjesht se rikthimi i konfliktit është më i lartë në 5 vitet që pasojnë fundin e tij. Siç ka treguar rasti i Bosnje-Hercegovinës, kjo periudhë mund të zgjasë më shumë. Është e rëndësishme të theksojmë se kohëzgjatja e këtij misioni, përveç faktorëve të tjerë, do të jetë çelësi i suksesit ose i dështimit të tij. Largimi i parakohshëm mund të rrezikojë vendosjen e paqes. Në mënyrë të ngjashme, misionet e zgjata janë të kushtueshëm. Përveç kostove për vetë misionin, mund të priten kosto shtesë, për shkak të stërvitjes së policisë palestineze, ndërtimit të infarstrukturës dhe sigurimit të pajisjeve. Disa vlerësime llogarisin midis 9.61 bilion dollarë dhe 16.72 bilion dollar në vit, pa llogaritur përpjekjet e rindërtimit, të cilat në rastin e 5 vjeçarit të rekomanduar do të rezultojnë në një numër total midis 48.05 bilion dollarë dhe 83.6 bilion dollarë.⁷¹ Ndonëse është e vështirë që vetë NATO të jetë përgjegjëse për

⁷⁰ International Institute for Strategic Studies: The future of urban warfare, Strategic Comments, 1 March 1999.

⁷¹ Robert E. Hunter, Seth G. Jones: Building a successful Palestinian state: Security, Santa Monica: RAND Corporation 2006, p. xi.

aspektet ekonomike dhe të qeverisjes në ndërtimin e kombit (*nation-building*) në një Palestinë të pavarur, shumë prej anëtarëve të saj kontribuojnë pjesën më të madhe të fondeve të organizatave ndërkombëtare që pritet të paguajnë për këto përpjekje, si BE-ja dhe OKB-ja ; pra këto kosto janë faktorë të drejtpërdrejtë.

Me pak fjalë

Misioni i NATO-s në Palestinë do të kishte pak shanse për sukses, dhe një probabilitet të lartë për të dështuar. Dikush nuk duhet të verbohet nga perceptimet e një mundësie historike dhe të fillojë një përpjekje që mund t'i kushtojë NATO-s besueshmërinë, prestigjin, paratë dhe ekzistencën, thjesht sepse duket se është një shans politikisht simbolik më afatgjatë për ta vendosur NATO-n si garant i sigurisë globale.

Territori i përfshirë paraqet aspektet që do t'i shkaktonin makth çdo planifikuesi fushatash – me popullsi të dendur, zona urbane me popullsi shumë të përziera konfliktuoze, një mjedis politik i paqendrueshëm që mund të përmbysset në çdo moment, dhe një kundërshtar me shumë eksperiencë nëse arrin në masat kundër rebelëve. Kështu, ky mision do të ketë nevojë përgjatë përgatitjeve për një planifikim të kujdesshëm, personel të mjaftueshëm dhe financim, një masë të madhe vullneti politik, dhe do të linte një hapësirë shumë të vogël për sukses. Në stadin e tanishëm, dhe me operacionet e tjera në vazhdim, duket papërgjegjshmëri për ta nxitur NATO-n në një mision që ka të gjithë elementët për t'u kthyer në një batak që ngjason me përfshirjen e Aleancës në Afganistan.

Dr Florence Gaub është Drejtues Akademik i Planeve dhe Operacioneve tek Fakulteti i Kursit për Bashkëpunim Rajonal i NATO-s në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s.

Trine Flockhart

NATO DHE (RI) PËRCAKTIMI I ROLEVE: “VETVETJA”, “NE” DHE “TJETRI”.

Përfytyrimi popullor për rolin e NATO-s u përcaktua prej fjalëve të famshme të të parit Sekretar të Përgjithshëm të NATO-s, Lordit Ismay, si një organizatë e krijuar për “të mbajtur Rusët jashtë, Amerikanët brenda dhe Gjermanët poshtë”. Në këtë kuadër, e thënë pak më me diplomaci si dhe me një lloj riorientimi për shkak të kohës së kaluar, roli i NATO-s vazhdon të mbetet ende thelbësor për ruajtjen e sigurisë së anëtarëve të saj nga kërcënimet e jashtme, për të garantuar qëndrueshmërinë e marrëdhënieve trans-Atlantike si dhe për të ripërshtatur marrëdhëniet mes ish shteteve kundërshtarë të organizatës. Megjithatë, pas këtij përshkrimi deri diku të thjeshtëzuar të NATO-s, qëndrojnë përcaktimet jo pak të vështira të “vetes”, “ne” dhe “tjetrit”, si dhe përfytyrimet për rolet dhe detyrat funksionale të këtyre kategorive. Ky artikull synon të zbulojë disa nga proceset e ndërlikuara të përcaktimit dhe ripërcaktimit të roleve të NATO-s dhe perceptimet që lidhen me identitetin e NATO-s si një organizatë (“vetja”), me shtetet e saj anëtare dhe ato që do të anëtarësohen në të ardhmen (“ne” dhe “partnerët”), dhe ndjesitë e saj për “tjetrin”. Nga këndvështrimi i rolit dhe identitetit, mund të pohohet se NATO ka qenë e angazhuar jo vetëm për të krijuar “veten”, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm dhe ruajtjes së vetë-identitetit përmes të cilit ajo përcakton veten dhe mënyrën sesi do t'i pëlqente të përfytyrohej nga të tjerët. Ajo ka qenë gjithashtu e përfshirë vazhdimisht në përcaktimin e rolit të dhënë, që në këtë rast lidhet me caktimin e një tërësie detyrash specifike funksionale, të cilat shihen si mbështetëse të vetë identitetit të saj. Ky është një proces që aktualisht po i nënshtrohet një transformimi domethënës. Kjo ndodh për shkak se vetë identiteti

i NATO-s është përfshirë nga procesi i ndryshimit nga një “aleancë e mbrojtjes” në një “institucion për menaxhimin e sigurisë”⁷², me një rol në rritje që po bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar. Së bashku me ndryshimet në vetë identitetin dhe rolin e përcaktuar të NATO-s, kjo organizatë ka qenë gjithashtu e angazhuar në ripërcaktimin e një identiteti kolektiv të ‘ne-ve’, i nënkuptuar si ndjenjat e përbashkëta të “ne-së” që mbështeten nga “veprimi i Ne-së”⁷³. “Identiteti i Ne-së” përfshin anëtarët dhe vendet e ardhshme anëtare nëpërmjet një rindërtimi gradual të identiteteve të tyre me anë të socializimit të një sërë normash të vendosura dhe përcaktuara nga NATO dhe anëtarët e saj. Në këtë mënyrë, ai përbën një identitet në përputhje me identitetin e përbashkët kolektiv të shteteve anëtare të kësaj organizate dhe anëtarëve të ardhshëm, sikundër ofron mbështetje aktive për vetë-identitetin dhe rolin e saj të pranuar prej të gjithëve. Megjithatë, një numër gjithnjë e më në rritje i shteteve që nuk kanë potencialin për të qenë anëtarë të mundshëm të NATO-s dhe që nuk kanë ndikim në përcaktimin e rolit dhe identitetit të saj, marrin pjesë në disa prej detyrave funksionale të NATO-s (sidomos në misionet në Ballkan, Afganistan dhe Gjirin e Adenit). Ky dimension i sjelljes/bashkëveprimit dhe ai funksional ka shtuar efektivisht një grupim të ri në kompleksitetin e përcaktimit dhe ripërcaktimit të identiteteve të NATO-s dhe roleve që lidhen me të. Grupi i ri në këtë artikull përcaktohet si “partnerët”, duke përfshirë një grup që nuk është plotësisht pjesë e tërësisë së vetë-identitetit të NATO-s dhe që mund të mos ndajë të gjithë vlerat themelore apo të përmbushë kriteret e saj të anëtarësimit, por që megjithatë është ngushtësisht i lidhur me NATO-n sa i përket angazhimit në bashkëpunim praktik, si pjesë e rolit të caktuar të saj. Duke dalluar ndërmjet 1) vet-identitetit të NATO-s (aleancë mbrojtëse apo institucion për menaxhimin e sigurisë) dhe 2) “identiteteve të ndryshme të “ne-ve” (identiteti kolektiv i shteteve anëtare dhe anëtarëve të ardhshëm) dhe 3) partnerëve (shtetet me të cilët NATO ka marrëdhënie konstruktive, por të cilët nuk synojnë të bëhen anëtarë), bëhet e qartë se NATO, që prej historisë së saj

⁷² Term i Keohane dhe Wallander (Keohane et al .1999). Ata dallojnë ndërmjet një aleance mbrojtëse, roli i së cilës është t'i kundërpërgjigjet një kërcënim të vecantë si dhe një institucioni për menaxhimin e sigurisë, që parapëlqen të merret me një larmi rreziqesh.

⁷³ “ Ne-ja/we-ness” është një koncept që u përdor fillimisht nga Karl Deutsch (1957) dhe studiuesit e tjere si një nga elementët e qenësishëm të komunitetit të sigurisë. “Veprimi i ne-se/we-doing” është një ripërshtatje e përdorur nga Emanuel Adler (2008) që shënon nivelin më të lartë të integritimit, ku NATO tashmë shndërrohet në një komunitet të veprimit.

të hershme, ka qenë aktive në përcaktimin dhe nxitjen e roleve dhe identiteteve në një rreth në rritje shtetesh anëtare, anëtarësh të ardhshëm dhe vendesh partnere.

Në shumë anë, ky është një proces “vetëpërcaktimi”, i ngjashëm me atë të përshkruar nga Georg Herber Mead, i cili dallon mes “Unë” dhe Mua” (Mead, 1934). Procesi vendoset fillimisht brenda një organizate gjatë luftës së saj për të përcaktuar “Unë” dhe “Mua”, ku “Unë” përfaqësonte “përcaktimin e vetvetes” dhe “mua” perceptimin e “vetvetes” kundrejt pritshmërive të të tjerëve lidhur me “rolin (funksional)” të saj. Fillimisht procesi përqendrohet tek përcaktimi i sjelljes përkatëse për organizatën dhe anëtarët e saj. Megjithëse shtete të veçanta anëtare ndonjëherë përplasen mes tyre gjatë përpjekjeve për të përcaktuar rolin dhe kontekstin e rolit të NATO-s, ndërmjet tyre ruhet një konsensus i brishtë.⁷⁴ Megjithatë, në përgjigje të ndryshimeve strukturore, lidhur me aspektin konkret e ideor të sistemit ndërkombëtar, veçanërisht pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ngjarjeve të 11 Shtatorit 2001, perceptimi i NATO-s për “tjetrin” si dhe vetë roli i NATO-s kanë ndryshuar. Tashmë nuk i mëshohet më faktit që NATO është “kryesisht” një aleancë mbrojtëse me një anëtarësi, rol dhe zonë veprimi të mirëpërcaktuar. Mund të thuhet se ndryshimet strukturore në sistemin ndërkombëtar shkaktuan një ripërcaktim të rolit të brendshëm të NATO-s dhe të aktiviteteve normë nxitëse, duke i dhënë këtyre një tipar gjithnjë e më të jashtëm në raport me sferën e hershme të veprimit, teksa vëmendja u shkëput nga proceset e brendshme të krijimit të rolit dhe identitetit, për t’u drejtuar drejt një angazhimi gjithnjë e në rritje, mes shteteve të konsideruara më parë si pjesë e “tjetrit” apo si “ jashtë zonës së veprimit”. Duke bërë këtë, jo vetëm që ndryshuan rolet ndaj atyre që konsideroheshin si përftuesit prej normave përgjatë kalimit nga “tjetri” tek “ne-ja i ardhshëm” apo “partneri”, por roli i NATO-s u transformua gjithashtu thellësisht në një aktor të përfshirë gjithnjë e më shumë në socializimin e normave. Me fjalë të tjera, historia e NATO-s ka qenë një proces i vazhdueshëm i ndërtimit të rolit dhe identitetit të “vetvetes”, “ne-së” dhe “tjetrit”, përshtatjes së brendshme dhe përhapjes jashtë të normave, vlerave dhe praktikave të lidhura me ato që përbëjnë “veten”, “ ne-në” dhe “tjetrin” e NATO-s.

⁷⁴ Në raste të caktuara konsensusi ka qenë vetëm sipërfaqësor ku shtetet anëtarë ka rënë dakort të mos jenë në një mendje duke anuar nga mospërputhja e qëndrimeve të tyre.

Ky shkrim synon të paraqesë procesin e ndërlikuar të krijimit dhe ripërcaktimit të vetë NATO-s dhe ndërveprimin e saj me një numër shtetesh të tjera. Artikulli do të përdorë Teorinë e Rolit dhe Teorinë e Identitetit Social (TIS) për të analizuar dinamikat e shumëfishta të përcaktimit të rolit të NATO-s, anëtarëve të saj, anëtarëve të ardhshëm dhe atë të vendeve partnere. Artikulli ndahet në katër pjesë. Ai fillon me një shqyrtim të teorisë së rolit dhe TIS, lidhjen mes këtyre të dyjave dhe zbatimin e tyre në rastin e NATO-s. Më pas ai tenton të shtjellojë mënyrën dhe ndërtimin e roleve dhe identiteteve duke u fokusuar tek “vetja” (NATO), e pasuar nga pjesa që bën fjalë mbi “ne”(anëtarët e vjetër, të rinj si dhe ato që priten të anëtarësohen në të ardhmen) dhe tek krijimi i roleve dhe identiteteve për grupin e shteteve të ndryshme që nuk mund të karakterizohen as si pjesë e “tjetrit”, as plotësisht si pjesë e “ne-së”, të cilëve artikulli u referohet si “partnerët”. Të dyja pjesët e shkrimit ndërtohen rreth 3 fazave të ndryshme të historisë së NATO-s të përcaktuara nga krizat dhe ndryshimet në nivelin strukturor në periudhat 1945-1949, 1989-1991 dhe 1999-2001. Shkrimi mbyllet me vlerësimin e roleve të NATO-s dhe perspektivat e saj për zhvillim të vazhdueshëm sipas kushteve të reja të globalizimit.

Teoria e rolit dhe teoria e identitetit social

Përdorimi i Teorisë së Rolit në këtë artikull mbështetet mbi kuptimin se në thelb të saj ajo trajton ndërveprimin mes aktorit dhe strukturës si edhe ndërveprimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Megjithatë, Teoria e Rolit mund të thuhet se përbëhet nga dy rryma të ndryshme. Njëra prej tyre, thekson strukturat materiale që përbëjnë burimin për role të caktuara (referuar këtu si përshtatja e rolit), dhe tjetra që i shikon rolet si të mishëruara tek përshtatjet e caktuara sociale dhe mënyrat e ndërveprimin mes aktorëve të ndryshëm (konceptuar në këtë rast si ndërveprimi bazë). Kuptimi është i lidhur ngushtësisht me përkufizimin fillestar të rolit të NATO-s prej Lordit Ismay, ku e para (mbajtja e Rusëve jashtë) lidhet me kuptimin strukturor dhe material të kërcënimit dhe me përshtatjen e vazhdueshme të instrumenteve e strategjive të veçanta për përballimin e kërcënimit të kësaj natyre. Ndryshimet në nivel strukturor në shumë raste kanë nxitur përshtatjen e rolit, ku strategjitë dhe instrumentet kanë ndryshuar, megjithëse qëllimi i përgjithshëm i

organizatës ka mbetur i njëjtë. Zhvillimi i NATO-s nga një aleancë mbrojtëse në institucion të menaxhimit të sigurisë mund të shihet nën këtë këndvështrim. Megjithatë, të dyja rolet e tjera të kësaj organizate të përmendura nga Lordi Ismay (të mbante Amerikanët brenda dhe Gjermanët poshtë), kanë të bëjnë më shumë me marrëdhëniet sociale ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe bazën e tyre ideore sesa me strukturat materiale. Të dyja lidhen me transformimin e marrëdhënieve sociale nëpërmjet proceseve komplekse të ndërveprimit dhe ndërtimit të identitetit. Duke përshtatur një version të Mead (1934) që trajton “ndërvarësinë bazë të vetes dhe tjetrit”, NATO mund të konceptohet si një aktor nxitës i socializimit dhe që inkurajon në mënyrë aktive një normë të veçantë të përcaktuar dhe praktikata e sjelljes që lidhen me të. Në këtë kuptim, NATO bëhet një aktor socializues dhe drejtuesi kryesor i kësaj norme, për shkak se kjo organizatë (ose ata aktorë që veprojnë në emër të saj) e shohin vetveten si të tillë dhe për arsye se ky pozicion është pranuar dhe zbatohet nga shtetet anëtare me qëllim përfundim dhe nxitjen e kësaj norme.

Të dy format e sjelljes së rolit, ndërveprimi bazë dhe përshtatja e rolit, bashkëekzistojnë në të njëjtën kohë dhe, në raste të caktuara, ndërliken ngushtësisht në një sistem vartësie dhe përbërje të dyanshme. Përshtatja e rolit mund të zbatohet vetëm nëse të gjithë shtetet anëtare bien dakord dhe NATO në mënyrë aktive lehtëson marrëveshjen mbi përshtatjen e rolit nëpërmjet proceseve ndërvepruese të socializimit (ku përfshihen marrëveshjet, ndikimi shoqëror dhe bindjet). Në mënyrë të ngjashme, sa i përket marrëdhënieve me jashtë, NATO mund të bëhet një aktor socializues, krahas anëtarëve të ardhshëm dhe vendeve partnere, vetëm nëse ajo e sheh veten në këtë rol. Sigurisht që kjo kërkon miratimin e strukturës më të lartë vendimmarrëse të NATO-s (Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC)), dhe nga aktorët që janë të pozicionuar nga ana pritëse në procesin e socializimit me normat e kësaj organizate. Marrëdhëniet sociale dhe ndërveprimi mes aktorëve të ndryshëm, në një shkallë të konsiderueshme, do të ndikohet nga kushtet strukturore materiale dhe prej zgjedhjes individuale të strategjive dhe instrumenteve. Këto zgjedhje do të ndikojnë marrëdhëniet sociale.

Marrëdhënia mes aktorëve të ndryshëm për krijimin e roleve është përmbledhur si më poshtë. Vëmendja kryesore përqendrohet tek ndërtimi i rolit të NATO-s, e cila këtu është përkufizuar si “vetja”, mbi shtetet anëtare të përcaktuara si “ne-1” dhe mbi krijimin e roleve, sa i përket grupit të shteteve të ardhshme anëtare, të emëtuara si “ne-2”. Unë përdor termin

riformim, sipas mënyrës referuar prej Gabi Schlag (2009), për të nënvizuar aspektin procedural dhe të qëndrueshëm të identitetit. Ai arrin në përfundimin se një identitet nuk është thjesht një tërësi zakonesh e sjelljesh të aktorit, por ai përfshin “një grup praktikash që ripërsëriten dhe struktura kuptimplote që janë në gjendje të ndryshojnë” (Schlag 2009, 2). Siç e kemi përmendur, ky kapitull trajton gjithashtu ndikimin e NATO-s lidhur me krijimin e roleve për një kategori të katërt shtetesh që kanë marrëdhënie konstruktive me NATO-n nëpërmjet partneritetit dhe dialogut, por që nuk synojnë anëtarësimin në këtë organizatë. Ndikimi i NATO-s në konstituimin e roleve për këtë grup shtetesh është ndoshta më i dyzuar dhe më sfiduesi, për sa kohë që ky grup nuk mund të përfshihet lehtësisht as në kategoritë e “neve” as në atë të “tjetrit”. Prandaj, edhe Sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen, gjatë fjalimit të tij të parë në këtë funksion, i renditi marrëdhëniet me këtë grup si një nga katër prioritetet kryesore.⁷⁵

Megjithëse Teoria e Rolit na jep njëfarë shpjegimi për sjelljen e politikës së jashtme, ajo nuk mund të shërbejë për të shtjelluar çdo aspekt të kësaj politike, për shkak se kjo teori lejon një hapësirë të madhe për interpretime dhe përkufizime individuale për të drejtat, detyrat, privilegjet dhe për forma të caktuara të sjelljes (Holsti 1987, 7). Siç sugjerohet prej Hollis dhe Smith (1990, 14), rolet përfshijnë gjykim dhe aftësi, duke marrë të mirëqenë se një gjykim dhe aftësi e tillë zbatohet brenda një strukture (Hollis & Smith 1990). Megjithatë, ekziston një hapësirë e konsiderueshme në lidhje me organizatat apo agjencitë e ndryshme brenda Teorisë së Rolit, për shkak se aktori e ka në dorë të zgjedhë sesi të sillet. Në këtë rast ai është i pajisur me aftësi dhe karakteristika të ndryshme, të cilat nënkuptojnë se ekziston gjithmonë një qëllim për sjelljen e paqëndrueshme përgjatë rolit të aktorit. Në periudhën e ndryshimeve strukturore, rolet e përcaktuara priren të bëhen të paqëndrueshëm duke çuar në një ripërcaktim të tyre dhe në intensifikim të procesit të të mësuarit dhe socializimit, ndërsa aktorët bëhen më të hapur për përshtatjen me norma dhe praktika të ndryshme. Periudha të tilla përkufizohen në këtë shkrim si “një moment i jashtëzakonshëm, kur vihet në lojë ekzistenca dhe mbijetesja e rendit politik” (Ikenberry 2008, 3). Sipas Ikenberry, momente të tilla mund të çojnë qoftë në zgjidhje që nuk prekin rregullat dhe

⁷⁵ Konferenca e parë e shtypit e NATO-s me Anders Fogh Rasmussen, 3 August 2009 http://www.nato.int/cps/en/natolive/opinions_56776.htm(accessed 17/08/2009)

institucionet ekzistuese, ose mund të sjellin transformime, përshtatje apo edhe shpërbërje (Ikenberry 2008, 12). Në të dyja rastet, megjithatë, procesi i të mësuarit nga eksperiencat e mëparshme ndodh, teksa aktorët ndryshojnë sjelljen dhe normat e tyre udhëheqëse. Në këtë artikull, theksi vihet tek elementët e zgjidhjes dhe përshtatjes. Ndryshimet strukturore që ndodhën në mjedisin ndërkombëtar pas Luftës së II-të Botërore, Luftës së Ftohtë dhe në prag të luftës në Kosovë apo edhe pas 11 Shtatorit, përshpejtuan gjithashtu procesin e ndërtimit të identitetit të ri dhe ripërcaktimin e roleve në përgjigje të ndryshimit të pritshmërive, krah për krah me rolin dhe mënyrën sesi interpretohet ai. Për shkak të rëndësisë të “momenteve të jashtëzakonshme” që nxitën ndryshimin, analiza në këtë artikull do të përqendrohet pikërisht mbi to.

Teoria e Rolit është e dobishme për të shpjeguar procesin ndërveprues ndërmjet aktorëve dhe kushteve strukturore (structural conditions) apo ndikimin mbi aktorë të veçantë, por qëllimi i këtij ndikimi të ushtruar nga të dyja strukturat dhe procesi ndërveprues (interactive process) është që të kuptojmë në fund të fundit rolin e vetë aktorit. Holsti (1987, 8) përshkruan thelbin e origjinës së konceptit të rolit si një larmi faktorësh që përfshijnë historinë, kulturën, normat dhe vlerat, nevojat dhe interesat. Me fjalë të tjera, aty ku pritshmëritë për interpretimin e rolit dhe përcaktimin e tij zënë vend në hapësirën ndërmjet aktorëve të ndryshëm, kuptimi i rolit është proces që zhvillohet brenda vetë aktorëve të veçantë - në këtë rast NATO. Këto procese të brendshme mund të përkufizojnë në mënyrë të gjerë edhe vetë proceset e krijimit të identitetit. Megjithatë, çështja është sesi i llogarisim ne ndryshimet në konceptin e rolit ndërmjet aktorëve, të cilët duket se kanë qenë subjekt i kufizimeve të njëjta strukturore, historike e kulturore dhe që ngjan se janë përballur me pritshmëri të ngjashme në interpretimin e këtij roli. Si do ta vlerësojmë ne p.sh dallimin sa i përket kuptimit dhe interpretimit të rolit ndërmjet Ukrainës dhe Bjellorusisë, apo mes Kroacisë dhe Serbisë, apo Gjeorgjisë dhe Azerbajxhanit? Përgjigja u dha më sipër – teoria e rolit e vë theksin veçanërisht tek qëllimi që agjencia apo organizata përcakton për vetveten, ashtu sikurse njih faktin se zgjedhja e aktorit, parapëlqimi dhe aftësia e tij do të ndikojnë në kuptimin dhe interpretimin e rolit. Megjithatë, kjo është një përgjigje qartësisht e pakënaqshme dhe e pamjaftueshme nëse duam të kuptojmë se përse disa aktorë zgjedhin një variant ndërkohë që një vend tjetër, në dukje krejt i ngjashëm me ta, zgjedh diçka plotësisht të ndryshme, që me kalimin e kohës çon në dy drejtime krejtësisht të dallueshme

nga njëra – tjetra. Në këtë kuadër, nëse ne duam të jemi në gjendje që të kuptojmë se përse ndonjëherë aktorë të njëjtë bëjnë zgjedhje të ndryshme, është e nevojshme që ta plotësojmë teorinë e rolit me një teori të vendosur në nivelin e aktorit, e cila mund të vlerësojë edhe dallimet mes aktorëve të njëjtë. Një qasje e dobishme teorike për të zgjidhur këtë enigmë është Teoria e Identitetit Social (TIS), veçanërisht proceset e kategorizimit të vetes dhe të tjetrit.⁷⁶

Teoria e Identitetit Social (TIS) ofron një përshkrim ku aktori nuk varet nga faktorët e nacionalitetit material ose që mbështeten mbi interesin, por në vend të kësaj përqendrohet mbi dëshirën e brendshme të aktorëve për të maksimizuar vetëvlerësimin e tyre. Supozimet e Teorisë së Identitetit Social (TIS) nënkuptojnë se vetëvlerësimi i individëve nuk mund të izolohet, por ai buron dhe ruhet nëpërmjet marrëdhënieve sociale që zënë vend mes anëtarëve të grupeve shoqërore, dhe ka një domethënie psikologjike për këta anëtarë, përmes të cilit ata e lidhin veten subjektivisht edhe kur krahasohen me grupe të tjera të kësaj natyre (Turner 1987, 1).

Në Teorinë e Identitetit Social (TIS), supozohet se të gjithë aktorët i përkasin një grupi social, ku ekziston një renditje hierarkike grupimesh sociale brenda një strukture të ngjashme, përmes identifikimit të një “tjetri” që është i përbashkët për ta, i cili është ai që përcakton çfarë nuk është “vetvetja” dhe çfarë duhet për t’u distancuar prej tij, dhe një “ne-je kuptimplotë” të përbashkët që përcakton çfarë “vetvetja” admiron dhe çfarë ajo synon të bëhet (Flockhart, 2006, 94). Prandaj, grupet sociale marrin një pozicion qendror brenda Teorisë së Identitetit Social (SIT), sepse përmes renditjes së grupeve sociale në mënyra dhe kategori të ndryshme, individët përftojnë normat dhe vlerat si dhe arrijnë edhe ruajnë vlerësimin për vetveten. Proceset ndërvepruese (interactive processes) janë po aq të rëndësishme për Teorinë e Identitetit Social (SIT), sikurse janë edhe për elementët e ndërveprimit bazë (constitutive interaction) të Teorisë së Rolit.

Një proces i vazhdueshëm i kategorizimit të vetvetes dhe tjetrit ndodh kur, brenda një kuadri të veçantë (si p.sh. Siguria Evropiane), aktorët kategorizojnë vazhdimisht grupet sociale si edhe qëndrimin e mundësitë e tyre brenda këtij kuadri. Aktorët do të parapëlqenin anëtarësinë në grupin social të kategorizuar si “ne-ja kuptimplotë” ose, të paktën, të pozicionohen sa më afër

⁷⁶ Për një përshkrim më të plotë të proceseve të kategorizimit të vetes dhe tjetrit shih Flockhart 2006.

këtij grupi që të munden, pasi sa më lart të renditet ky grup social aq më shumë gjasa ekzistojnë që anëtarësia e tij të prodhojë nivelin e dëshiruar të vlerësimit për vetveten. Anëtarësia në grupin social nuk është e hapur për të gjithë, por megjithatë kjo varet nga vullneti dhe aftësia e aktorëve të tjerë për t'iu përshtatur normave, vlerave dhe praktikave të grupit social që dëshirojnë t'i bashkohet si dhe prej ekzitencës së vullnetit të grupit në fjalë për të pranuar anëtarë të rinj. Aktorët që e konceptojnë NATO-n si “ne-ja kuptimplotë” socializohen më lehtë me vlerat e normat e saj krahasuar me ata që nuk kanë këtë perceptim. Ata që e perceptojnë NATO-n si pjesë e “tjetrit” ose që janë indiferent ndaj saj, kanë më pak të ngjarë që të socializohen vullnetarisht në të. Ndryshueshmëria në zgjedhje, si në rastin e Ukrainës dhe Bjellorusisë, mund të shpjegohen përmes kuptimeve të ndryshme që ato kanë për “ne-në kuptimplotë” dhe “tjetrin”. Në rastin e Bjellorusisë “ne-ja kuptimplotë” shihet si Rusia, ndërsa në rastin e Ukrainës ajo është ende një çështje politikisht e debatueshme.⁷⁷ Megjithatë, duket se NATO ka më shumë ndikim në Ukrainë sesa në Bjellorusi.

Teoria e Identitetit Social (SIT) nxjerr qartësisht në pah se identitetet janë ndërtuar nëpërmjet procesesh komplekse të kategorizimit të vetes dhe tjetrit, ku “vetja” vendoset sa më larg që të jetë e mundur nga “tjetri” dhe sa më afër ndaj asaj që konsiderohet si “ne-ja kuptimplotë”. Gjatë procesit të krijimit të një identiteti të tillë, aktorët mësojnë, përmes socializimit dhe përshtatjes me grupin e normave mbizotëruese (dhe ka shumë gjasa që të mësojnë të sillen në mënyra që janë të përshtatshme me grupin e normave mbizotëruese të grupit social të preferuar). Në rastin e NATO-s, tërësia e normave që u kërkohet të mësojnë dhe përshtatin grupet “ne-1” dhe “ne-2”, është një formë e Internacionalizmit Liberal e cila është zhvilluar dhe specifikuar në mënyrë të vazhdueshme në një grup normash të veçanta dhe kërkesa sjelljeje gjithnjë e më të shumta. NATO dhe institucione të tjera të rendit liberal të krijuara pas 1945, gradualisht luajtën rolin e “ruajtësit të kësaj tërësie normash” dhe janë shndërruar në aktorët kryesorë për nxitjen e tyre (norm promoting agents).

⁷⁷ Në mënyrë të qartë kjo çështje nuk është zgjidhur ende edhe në nivel kombëtar të këtij shteti, ku një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka një kuptim të ndryshëm të “ne-se kuptimplotë” nga qeveria që ishte në pushtet deri në vitin 2009. Marrëdhëniet me NATO-n kanë qenë një nga çështjet më të kundërshtueshme në fushatën elektorale në Ukrainë në fund të 2009 dhe fillim 2010.

Një parakusht i rëndësishëm për një organizatë, që të sillet si një socializues i⁷⁸ normës, (norm socializers) është ekzistenca e një marrëveshjeje brenda saj, e cila ka të bëjë me atë se nga se përbëhet “vetja” dhe sjellja përkatëse që buron më pas.

Duke kombinuar elementët e teorisë së rolit të përmendur më sipër me konceptin e SIT (Teoria e Identitetit Social), është e mundur që të gjurmohet ndryshimet sa i përket përcaktimit dhe ripërcaktimit të roleve dhe identiteteve në NATO dhe tek aktorët me të cilët NATO ka marrëdhënie ndërvepruese. Ashtu siç kemi theksuar më sipër, analiza është përqëndruar mbi 3 momentet e jashtëzakonshme në historinë e NATO-s 1945-1949, 1989-1991 dhe 1999-2001.

Përcaktimi i tipareve të këtyre momenteve lidhet me faktin se ndryshimet strukturore që ndodhën në sistemin ndërkombëtar bënë të mundur transformimin e përgjithshëm ideor, dhe sollën ndryshime në dokumentet strategjike të NATO-s. Megjithatë, duhet të theksohet se përdorimi i këtyre periudhave të veçanta kohore ka karakter orientues, më së shumti për të prekur ato mënyra të reja të menduari që pasuan prej valëve të këtyre ndryshimeve. Datat nuk nënkuptojnë se ky ndryshim ka ndodhur vetëm gjatë kësaj kohe, megjithëse të 3 këto momente janë ndjekur nga përpjekje për përshtatje të rolit dhe ndryshim të qasjeve në ndërveprimin bazë (constitutive interaction), për shkak se NATO e ka patur gjithnjë karakteristikë të saj ndryshimin gradual dhe riformulimin e roleve e funksioneve të caktuara. Përdorimi qoftë i teorisë së rolit apo edhe SIT (Teorisë së Identitetit Social) na mundëson një qasje më gjithëpërfshirëse, duke nënkuptuar qoftë faktorët materialë e strukturorë, ashtu edhe ata socialë e ideorë, që na mundësojnë të vërejmë ndryshimet në konceptimin e rolit, përshtatjen e tij, identitetin e vetvetes dhe qasjet e ndërveprimit bazë në NATO përgjatë viteve.

Të krijuarit dhe të rikrijuarit e “vetvetes”

Nënshkrimi i Traktatit të Atlantikut të Veriut më 4 Prill të vitit 1949 në Uashington ndërtoi konturet bazë të Aleancës së

⁷⁸ Megjithëse miratimi i MC14/3(Reagimi Fleksibel e/Flexible Response) në vitin 1967 ishte një arritje e madhe dhe në shumë drejtime mund të shihet si një moment kritik në historinë e NATO-s, teksa Franca u largua nga strukturat e integruara ushtarake nga mesi i viteve 1962-1967, ai nuk llogaritet si një rrethanë e vështirë për shkak se procesi drejt miratimit të këtij dokumenti ishte shumë i shkurtër dhe ai vetëm kodifikoi mendimin ekzistues strategjik. Për më tepër, pavarësisht tërheqjes së Francës, asnjë ndryshim tërësor strukturor nuk ndodhi në sistemin ndërkombëtar.

Atlantikut, edhe pse roli i saj i saktë, marrëdhëniet e saj dhe formulimi specifik i dokumenteve strategjike do të plotësohej në një fazë të mëvonshme. Si rrjedhojë, në fillim ajo çfarë përbënte sjelljen e duhur brenda NATO-s ishte jo plotësisht e qartë dhe retorika e përdorur për këtë ndonjëherë dukej jo-logjike apo edhe kontradiktore. Për të kuptuar burimin e kontradiktave të dukshme në retorikën e NATO-s, nevojitet shqyrtimi i strategjive kryesore të politikës së jashtme, të cilat u formëzuan pas Luftës së II-të Botërore. Siç është përmendur edhe nga Ikenberry (2001), periudha e pas luftës u karakterizua nga dy strategji paralele të politikës së jashtme - një strategji e frenimit dhe një strategji e ndërtimit të institucioneve që çonin drejt një rendi liberal (Ikenberry 2001). Ekzistenca e dy strategjive të politikës së jashtme, e cila në njëfarë mënyre mund të shihet edhe si kontradiktore, i dha jetë dy proceseve paralele të krijimit të roleve dhe ndërtimit të identitetit. Pozicioni i veçantë i NATO-s, si një instrument i rëndësishëm në strategjinë e frenimit dhe si pjesë e rëndësishme e arkitekturës së re institucionale, që në fillim ka nxjerrë si problem krijimin e “vetvetes”. Kjo për shkak se NATO-s i është dashur gjithmonë të ballafaqohej me “dy vetvete”. Brenda strategjisë së frenimit, “vetvetja” e NATO-s mbështetej tek një “tjetër” që ishte Bashkimi Sovjetik dhe tek kërcënimi material e konkret i luftës bërthamore. “Ne-ja kuptimplotë”, në këtë rast, ishte konceptuar si “bota e lirë”, e cila lejonte edhe përfshirjen e pjesëmarrësve të dyshimtë për t’u identifikuar me këtë grupim, siç ishin asokohe Spanja dhe Portugalia (kjo e fundit si anëtare themeluese e NATO-s). Nga ana tjetër, brenda strategjisë së rendit liberal, “vetja tjetër” e NATO-s mbështetej mbi një koncept ideal të “tjetrit” (që ishte e shkuara e trazuar e vetë Evropës) (Waever 1998), si edhe tek një lloj kërcënimi i mjegullt për një rikthim të rivalitetit të Fuqive të Mëdha në Kontinent. Ndërkohë që “ne-në kuptimplotë” e përbënte komuniteti i shteteve liberale, për të cilët çdo konflikt do të zgjidhej në mënyrë paqësore. Gjatë gjithë periudhës së pas luftës, të dyja strategjitë kanë ekzistuar krahas krahas edhe pse theksimi i secilës në momente të caktuara, sikundër edhe ka ndodhur në nivele të ndryshme, megjithëse vënia në pah e secilës në momente të caktuara ka qenë e ndryshme, sikurse edhe konceptet për rolin e aktorëve që lidhej me to.

Përgjatë historisë së NATO-s, ndërtimi i “vetvetes” është realizuar përmes procesit të socializimit, i cili është mbështetur në bindjen dhe ndërmjetësimin e vazhdueshëm mes shteteve anëtare. Një pjesë e rëndësishme e procesit ka qenë përpjekja e pandalur për të arritur konsensus për të gjitha vendimet politike

të marra në NAC. Veçanërisht marrëveshja lidhur me dokumentet strategjike ka qenë një proces i ngadaltë dhe shpesh i vështirë. Në këto procese të brendshme të vazhdimësisë së ndryshimit, roli i SHBA-së si *primus inter pares* e ka lejuar këtë vend ta shohë vetveten si përcaktues i axhendës së organizatës dhe aktor i socializimit të brendshëm.

1945-1989

Vlera të mjegullta, por me një “tjetër” konkret

Gjatë periudhës së parë të ekzistencës së NATO-s koncepti kryesor i rolit të NATO-s u mbështet mbi “tjetrin” konkret dhe kërcënues, i cili u shfaq në formën e BS dhe një kërcënimi bërthamor rrëqethës. Si rezultat, pozicioni i rolit të NATO-s gjatë Luftës së Ftohtë u bë shumë i qartë, si ai i një aleancë ushtarake mbrojtëse me detyrë shumë specifike, për të garantuar që strategjia e frenimit të BS të funksiononte dhe që lufta bërthamore të shmangej. Ky rol u shpreh mjaft qartë në Nenin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe u specifikua gradualisht në një numër dokumentesh strategjike⁷⁹ që synonin t’i ofronin Aleancës drejtimin strategjik dhe të kodifikonin vendimet që merreshin me administrimin ditë pas dite të Aleancës (Rynning& Ringsmose 2009, 6). Negociatat e realizuara në rastin e miratimit të dokumentit strategjik të vitit 1957, që u mbështetën tek koncepti i Shkatërrimit Masiv dhe ato të vitit 1968, që vunë në qendër të tij Reagimin Fleksibël, nënkuptonin se në të dy rastet proceset kishin qenë themelore për nga mënyra sesi kishte ndodhur socializimi, duke krijuar pritshmëritë se negociatat do të vazhdonin deri në arritjen e një marrëveshjeje.

“Vetja e dytë” e NATO-s mbështetej tek strategjia e rendit liberal, gjithmonë e paraqitur në sfond, e cila theksohej shumë më qartë në Nenin 2 të Traktatit të Atlantikut. Ky Nen specifikonte se Aleanca do të kontribuonte drejt marrëdhënieve ndërkombëtare paqësore dhe miqësore, duke forcuar institucionet e tyre të lira e duke përcjellë një kuptim më të mirë mbi parimet mbi të cilat ato ishin krijuar (Traktati i Atlantikut të Veriut, Neni 2). Megjithatë, angazhimi ndaj strategjisë së dytë të politikës së jashtme, për të ndërtuar një rend liberal, nuk ishte prioritet në 5 vitet e para të ekzistencës së NATO-s, ku ngjarje të tilla si realizimi i provave bërthamore prej BS dhe Lufta në

⁷⁹ Gjatë Luftës së Ftohtë, NATO miratoi 4 dokumenta strategjike: DC6/1(1949); MC3/5(1952); MCI4/2(1957); MCI4/3(1967)

Kore e çimentuan besimin e NATO-s ndaj BS si “tjetri” i tyre dhe e bënë kërcënimin e luftës bërthamore të dukej shumë i vërtetë. Ndërtimi i një koncepti të vetes, të mbështetur mbi strategjinë e rendit liberal, filloi jo më parë se të arrihej marrëveshja për Raportin Harmel të vitit 1967, që mund të shihet si një pikë kthese për njohjen e strategjisë së rendit liberal si pjesë e konceptit të NATO-s për veten dhe për njohjen e Nenit 2 të Traktatit. Ai arriti në përfundimin se “mënyra për të sjellë paqen dhe stabilitetin në Evropë mbështetet në përdorimin konstruktiv të Aleancës në interes të uljes së tensionit (Raporti Harmel, 1967). Megjithatë, gjatë Luftës së Ftohtë, strategjia e frenimit ishte baza për konceptin e rolit më mbizotërues të Aleancës dhe për arsyen e ekzistencës (*raison d’être*) të saj. Si rrjedhojë përcaktimi i rolit të NATO-s gjatë Luftës së Ftohtë ishte si një aleance ushtarake mbrojtëse.

1989-1999

Zbehja e “tjetrit” dhe testimi i detyrave

Zhdukja e kërcënimit Sovjetik e “zhveshi” NATO-n prej rolit të saj më të dukshëm që ishte paracaktuar përmes Traktatit të Uashingtonit si edhe prej elementëve bazë që qëndronin në themel të konceptit të saj të “vetes”. Megjithatë, fundi i Luftës së Ftohtë e përballi Aleancën me detyrën për të rivënë në qendër të vëmendjes “tjetrin” ideal që lidhej me të kaluarën e trazuar të Evropës dhe “ne-në kuptimplotë” ideale, e konceptuar tashmë si një “komunitet sigurie”. NATO duhej të përfshihej në mënyrë sa më të shpejtë në përshtatjen e rolit të saj nëse dëshironte të “qëndronte në skenë”. Përgjigja erdhi nëpërmjet miratimit të Konceptit të Ri Strategjik, në Nëntor të vitit 1991. Dokumenti i ri theksonte dialogun, partneritetin, bashkëpunimin dhe nënvizonte se tashmë kërcënim përbënte mungesa e stabilitetit politik dhe trazirat etnike në pjesët e brishta të Evropës. Ky rezultoi të ishte një parashikim i saktë, por meqenëse NATO në fillim të periudhës nuk kishte ripërcaktuar rolin e saj për “të dalë jashtë zonës”(go out –of –area”), ajo nuk mundi të luante një rol të plotë në Ballkan. Kjo ishte e vërtetë, pavarësisht faktit që dispozita për një rol në menaxhimin e krizave ishte pjesë e Konceptit të Ri Strategjik, i cili parashikonte në këtë rast “menaxhimin e krizave që preknin sigurinë e anëtarëve të saj.”⁸⁰ Përfshirja e NATO-s në krizat e Ballkanit filloi me ngadalësi dhe përpjekjet e para u kryen përgjatë

⁸⁰ http://www.nato.int/issues/crisis_management/index.html/role

vitit 1992, me synimin fillestar për të monitoruar zbatimin e embargo-s e armëve të vendosur nga OKB-ja për ish-Jugosllavinë. Megjithatë, në vitin 1995 NATO ndërhyri ushtarakisht duke çimentuar në këtë mënyrë rolin e organizatës në parandalimin e konfliktit dhe menaxhimin e krizave, çka nënkuptonte se ajo po kapërcente një prag të rëndësishëm lidhur me të ashtuquajturin koncept “jashtë zonës” (out of area).

Detyra e transformimit të “tjetrit” nga konkret në një “tjetër” ideal apo ajo e një “ne-je kuptimplotë” nga “ne-ja e botës së lirë” drejt një “ne-je si komunitet sigurie” (i përbërë nga shtetet demokratike), nuk ishte e lehtë. Të dyja konceptet ishin abstrakte dhe kërkonin mjaft debate për shkak të vështirësisë në përcaktimin e “vetes” dhe në mungesën e një “tjetri” të dallueshëm dhe konkret. Gjithashtu, nuk mund të krijoheshin kufij logjikë apo konkretë për “veten”, sa kohë të gjithë vlerat po bëheshin gjithnjë e më shumë të përbashkëta edhe për aktorët që nuk ishin pjesë e NATO-s (shumë prej të cilëve pa ndonjë mundësi reale për të qenë anëtarë të organizatës). Thjesht, ishte e vështirë për të përcaktuar “veten” i mbështetur vetëm tek vlera të tilla si demokracia liberale. Teksa kërkesat për anëtarësim e asociim në NATO u rritën, NATO duhet të shqyrtonte me kujdes kriteret e saj për anëtarësim. Megjithatë, që të formulonte kriteret të qarta për anëtarësimin, asaj i duhej të ishte më e saktë rreth përcaktimit të asaj që tashmë i jemi referuar si “vetja”. Rrjedhojë e këtyre përpjekjeve ishte një projekt i madh i socializimit të shteteve (state socializing) në të cilin NATO u bë aktori kryesor i socializimit të demokracisë liberale dhe standardeve të sjelljes që shoqëronin këtë proces në të gjithë Evropën e Re (Schimmelfenning et.al.2006). Megjithëse shumica e procesit të socializimit u përqëndrua në krijimin e “ne-së” nëpërmjet nxitjes së normës, procesi u shndërrua në vetë-transformues dhe kontribuoi në rikrijimin e “vetes” së NATO-s përmes rindërtimit të Aleancës si një nxitëse normash dhe socializuese (socializer). Brenda një kohe të shkurtër, NATO ka krijuar një rrjet strukturash institucionale për qëllime socializimi të tilla si Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) dhe Partneritetin për Paqe (PpP). NATO e ka marrë shumë seriozisht rolin e ri si aktor socializues (socializing agent) dhe e ka përcaktuar nxitjen e normave liberale dhe praktikave që lidhen me këtë proces si një ndër rolet kryesore të organizatës. Si rezultat përcaktimi i rolit të NATO-s pas Luftës së Ftohtë, mund të përkufizohet si një aleancë mbrojtëse e me përgjegjësi të shtuara për parandalimin e konfliktit dhe menaxhimin e krizave, ashtu sikurse edhe si një organizatë me një rol të rëndësishëm në rritje, si nxitëse e normave të rendit liberal.

1999 dhe përtej-shfaqja e kërcënimeve të reja dhe detyrave praktike

Me rastin e 50 vjetorit të krijimit të saj dhe gjatë fillimit të fushatës së bombardimeve në Kosovë, vendet e para ish-komuniste u mirëpritën në Aleancë. Me këtë rast u rishikua edhe Koncepti i Ri Strategjik i miratuar që nga viti 1991, duke hequr fjalën “i ri” nga titulli dhe duke shtuar menaxhimin e krizave, partneritetin, bashkëpunimin dhe dialogun në zonën e Atlantikut Verior, si një prioritet të katërt strategjik kolektiv (Rynning and Ringsmose 2009, 10). Megjithatë, në termat e përcaktimit të vetëpërfaqësimit, koncepti i ri strategjik ishte disi i mjegullt, kur shprehet se sfidat dhe rreziqet e ardhshme dukej se buronin nga “brenda dhe rreth zonës Euro-Atlantike” (NATO 1999, 7) dhe se Aleatët duhej të merrnin parasysh edhe “rreziqet e një natyre më të gjerë” dhe të “kontekstit global (Flockhart dhe Kristensen 2008, 9). Është me rëndësi të theksojmë se në këtë rast, dokumenti strategjik ndoshta nuk është mënyra më e mirë për të gjykuar konceptimin e NATO-s për “veten” për periudhën pas 1999, sepse ajo që Koncepti Strategjik përshkruan shumë qartë ishte situata para këtij viti.

Që prej miratimit të Koncepti Strategjik të 1999-ës, NATO ka qenë “në mes të vorbullës”. Ngjarjet e rëndësishme që formëzuan NATO-n gjatë kësaj periudhe përfshijnë veçanërisht fushatën e Kosovës. Pavarësisht suksesit të misionit, kjo fushatë nxori në pah dallimet ndërmjet amerikanëve dhe evropianeve për mënyrën sesi përqasen me luftën si edhe mungesat e mundësive të vendeve të caktuara të Aleancës lidhur me kapacitetet teknologjike e ushtarake. Paaftësia e evropianëve për të marrë pjesë plotësisht në fushatën ajrore të Kosovës sfidoi seriozisht konceptin e vetë NATO-s si një organizatë ushtarake, e cila duhet të jetë e aftë të merret në mënyrë efektive dhe të koordinuar me menaxhimin e krizave dhe parandalimin e konfliktit. Konceptimi negativ për “veten” u përkeqësua më tej kur NATO, pas ngjarjeve tragjike të 11 Shtatorit 2001, vendosi të zbatojë Nenin 5 vetëm për të ofruar ndihmë në Afganistan, por që u refuzua me mirësjellje nga SHBA-ja. Aleatët evropianë u ndjenë të prekur nga kjo, dhe administrata e Bushit e humbi shansin që të rigarantonte aleatët Evropianë se NATO vlerësohej ende nga SHBA-të. Ngrica përgjatë Atlantikut u thellua prej retorikës së ashpër së administratës së SHBA ndaj “boshtit të së keqes” dhe “goditjeve parandaluese”, e cila arriti në një nivel të tillë sa që disa parashikuan “fundin e rendit ndërkombëtar të miratuar nga të gjitha palët” (Petereson 2004, 624). Kjo lloj ngrice në

marrëdhënie u kthye në një “eksperiencë afër vdekjes”⁸¹ kur NAC, në Shkurt të 2003, refuzoi të jepte autorizimin për një planifikim të avancuar ushtarak të NATO-s në ndihmë të Turqisë, në mënyrë që ajo të mund të mbrohej në rast të luftës në Irak. Që prej pranverës të vitit 2003, NATO kaloi rreth 4 vjet krizash të vazhdueshme për një sërë çështjesh (Pond, 2004). Siç vërente edhe Hitchcock (2008, 54) arsyeja përse krizat e fillim shekullit XXI dukeshin kaq të mëdha është se ato – veçanërisht kriza e Irakut – kanë ndalur zbatimin me sukses të procesit të përshtatjes, bërjes së rregullave dhe kompromisit (Hitchcock, 2008). Larmia e pakënaqësive të shumta që shoqëruan përshtatjen e nevojshme strukturore pas ngjarjeve të 11 Shtatorit dhe një sërë krizash që u shfaqën në rendin politik të Aleancës, nënkuptonin se NATO nuk qe në gjendje të arrinte një marrëveshje apo zgjidhje mbi mënyrën e përshtatjes së rolit të saj. NATO ishte në një pikë ku ajo thjesht duhej të ndërronte faqen. Që prej asaj kohe dy opsionet e Ikenberry (2008), “zgjidhje” ose “përshtatje”, janë zëvendësuar me një ligjërim të ri mbi “transformimin”.⁸²

Rynning dhe Ringsome (2009, 16) vërejnë se aktualisht ekzistojnë dy vizione konkurruese për NATO-n. Njëri është “Kthehu në shtëpi NATO (“Come Home NATO)”, që bën thirrje për një organizatë me karakter rajonal me fokus tek çështjet që lidhen me Nenin 5. Tjetri është “Globalizohu budalla (Globalize, stupid)”, që argumenton se NATO duhet të jetë një organizatë më globale. Megjithëse çështja nuk është zgjidhur dhe është më shumë se çfarëdo aspekt i theksimit më shumë ose më pak të një elementi, NATO ka marrë një sërë vendimesh të cilat mund të shihen sikur po e ripërcaktojnë atë gradualisht, nga një organizatë rajonale në një organizatë të aftë që të veprojë globalisht. Në praktikë, vendimi i 11 gushtit 2003 për të marrë përgjegjësinë për Forcën Ndërkombëtare të Ndhmës për Sigurinë në Afganistan (International Security Assistance Force, ISAF) – një mision që si rrjedhojë e zgjeroi në mënyrë të dukshme qëllimin e saj gjeografik dhe operacional, nënkuptonte që NATO tani, për më mirë apo më keq, po lëvizte jo vetëm “jashtë zonës”

⁸¹ Një diplomat NATO-s që nuk donte të identifikohet e përshkroi me këto terma kundërshtimin që i bëri NAC respektimit të Nenit 4 të Traktatit të Aleancës së Veriut

⁸² Fjala “transformim” u shfaq dendurazi në ligjërimin e NATO-s pas vitit 2003. Megjithëse është ndryshe nga termi që është përdorur në të njëjtën mënyrë si këtu, përdorimi i saj i shpeshtë nënkuptonte se është i nevojshëm një ndryshim i madh – dhe jo thjesht një përshtatje.

por edhe jashtë rajonit Euro-Atlantik (Flockhart and Kristensen, 2008). Transformimi i NATO-s në një aktor global e më të lëvizshëm mund të shihet edhe në krijimin e Forcës Reaguese të NATO-s (NATO Response Force NRF). NRF-ja konsiston në forca më të afta për të vepruar ndaj përballimit të kërcënimeve atje ku shfaqen, sesa në struktura tradicionale që mbështeten mbi një mbrojtje të madhe territoriale që qëndron e palëvizur. Që prej vitit 2006, kjo është gjithashtu e dukshme edhe në Udhëzuesin Gjithëpërfshirës Politik (Comprehensive Political Guidance), i cili mund të shihet si një koncept i ndërmjetëm strategjik, që përshkruan si kërcënime të prekshme terrorizmin dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.

Rezultati përfundimtar mbi konceptin e ri strategjik të NATO-s do të mbetet i panjohur deri në fund të 2010. Rrjedhimisht, është ende herët për të thënë nëse NATO zgjedh variantin “Kthehu në shtëpi (Come Home)” ose “Globalizohu budalla (Globalize, stupid)”. Megjithatë, NATO ka qenë e përfshirë në një sërë aktivitete që duket se tregojnë mbizotërimin e një koncepti të rolit që thekson vizionin “Globalizohu budalla” për organizatën. Përfshirja ushtarake praktike e NATO-s në Kosovë dhe Afganistan, aktivitetet e saj kundër piraterisë në Gjirin e Adenit, ndihma ndaj tërmetit në Pakistan dhe ajo ndaj Unionit Afrikan në Darfur, janë të gjitha aktivitete, të cilat çojnë drejt konceptimit të rolit të saj si një organizatë sigurie me një grup të gjerë detyrash dhe hapësirash gjeografike. Nga ana tjetër, vizioni “Kthehu në Shtëpi” dukej se po merrte gjithnjë e më shumë mbështetje, të paktën deri para fillimit të luftës Ruso-Gjeorgjiane dhe sulmit kibernetik mbi rrjetin e serverave të institucioneve qeveritare të Estonisë në 2006. Në verën e vitit 2009 u ndërmor një proces i gjatë konsultimi me qëllim përcaktimin e një Koncepti të Ri Strategjik për NATO-n.⁸³ Gjykuar nga diskutimet e gjalla që janë zhvilluar që prej fillimit të procesit, të dyja vizionet janë ende në lojë, por një theks më i madh po vihet mbi Nenin 5 dhe mbi një rol më global. Ndoshta mund të jetë koha për të pranuar më në fund se NATO nuk është më thjesht një aleancë mbrojtëse. Ajo po bëhet gjithnjë e më shumë një institucion i menaxhimit të sigurisë, në gjendje të veprojë ushtarakisht dhe politikisht në kontekstin rajonal dhe atë global, në bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare dhe me një numër gjithnjë e më të madh

⁸³ Procesi filloi me një konferencë të aktorëve kryesorë në Bruksel “Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s: Fillimi i Procesit” në Korrik 2009. Delegatëve të ftuar iu kërkua të përcaktonin axhendën dhe çështjet kryesore të NATO-s në shekullin e XXI.

partnerësh dhe marrëdhëniesh me vende të veçanta jo vetëm në rajonin Euro-Atlantik, por edhe më larg si Australia dhe Zelanda e Re.

Transformimi i marrëdhënieve - Rikrijimi i “NE”-së dhe partnerëve

Siç theksohet edhe prej Lordit Ismay, krijuesit e Rendit Liberal dhe të NATO-s ishin plotësisht të ndërgjegjshëm se roli i saj nuk mund të ishte vetëm të “mbante Rusët jashtë”. Ajo duhej gjithashtu që të transformonte edhe marrëdhëniet mes shteteve që deri para pak kohësh kishin qenë armiq të egër me njëri-tjetrin, apo të atyre që kishin qenë të kënaqur me ekzistencën e tyre të izoluar dhe që mbroheshin prej oqeanëve Atlantik dhe Paqësor. Nga perspektiva e Teorisë së Rolit, transformimi i marrëdhënieve që kanë krijuar gradualisht konceptin e “ne-së” dhe atë të “partnerëve”, janë zhvilluar përmes ndërveprimit bazë, paralelisht me procesin e përshtatjes së rolit të përshkruar më sipër. Këto kanë qenë procese të vazhdueshme përgjatë historisë së NATO-s, megjithë ndryshimet në rrjedhat e tyre, të cilat kanë qenë ndikuar nga të njëjtat momente të jashtëzakonshme që përcaktuan përshtatjen e rolit. Uniteti dhe ruajtja e “ndjesisë së ne-së” ka qenë gjithmonë prioritet në NATO, për shkak se uniteti ndërmjet shteteve sovraane me interesa, kultura dhe sfonde historike të ndryshme duhet forcuar. Kjo edhe sepse NATO u krijua rreth një parakushti për mbrojtjen nukleare, i cili nëse nuk respektohet sigurisht që do të çonte pothuajse në shkatërrimin e mbrojtësit – SHBA-së. Si rrjedhojë, kohezioni është vlerësuar gjithmonë si shumë i rëndësishëm për NATO-n, për shkak se shenjat e përçarjes mund ta vinin në dyshim besueshmërinë e garancisë së sigurisë bërthamore. Për këtë arsye të gjithë shtetet anëtare kanë qenë subjekt i presionit thelbësor moral për të rënë dakord për vendime që do të çonin qoftë në “zgjidhje”, qoftë në “përshtatje”, ashtu sikur besohej se “transformimi” apo “çarja” do të tregonin një mungesë kohezioni që mund të cënonte besueshmërinë e sipërpërmendur. Megjithatë, përgjatë rrjedhës së viteve kanë qenë të shumtë shembujt ku interesat e ndryshme të shteteve anëtare kanë penguar që të arrihet qoftë zgjidhja, qoftë përshtatja. Në situata të tilla, NATO është mbështetur mbi “nacionin e ambiguitetit” - një pozicion ku të gjithë anëtarët në heshtje bien dakord të mos jenë në një mendje dhe të mos shtyhen drejt qartësisimit të pozicionit, por duke qenë në gjendje të ruajnë në dukje kohezionin mes tyre.

Ndërveprimi bazë dhe krijimi i komunitetit

NATO ka qenë karakterizuar nga marrëveshjet dhe ndërmjetësimi mes anëtarëve të saj, me qëllim që të ruajë konsensusin në të gjitha çështjet që lidhen me mbarëvajtjen e Aleancës. Çështjet me rëndësi të veçantë, kanë qenë ato strategjike, buxheti, roli i armëve bërthamore, besueshmëria e garancisë bërthamore, riarmatimi i Gjermanisë dhe zgjerimi. Në të gjitha proceset e arritjes së konsensusit, SHBA-të kanë patur privilegjin që, për shkak të aftësive të tyre, të përcaktojnë vlerat e përbashkëta dhe mënyrat e pritshme të sjelljes. Për këtë arsye, brenda organizatës SHBA-të kanë luajtur rolin e aktorit socializues (socializing agent) krahas për krahas me shtetet anëtare. Pozicioni i privilegjuar i SHBA-së si aktori kryesor socializues është rrjedhojë e dy ujdivë historike mes SHBA-së dhe Evropës. Njëra prej tyre është që SHBA-të i ofruan evropianëve mbrojtje dhe akses në tregjet e tyre. Në këmbim të kësaj, evropianët pranuan lidhshmërinë amerikane dhe ranë dakord të jenë partnerë të besueshëm duke ofruar mbështetje diplomatike, ekonomike dhe logjistike për këtë udhëheqje (Ikenberry 2008, 10). Tjetra është se SHBA-të pranuan t'i përmbaheshin një sistemi ndërkombëtar për të cilin ishte rënë dakord, ndërsa evropianët pranuan projektin Amerikan për rendin institucional. Kjo lloj marrëveshjeje u pranua nga shumica e anëtarëve, megjithëse Franca nuk e pranoi kurrë tërësisht pozicionin udhëheqës të Amerikës dhe ka vënë gjithmonë në dyshim besueshmërinë e garancisë së sigurisë.

Praktika e konsensusit të pazhurmshëm që realizohej brenda NATO-s nën udhëheqjen e SHBA-së, ka qenë pjesë përbërëse e identitetit të shteteve anëtare dhe, me kalimin e kohës, ka formëzuar një sens në rritje të “ndjesisë së ne-së”. Kjo ka farkëtuar gradualisht Aleancën si një komunitet të shteteve të mbështetur mbi vlera të përbashkëta dhe si një identitet kolektiv dhe koncepte të përbashkëta për “tjetrin”. Megjithëse në dukje nuk ishte e mundur që arkitektët e Aleancës Atlantike të krijonin një “komunitet sigurie”, nëpërmjet një rastësie fatlume ata duket të kenë vënë në zbatim pikërisht atë që Karl Deutsch dhe kolegët e tij përkufizuan më vonë si “përbërësit e nevojshëm për të krijuar një komunitet sigurie pluralist” (Deutsch, 1957). Deutsch et al argumenton se nevojitet një forcë udhëheqëse që të ndihmojë në krijimin e një komuniteti sigurie rreth një ndjesie të përbashkët kërcënimi dhe se mbajtja e këtij komuniteti sigurie varet nga ekzistenca e ndjenjës së vlerave të përbashkëta dhe një angazhim i plotë për të biseduar dhe arritur marrëveshje, sesa

për të kundërshtuar dhe luftuar (Hall 2008, 229). Përveç kësaj, është edhe përcaktimi tjetër i Deutsch se ndërtimi i këtij komuniteti çohet përpara përmes shumësisë së interesave dhe shpeshësisë së krizave. Kjo duket të jetë saktësisht ajo çfarë ndodhi gjatë Luftës së Ftohtë, ku nëpërmjet praktikave të ndërveprimit brenda NATO-s shtetet e ndryshme me interesa të veçanta, u shndërruan gradualisht në një “ne” kolektive.

Megjithatë, krijimi i rolit nëpërmjet ndërveprimit bazë u realizua në një mjedis ku ekzistonte një koncept i qartë për “ne-në” (anëtarët e NATO-s) dhe një ndarje e qartë hierarkike brenda “grupit ne”, ku zëri i SHBA-së u pranua që të ishte “më i lartë” sesa i pjesës tjetër, me kusht që ai të qëndronte brenda hapësirave të rendit institucional për të cilin kishin rënë dakord. Për më tepër, ndërveprimi bazë u realizua në kushtet kur të gjithë kishin pranuar se kush ishte “tjetri” i përbashkët si dhe cilat qenë procedurat praktike për ndërveprim, që mbështeteshin tek bindja dhe ndërmjetësimi për sipërmarrjen e përbashkët (Wenger, 1998, 77). Këto përbënin kushte që duhet t’i pranonin edhe të gjithë anëtarët e rinj, dhe kanë qenë një karakteristikë e vazhdueshme e të gjithë ndërveprimit bazë brenda grupit “ne-1”, mbi të cilin janë mbështetur të gjithë vendimet e marra. Nëpërmjet institucionalizimit të praktikave të bindjes dhe ndërmjetësimit, aktorët iu bashkëngjiten emocionalisht qoftë praktikës, por edhe sipërmarrjes së tyre përbashkët, duke e bërë shumë të vështirë edhe nga aspekti emocional ripërcaktimin apo thyerjen e rutinave të vjetra (Adler 2008, 204). Megjithatë, ishte pikërisht praktika e krijuar e bindjes dhe e ndërmjetësimit mbi një veprim të përbashkët, e cila u shpërbë gjatë presidencës së Bushit, veçanërisht në lidhje me luftën në Irak. Në këtë mënyrë u cënuan qasjet e deri atëherëshme të ndërveprimit bazë që ishin krijuar mes grupit “ne-1”, duke lënë pasojë të thella mbi aftësinë e Aleancës për të realizuar përshtatjen e nevojshme të rolit në përgjigje të ndryshimeve strukturore të situatës ndërkombëtare që pasuan 11 Shtatorin.

Ndërveprimi bazë dhe socializimi i normës

Marrëdhëniet e ngushta dhe të qëndrueshme, të krijuara brenda grupit “ne-1”, u vunë në provë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë edhe nga presioni këmbëngulës i ish “armiqve” (ish-vendet anëtare të Traktatit të Varshavës) për t’u bërë pjesë e “ne-së”. Fillimisht anëtarët e NATO-s nuk ishin entuziastë rreth zgjerimit të grupit tashmë të krijuar të “ne-1”, pasi kjo u pa si një

burim i mundshëm për të minuar kohezionin e rëndësishëm të Aleancës. Megjithatë, nuk mund t'i rezistojë politikisht presionit për marrëdhënie më të ngushta me ish-anëtarët e Paktit të Varshavës. Rrjedhimisht, në korrik të vitit 1999 NATO ra dakord për "t'i zgjatur dorën e miqësisë" ish-kundërshtarëve të tyre të dikurshëm të Traktatit të Varshavës. Proceset e ndërveprimit bazë në NATO ndryshuan karakterin e tyre menjëherë dhe rrjeti i aktorëve ndërveprues u rrit në mënyrë të dukshme. Siç është argumentuar bindshëm nga Alexandra Gheciu (2205), NATO u angazhua sistematikisht në nxitjen e normave të demokracisë liberale për Evropën Qendrore e Lindore, duke u shndërruar në një aktor të socializimit (socializing agent) edhe jashtë kufijve të saj (Gheciu). Duke bërë këtë, koncepti i rolit të NATO-s për veten ndryshoi, tashmë për t'u përshtatur me aspektet që lidheshin me të qenit socializues i jashtëm i normës (external norm socializer), çka gjithashtu shtronte nevojën për një ndryshim të konsiderueshëm sa i përket përcaktimit të rolit brenda shteteve, në mënyrë që të arrihej qëllimi përfundimtar i përpjekjeve socializuese dhe konceptualizimit të elementit "ne".

Fillimisht NATO nuk kishte projekt të qartë për rrjetin e zgjeruar institucional që duhej krijuar dhe që do të pasonte vendimin "për t'u shtrirë dorën e miqësisë" vendeve të ish-Traktatit të Varshavës. Madje edhe kur ky projekt ishte gati, shpejtësia mbresëlënëse e ngjarjeve nënkuptonte një ndryshim të shpeshtë planesh. P.sh. kur iniciativa e parë e NATO-s, – Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC), - realizoi takimin e tij përrues të dhjetorit 1990, iu desh të ndryshonte thellësisht natyrën e tij sepse gjatë kohës së zhvillimit të këtij takimi, BS pushoi së ekzistuari si entitet. Ajo që në fillim ishte menduar të ishte një grup i menaxhueshëm prej 23 shtetesh, papritur u rrit duke përfshirë edhe shtetet që pasuan shpërbërjen e BS. Rritja e papritur e NACC solli si rrjedhojë një larmi interesash dhe dallimesh në nivelin e pjesëmarrjes, pasi ato shtete me objektiv strategjik për të arritur anëtarësimin ndjenë se nevojat e tyre nuk do të gjenin përgjigje të mjaftueshme në Këshillin e Bashkëpunimit. Vendet e Evropës Qendrore e Lindore-veçanërisht Polonia, Hungaria dhe Çekosllovakia (më vonë Republika Çeke dhe Sllova), e klasifikuan veten e tyre si më afër "ne –së kuptimplotë" (NATO-s) sesa disa prej ish-republikave sovjetike. Ata argumentonin në mënyrë bindëse për nivele të ndryshme mes anëtareve të NACC, çka në vitin 1994 solli krijimin e një iniciative të re institucionale për menaxhimin e socializimit (Partneriteti për Paqe PpP) .

Megjithëse ende nuk është plotësisht e qartë nëse NATO që prej fillimit kishte një ide të mirëpërcaktuar se PpP ishte një taktikë për të fituar kohë, përpara se të merreshin vendimet e vështira, apo nëse ajo ishte hapi i parë drejt anëtarësimit të plotë në NATO. Nga këndvështrimi i krijimit të rolit, PpP mund të thuhet se ka qenë një lëvizje e zgjuar. PpP u mbështet mbi parimet binjake të vetë-diferencimit dhe vetë-financimit, të cilat nënkuptonin në praktikë që çdo vend i PpP-së të vendoste rrugën dhe qëllimet e procesit të tyre të socializimit.

Megjithatë, në fakt NATO u la përgjegjësia e kategorizimit në PpP vetë vendeve pjesëmarrëse, ndërkohë që roli i saj u kufizua tek përcaktimi i kushteve për anëtarësimin e grupit “ne – 1”, duke vendosur mbi të gjitha kriterin politik të anëtarësimit dhe listën specifike të fushave në të cilën NATO mund të punonte me partnerët për të përmbushur kriteret. Nuk ishin vetëm vendet e ardhshme anëtare që ishin kredhur në një kurbë të procesit të të nxënit, por kjo ishte e vërtetë edhe për NATO-n. Në brendësi të organizatës procesi i të mësuarit ishte i dukshëm sa i përket zhvillimit të metodave të socializimit dhe përshtatjes së strukturave për socializim. Kjo u vu re veçanërisht në rastin e metodës së vetëkategorizimit, e cila u zhvillua më tej në Planin e Veprimit për Anëtarësim (Membership Action Plan)-MAP, në të cilin shtetet e ardhshme anëtare punonin drejt përmbushjes së të gjithë kriterëve të nevojshme që kërkoheshin për t’u vlerësuar më pas nga NATO. Me kalimin e kohës teksa NATO-ja përshtatej më shumë me rolin e saj të ri si socializues normash (norm socializer), u shtuan kriteret e reja specifike për anëtarësim, të mbështetura mbi zhvillimin e rregullave bazë të komunitetit perëndimor (Schimmelfing, et. Al 2006, 29) që kishin gjithashtu një mbështetje në rritje edhe mbi nevojat e vetë NATO-s në Kosovë dhe Afganistan. Gjithashtu, anëtarëve të ardhshëm iu bë e ditur se prej tyre pritej të silleshin si prodhues të sigurisë (security producers) dhe jo thjesht si konsumatorë (security consumers) të ndihmës së NATO-s (Moore 2009, 3).

Që prej fillimit të procesit të PpP në vitin 1994, 12 vende kaluan nga grupi “ne-2” në atë “ne-1” duke përfunduar anëtarësimin e plotë në NATO. Si rrjedhojë, grupi i anëtarëve të ardhshëm u reduktua ndjeshëm, ndërkohë që anëtarësia e NATO-s u rrit me 28 anëtarë. Në këtë proces, koncepti i rolit të “ne-1” ka ecur pak, sa kohë që identiteti kolektiv i NATO-s ende shihet si një komunitet i shteteve demokratike, i konceptuar si një komunitet sigurie. Në të kundërt, koncepti i rolit dhe vetes të këtyre shteteve, të cilët kanë lëvizur nga grupi “ne-2” në “ne-1” ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme, duke pohuar se NATO ka patur sukses të

konsiderueshëm në rolin e saj të ri si aktor socializues. Për më tepër, shtetet e reja kanë gjithashtu një ndikim mbi ndërtimin e konceptit të rolit të NATO-s, përsa kohë ata janë përkrahësit kryesorë për vizionin “Kthehu në shtëpi (Come Home)” të NATO-s, sikurse shtetet e reja anëtare janë mbështetësit kryesorë për një theks më të madh në çështjet e Nenit 5, sesa për një rol më global si një institucionin i menaxhimit të sigurisë.

Ndërveprimi bazë dhe partneriteti

Një prej besimeve më të qëndrueshme që është krijuar në NATO që prej fundit të Luftës së Ftohtë lidhet me faktin se territori i vetë NATO-s nuk mund të jetë plotësisht i sigurt nëse mbretëron paqëndrueshmëria përgjatë periferisë së tij (Moore, 2009, 1). Megjithëse shumica e vëmendjes i është kushtuar krahut lindor, krahu jugor ka qenë njohur gjithashtu si një zonë e paqëndrueshme e me shumë çështje të pazgjydhura në fushën e sigurisë. Për këtë arsye, duke patur parasysh suksesin e programit Partneritet për Paqe (PpP) (Adler 2008, 210) dhe konceptin e rolit si socializues norme, NATO vendosi në 1994 të nxiste iniciativa të tjera, sesa thjesht një PpP (Adler 2008) me shtete, anëtarësia e mundshme e të cilëve në NATO ishte minimale ose e pamundur. Në vitin 1994, NATO krijoi të ashtuquajturin Dialog Mesdhetar DM me 7 shtete (Izraeli, Egjipti, Maroku, Mauritanai, Tunizia, Jordania dhe Algjeria) ku të gjithë pjesëmarrësit as nuk synonin, por as nuk ishin ftuar të bëheshin anëtarë të NATO-s. Në vitin 1997 u krijua Këshilli i Përhershëm i Përbashkët NATO-Rusi së bashku me vendimin për shndërruar Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA). Ai u krijua për të qenë një forum për konsultime politike dhe ishte i lidhur me bashkëpunimin praktik të PpP-së, duke i bërë kështu dy institucione të plotësonin njëri-tjetrin (Flockhart dhe Kristensen 2008, 17). Në të njëjtën kohë, përgatitjet e veçanta për anëtarësim i kaluan MAP, i cili në këtë mënyrë krijoi ndarjen e PpP-së dhe KPEA-së nga çështja e anëtarësimit. Që prej vitit 1997, u krijuan iniciativa të tjera institucionale, synimet e të cilave përfshinin marrëdhënie më të ngushta institucionale me Rusinë, Ukrainën dhe Gjeorgjinë duke njohur faktin se këto shtete kanë çështje të veçanta që nuk mund të zgjidhen brenda marrëveshjeve_ekzistuese të partneritetit dhe bashkëpunimit. Procesi i vendosjes së marrëdhënieve me shtetet jashtë NATO-s mori një hov të ri me sulmet terroriste të 11 Shtatorit 2001,

teksa NATO gradualisht braktisi fokusin e saj me qendër Evropën duke krijuar Inicativën e Bashkëpunimit të Stambollit (IBS) në vitin 2004, e cila përfshiu Bahrejin, Kuvajtin, Katarin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe dhe duke deklaruar synimin për ta shndërruar Dialogun Mesdhetar në një partneritet të mirëfilltë (Moore, 2009). Së fundmi, në Samitin e Rigës në vitin 2006, NATO u hap edhe për një kategori tjetër shtetesh që në mënyra të ndryshme u përcaktuan si “partnerët globalë” ose “3 jo- të” (jo – anëtarë të NATO-s, jo-partner, jo-evropian) apo siç përkufizohen sot “partnerët e tjerë përgjatë globit”. “Partnerët e tjerë” përfshijnë shtete si Australia, Zelanda e Re, Japonia dhe Koreja e Jugut.

Si rrjedhojë, NATO ka tashmë një rrjet marrëdhëniesh të ndryshme me shtete që për një sërë arsyesh nuk do të bëhen qoftë pjesë e grupit “ne-1” apo “ne-2”, por nuk janë as pjesë e “tjetrit”. Grupi i shteteve që gjerësisht përcaktohen si partnerë mund të ndahen në 5 nëngrupe:

- Vendet e PpP-së që nuk kanë mundësi anëtarësimi (p.sh. disa prej ish-Republikave Sovjetike të Azisë Qendrore.

- Vendet e PpP që nuk shfaqin dëshirë për të bërë vende anëtare (Finlanda, Suedia, Irlanda, Zvicra dhe Austria)

- Vendet e Dialogut Mesdhetar apo të Inicativës për Bashkëpunim të Stambollit ku të gjithë nuk kërkojnë të anëtarësohen, por as nuk ftohen për të bërë vende anëtare.

- ”Partnerët e tjerë përgjatë globit” (këtu u referohemi si “partnerët globalë”) të tillë si Australia, Zelanda e Re, Japonia dhe Koreja e Jugut, me të cilët NATO ndan një numër vlerash e interesash të përbashkëta, por të cilët nuk shihen si anëtarë të mundshëm.

- Vendet me marrëdhënie të veçanta të tillë si Rusia, Ukraina dhe Gjeorgjia, ku Gjeorgjia dhe Ukraina synojnë të dyja të anëtarësohen, por që për këtë duhet të zgjidhen çështje të veçanta.

Nga këndvështrimi i Teorisë së Rolit dhe TIS-së, marrëdhënia e NATO-s me një tërësi shtetesh të ndryshme është e ndërlikuar, për shkak se përshtatja e rolit dhe ndërveprimi bazë është i ndërlidhur më shumë se zakonisht, dhe sepse retorika e NATO-s (dhe partnerëve) është e mbështjellë më shumë se në raste të tjera prej të artikulimit diplomatik. Megjithatë, është e qartë se hovi i ringjallur për zhvillimin e formave të reja të partneritetit mund të shihet si një reagim kundrejt ndryshimeve strukturore që pasuan mjedisin ndërkombëtar pas 11 Shtatorit. Më e pakta që vjen si rezultat i këtyre marrëdhënieve është rritja e nevojës për të kontribuar në operacionet e kushtueshme të NATO-s në Afganistan, ku kontributet nga vende të tilla si Suedia dhe Australia janë të mirëpritura. Nga ana tjetër, vendimi i njëkohshëm

për të ngritur DM-në dhe për të krijuar IBS-në është qartësisht i lidhur me ngjarjet e 11 Shtatorit. Megjithatë, më shumë sesa të kërkojnë kontribute materiale prej tyre, këto marrëdhënie theksojnë dialogun politik, pjesëmarrjen në aktivitetet e PpP-së, trajnimet e tjera, sikurse edhe në kurset e shkollave të NATO-s (Moore 2009).

Marrëdhëniet u ngritën gjatë presidencës së Bushit dhe gjatë retorikës të nxitjes së demokracisë në Lindjen e Mesme dhe rreth Mesdheut. Megjithatë, është e vështirë të pohohet se këto vende kanë të njëjtin potencial për nxitjen e demokracisë përsa kohë ata as kërkojnë, por edhe as u ofrohet anëtarësimi në NATO. Ata as nuk janë shtet që e klasifikojnë NATO-n si “ne- ja kuptimplotë”, çka e kufizon në mënyrë të dukshme mundësitë për socializim. Megjithatë, siç e përmendëm edhe më herët në këtë kapitull, marrëdhëniet me DM dhe IBS janë ngritur nga Sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen në një nivel të veçantë prioriteti për Aleancën Atlantike. Kjo mund të shihet si një përpjekje e vetëdijshme nga z. Rasmussen për të hyrë në një fazë të re marrëdhëniesh të ndërveprimit bazë me këto vende si edhe për të kundërvepruar ndaj ndikimit negativ që u shfaq prej mënyrës së Z. Pedersen (në postin e ish-kryeministrit të Danimarkës) u mor me krizën e karikaturave që ironizonin profetin Muhamed në gazetën daneze gjatë vitit 2006. Duke bërë këtë, NATO po kërkon të hyjë në një ndërveprim themelor me vendet myslimane me qëllim për të kundërvepruar ndaj përfytyrimeve negative që u krijuan në këto vende.

Siç përcaktohet edhe në figurën 1 në fillim të këtij artikulli, vijat lidhëse të ndikimit mes NATO-s dhe “partnerëve” **prirën të jenë jo shumë të forta**. Kjo duket se do të vazhdojë të mbetet e tillë edhe me marrëdhëniet e ngritura në një status të veçantë, për shkak se kushtet për një ndikim domethënës nuk janë të pranishme në çdo drejtim. Megjithatë, marrëdhëniet me partnerët globalë ofrojnë qartazi një kontribut shumë të nevojshëm për operacionin në Afganistan në një kohë kur burimet e NATO-s po arrijnë deri në limit. Në mënyrë të ngjashme, vendosja e marrëdhëniesh të mëtejshme me vendet e DM-së dhe IBS-së lind një ndikim pozitiv (pavarësisht natyrës së tyre të kufizuar) mbi marrëdhëniet diplomatike mes NATO-s dhe vendeve myslimane, që mund ta shikojnë ndërhyrjen e saj në Afganistan më shumë negativisht dhe që kanë krijuar një pikëpamje për Sekretarin e ri të Përgjithshëm të NATO-s gjatë krizës së karikaturave në Danimarkë.

Pavarësisht attributeve funksionale të partneriteteve të saj, NATO do të ketë nevojë t'i japë përgjigje pyetjes mbi formën

dhe funksionin e partneriteteve, për shkak se siç pohon edhe Rebecca Moore: “partneriteti është në të vërtetë një debat mbi qëllimin dhe identitetin e Aleancës”

Drejt një aleance të arrirë, me role të shumëfishta dhe marrëdhënie të qëndrueshme

Pyetja se cili është roli i NATO-s, është një pyetje e debatuar që me krijimin e NATO-s në 1949. Në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, ka qenë gjithmonë e qartë se NATO ka patur role të shumëfishta që shtriheshin përtej asaj që të “mbante Rusët jashtë” e teksa mjedisi i sigurisë ndryshonte dhe rolet e NATO-s u bënë më të ndërlikuara dhe të mbivendosura, zuri rrënjë një shkallë konfuzioni e frustrimi, e cila ka qenë portretizuar si krizë në NATO, e shkaktuar prej roleve të shumta dhe mjaft të ndërlikuara. Pikëpamja e paraqitur këtu është se rolet e ndërlikuara e të shumëfishta të NATO-s nuk janë në vetvete shkak i krizave në NATO. NATO është një organizatë e përbërë dhe e ndërtuar mbi një sërë kompromisesh të ndërlikuara, që lindin nga nevoja për role të shumëfishta. NATO-ja e ka menaxhuar në mënyrë të suksesshme këtë ndërlikueshmëri brenda grupit “ne-1, përmes krijimit të një sërë praktikash të mbështetura mbi **këmbënguljen dhe tratativat** që burojnë nga një sipërmarrje e përbashkët (Wenger 1998)” e ku krizat përgjatë historisë së saj pothuajse kanë çuar gjithmonë në zgjidhje apo përshtatje⁸⁴ – ose ambiguitet.

Me ndryshimin e mjedisit të sigurisë, NATO ka ndërmarrë përshtatjen e rolit dhe ndryshuar marrëdhëniet e saj bazë me aktorët e tjerë, çka është saktësisht ajo që duhet të bëjë një organizatë funksionale dhe e konsoliduar për krijimin e një komuniteti sigurie (Hall 2008). Krizat e llojit të rrezikshëm, që është kriza që nuk çon në zgjidhje apo përshtatje, kanë ndodhur vetëm kur NATO u përball me një shkëputje nga praktikat e krijuara mbi arritjen e një zgjidhje apo përshtatjeje, çka ndodhi me përjashtimin e negociimit e të këmbënguljes gjatë presidencës së Bushit, veçanërisht në Luftën e Irakut. Si rrjedhojë mund të pohohet se fundi i këtyre praktikave në NATO përbente një kërcënim kryesor për të dhe jo luftërat në Irak, Kosovë apo Afganistan.

Një organizatë me mjaft eksperiencë si NATO mund dhe duhet të **përfshijë brenda vetes** rolet e shumëfishta dhe ndërveprimet

⁸⁴ Tërheqja e Francës në 1966 nga struktura e integruar ushtarake e NATO-s ishte një përjashtim.

e ndërlikuara me aktorë të tjerë – qoftë si ofruese apo marrëse e normave dhe, për më tepër, duke u përcaktuar gjerësisht si një institucion i menaxhimit të sigurisë. Duke arritur në këtë përfundim, artikulli i kthehet efektivisht çështjes të asaj që kundërshtarët i shohin rolet e shumëfishta të NATO-s si një shenjë dobësie - një kërkim i dëshpëruar i arsyes për të ekzistuar/*raison d'être* - ndërkohë që argumenton se rolet e shumëfishta dhe në evoluim të përhershëm mund të shihen si një funksion i konsolidimit dhe zhvillimit. Ashtu si shoqëritë e ndërlikuara synojnë të kenë një shtrirje të madhe të roleve dhe identitetit (Mennell 1994, 177), ashtu edhe një organizatë e arrirë që përfaqëson këto shoqëri, siç është NATO-ja, duhet të ketë role e marrëdhënie të shumëfishta. Ajo çfarë është e rëndësishme në këtë rast nuk ka të bëjë me atë se cilin rol apo marrëdhënie mund ketë NATO, por nëse ato janë të përputhshme me tërësinë e vlerave e identitetit qoftë të NATO-s, shteteve të saj anëtare, shteteve të ardhshëm anëtare dhe vendeve partnere. Në tërësi NATO ia ka dalë të qëndrojë brenda këtyre kufijve, megjithëse përpara shtrohen pyetje të vështira në vendosjen e marrëdhënieve me regjimet jo-demokratike apo në çështjet se kur dhe ku të ndërhyjë përballë krizave dhe konflikteve që mund të shfaqen në të ardhmen. NATO ka nevojë në mënyrë absolute që të mendojë qoftë për rolin dhe marrëdhëniet e saj dhe t'i formulojë ato në një koncept strategjik, për të cilin duhet të bien të gjithë në një mendje.

REFERENCES

Adler, Emmanuel. 2008. The Spread of Security Communities: Communities of Practice, Self-Restraint, and NATO's Post-Cold War Transformation. *European Journal of International Relations*, 14 (2): 195-230

Deutsch, K.W. 1957. *Political Community and the North Atlantic Area*. Princeton University Press.

Flockhart, Trine 2006 "Complex Socialization: A Framework for the Study of State Socialization. *European Journal of International Relations*, 12 (1): 89-118

Flockhart , Trine and Kristian Soby Kristensen. 2008. NATO and Global Partnerships – To be Global or to Act Globally ? : Danish Institute for International Studies

Gheciu, Alexandra. 2005. Security Institutions as Agents of Socialization? NATO in the New Europe *European Journal of International Relations*, 59 (4): 973-1012

Hall, John A 2008 Passions within Reasons In *The End of the West? Crisis and Change in the Atlantic Order*, edited by J. Anderson, J.Ikenberry and T. Risse: Cornell University Press.

Harmel-Report. 1967. The Future Tasks of the Alliance – NATO Documents

Hitchcock, William. 2008. The Ghost of Crises past: The Troubled Alliance in Historical Perspective. In *The End of the West? Crisis and Change in the Atlantic Order*, edited by J. Anderson, J.Ikenberry and T. Risse: Cornell University Press.

Hollis, Martin & Steve Smith. 1990. *Explaining and Understanding International Relations*: Clarendon Press.

Holsti, K. J 1987 National Role Conception in the Study of Foreign Policy. In *Role Theory and Foreign Policy Analysis* edited by S.G.Walker: Duke University Press.

Ikenberry, John. 2001. *After Victory: Institutions, Strategic Restraint and the Rebuilding of Order after Major Wars*: Princeton University Press

Ikenberry, John. 2008. Explaining Crisis and Change in Transatlantic Relations: In *The End of the West? Crisis and Change in the Atlantic Order*, edited by J. Anderson, J. Ikenberry and T. Risse: Cornell University Press

Keohane, Robert Owen, Celeste A. Wallander and Helga Haftendorn. 1999. *Imperfect Unions: Security Institutions Over Time and Space*. Oxford University Press.

Mead, George Herbert. 1934. *Mind Self and Society*: University of Chicago Press

Mennell, Stephen. 1994. The Formation of We-Images: A Process Theory. In *Social Theory and the Politics of Identity* edited by C. Calhoun: WileyBlackwell.

Moore, Rebeca. 2009. *NATO's Partnerships. In NATO at 60: Reflecting on the Past- Anticipating the Future*: Danish Institute for International Studies NATO 1999. The Alliance's Strategic Concept, NATO Documents

Peterson, J. 2004. America as a European Power: The End of Empire by Integration? *International Affairs* 80 (4):613-629

Pond, E. 2004. *Friendly Fire: The Near-Death of Experience Transatlantic Alliance*: Brookings Institutions Press

Rynning, Sten and Jens Ringsmose. 2009. *Come Home, NATO? : The Atlantic Alliances's New Strategic Concept*: Danish Institute for International Studies

Schimmelfenning, Frank; Stefan; Engert; Heiko; Knobel. 2006. *International Socialization in Europe: European Organization Political Conditionality and Democratic Change*: Palgrave Macmillan

Schlag, Gabi. 2009. *Reconstituting NATO*. Paper present at the ECPR Joint Session on Theorizing NATO. Lisbon

Turner, John. 1987. *Rediscovering the Social Group*: Blackwell

Wenger, Etienne. 1998. *Communities of Practice* : Cambridge University Press

Waever, Ole. 1998. Insecurity, Security and in – Security in the West European Non –War Community. In *Security Communities* edited by E. Adler and M.N. Barnett: Cambridge University Press.

Trine Flockhart është hulumtues tek Instituti Danez për Studime Ndërkombëtare (DIIS)

Can Buharalý, EDAM

MARRËDHËNIE MË TË MIRA NATO-BE KËRKOJNË MË TEPËR SINQERITET

Interesi i kombeve Evropiane për sigurinë dhe mbrojtjen e përbashkët daton prej fundit të Luftës së Dytë Botërore. Themelimi i Bashkimit Evropian Perëndimor (BEP) në 1948, nisma e Komunitetit Evropian të Mbrojtjes (KEM) në 1954, Plani Fouchet i vitit 1961, dhe Bashkëpunimi Politik Evropian që filloi në 1970, përfaqësojnë të gjithë shembuj përpjekjesh në këtë drejtim. Megjithatë, Lufta e Ftohtë dhe themelimi i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) me Shtetet e Bashkuara vonoi deri në vitet 1990 planet për një rol Evropian më aktiv në nismat e sigurisë. Fundi i Luftës së Ftohtë e inkurajoi BE-në të rishikonte kapitullin e sigurisë çka çoi në krijimin e Politikës të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (PJSP) si shtylla e dytë e Traktatit të Mastrihtit të vitit 1991.

Arkitektura e re u përball me riaktivizimin e Bashkimit Evropian Perëndimor (BEP) të përgjumur, duke synuar të përfshijë të gjitha shtetet Evropiane që ishin anëtare të BE-së apo NATO-s. Vendet anëtare të të dyja organizatave u caktuan si anëtare me të drejta të plota, ata që ishin vetëm anëtarët e NATO-s ishin Anëtarë të Asociuar, dhe vendeve që ishin vetëm anëtarë të BE-së iu caktua statusi i Vëzhguesit. Pavarësisht statusit dhe të drejtave të tyre të ndryshme, të 18 shtetet Evropiane u ulën përreth një tavoline të vetme dhe i dhanë zë mendimeve të tyre. Kështu, gjatë viteve 1990, BEP arriti të përmirësonte lidhjet e sigurisë ndërmjet aktorëve të ndryshëm Evropianë.

Kjo periudhë u konkretizua në St. Malo në Dhjetor 1998, kur Mbretëria e Bashkuar dhe Franca ranë dakord për ta vendosur BE-në në krye të çështjeve të sigurisë dhe për t'i dhënë fund periudhës jetëshkurtër të BEP. Në vazhdim, samiti i Këshillit

Evropian i Këlnit në Qershor 1999 shënoi fillimin e një Politike Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM). Që atëherë, Bashkimi Evropian ka krijuar Komitetin e tij Politik dhe të Sigurisë (KPS), Komitetin Ushtarak, dhe Sekretariatit Ushtarak. BE ka krijuar gjithashtu grupet e luftimit dhe vendosi një qëllim kryesor – fillimisht për 2003 dhe pastaj për 2010 – në mënyrë që të jetë sa më e aftë në operacionet paqeruajtëse. Në vitin 2003 u pranua një Strategji Evropiane e Sigurisë që përcaktoi kërcënimet dhe objektivat strategjike dhe që u rishikua në fund të 2008. Shkurtimisht, përgjatë 10 viteve të fundit BE-ja ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme PESM-in.

Një historik i shkurtër mbi marrëdhëniet NATO-BE

Në fillimin e kësaj epoke të re, BE-ja, duke synuar rritjen e vizibilitetit dhe aftësive të saj, zhvilloi një kuadër bashkëpunimi me NATO-n. Negociatat mbi këtë kuadër zgjatën pothuajse tre vjet dhe u finalizuan në Dhjetor 2002. Ato përfshinin elementët e mëposhtëm:

- Rregullimet e Berlin+ për përdorimin e aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s nga BE.

- Marrëveshjet për një Partneritet Strategjik NATO-BE (Deklarata BE-NATO mbi PESM dhe shkëmbimin e letrave ndërmjet Sekretarëve të Përgjithshëm).

- Marrëveshjet në lidhje me përfshirjen e aleatëve Evropianë jo-anëtarë të BE-së në PESM (Dokumenti i Zbatimit të Nicë-s).

Ky kuadër u bazua mbi këndvështrimin e përbashkët të përcaktuar nga Sekretarja e Shtetit të SHBA-së Madeleine Albright në 1999 si “3D-të”. Pra, synimi nuk ishte të “Dyfishohen” asetet e NATO-s, të mos “Diskriminohen” vendet jo-anëtare të BE-së dhe NATO-s, dhe të mos “Ndahet” BE-ja nga arkitektura e sigurisë transatlantike. Si e tillë, supremacia e NATO-s ishte e garantuar, ndonëse Evropianët u lejuan të merrnin më shumë përgjegjësi. Kjo ishte e rëndësishme derisa kriza e Bosnjes e viteve 1990 kishte treguar vështirësitë në dhënien e një përgjigje Evropiane të përbashkët dhe të institucionalizuar. Gjithashtu, SHBA nuk dëshironte të qëndronte si aktori kryesor në skenën e sigurisë Evropiane pas rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Paktit të Varshavës. Prandaj, ishte koha që Aleatët Evropianë të riorganizonin vetveten.

Viti 2003 ka qenë një vit kritik përse i përket marrëdhënieve NATO-BE. Bazuar në kuadrin e miratuar, BE-ja mori përsipër përgjegjësitë e Operacionit të drejtuar deri atëherë nga NATO,

“Aleati i Harmonisë” në Maqedoni në Mars 2003, fillimisht nëpërmjet operacionit Berlin+ me asetet e NATO-s të vëna në dispozicion të BE-së. *Grupi i Kapaciteteve* NATO-BE u formua në Maj 2003 për të siguruar koherencën dhe përfundimin reciprok të përpjekjeve të zhvillimit të aftësive të NATO-s dhe BE-së. Ndërkohë, stërvitja e parë e bashkuar për menaxhimin e krizave të NATO-s dhe BE-së u mbajt në Dhjetor të të njëjtit vit. Si i tillë, edhe pse duheshin pothuajse tre vjet për ta përfunduar, bashkëpunimi NATO-BE nisi me një fillim të shpejtë në 2003, duke rritur pritshmëritë.

Re mbi bashkëpunimin NATO-BE

Mosmarrëveshjet midis NATO-s dhe BE-së filluan të shfaqeshin shpejt. Arsyeja më e cituar për këtë është anëtarësimi i Qipros në BE pas Majit 2004 dhe problemet që shkaktoi kjo me njërin prej aleatëve të NATO-s, Turqinë. Nuk është sekret që Turqia nuk dëshiron që Qipro, (një shtet të cilin ajo nuk e njeh), të marrë pjesë në takimet zyrtare NATO-BE. Çdo shtet që merr pjesë në takimet zyrtare NATO-BE ka nevojë që të ketë marrëveshje sigurie. Qipro nuk është një anëtare e NATO-s dhe e programit të Partneritetit për Paqe (PpP) të NATO-s pasi nuk ka një marrëveshje sigurie me NATO-n. Kjo është një rrjedhojë e vendimeve të marra nga NATO dhe BE-ja në Dhjetor të vitit 2002, kur ata ranë dakord mbi parimet e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Ky vendim është marrë përpara zgjerimit të BE-së të vitit 2004 kur Qipro u anëtarësua në Bashkimin Evropian. Me fjalë të tjera, marrëveshja ishte ndërmarrë qëllimisht me qëllim që dihej se anëtarësimi i Qipros në BE, duke parë marrëdhënien e tensionuar me Turqinë, do të parashtronte vështirësi për bashkëpunimin NATO-BE. Kështu, Turqia negocioi detajet e një mekanizmi konsultativ NATO-BE duke pasur parasysh që aleatët e mbetur të saj si dhe anëtarët e BE-së, duke përfshirë Greqinë, e pranuan këtë qasje.

Qipro tani bllokoi rregullimet administrative që duhen implementuar ndërmjet Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (AEM) dhe Turqisë. Ajo mund ta bëjë këtë pavarësisht faktit që AEM është një produkt i ish-IEPG (Independent European Programme Group) dhe WEAG (Western European Armament Group) të NATO-s, ku Turqia ishte një anëtare me të drejta të plota. Qipro gjithashtu pengon çdo lëvizje drejt Turqisë duke nënshkruar një marrëveshje sigurie me BE-në.

Thënë kjo, bashkëpunimi i kufizuar midis NATO-s dhe BE-së nuk mund t'i atribuohet ekskluzivisht problemit të Qipros dhe

çështjeve teknike komplekse që ajo përfshin. Tre janë arsytet më të rëndësishme përse bashkëpunimi NATO-BE ka hasur në vështirësi që nga viti 2004.

Një arsye ndoshta më pak e përmendur ishte pakënaqësia e Uashingtonit me lëvizjen e papritur të BE-së drejt autonomisë. Duhet marrë parasysh që BE-ja nisi misionin e saj të parë ushtarak të pavarur në Kongo, në Qershor të vitit 2003. Lëvizja erdhi pas rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe NATO nuk u konsultua para nisjes së Operacionit Artemis. Kjo është ndoshta arsyeja kryesore pse BE-ja dhe NATO, ndërmorrën operacione të ndara në Sudan më vonë në vitin 2005. Lëvizje të tilla dëshmojnë për ngurrimin nga ana e të dy institucioneve për të zgjeruar bashkëpunimin e tyre.

Megjithatë, shumë ekspertë besojnë që SHBA po përgatitet për një PESHM më të pavarur dhe e shikojnë fjalimin e Ambasadores së SHBA-së në NATO Victoria Nuland në Paris 2008 si shprehje të një pëqasjeje të re të SHBA-së. Ajo deklaroi se: "Evropa ka nevojë, Shtetet e Bashkuara kanë nevojë, NATO ka nevojë, bota demokratike ka nevojë për një kapacitet Evropian më të fortë dhe më të aftë".

Qasja e re e SHBA-së nuk do të thotë domosdoshmërisht një ndryshim nga 3D-të. Ajo tregon më së miri masën në të cilën SHBA ka nevojë për partnerë më të aftë për t'u përballur me sfidat e së ardhmes. Qartësisht BE-ja është lloji i partnerit me të cilin SHBA-ja do të preferonte të punonte. Tanimë SHBA duket të jetë në mbështetje të aftësive më të mira të planifikimit civilo-ushtarak të BE-së. Kjo nuk duhet të përmbushet duke dyfishuar aftësitë ekzistuese të NATO-s, por ajo duhet të jetë plotësuese me kapacitete të tilla. Por në fund të ditës, fati i një planifikimi të përhershëm të BE-së dhe të zyrave qendrore të përgjithshme operative varet më tepër nga qëndrimet Britanike sesa ato Amerikane.

Në të njëjtën mënyrë, pyetja nëse BE duhet të veprojë si një grup brenda NATO-s apo si një konglomerat shtetesh sovranë ka një përgjigje të thjeshtë. Shndërrimi i NATO-s në një forum këshillimor politiko-ushtarak midis SHBA-së dhe BE-së nuk do të dobësonte vetëm historinë dhe aftësitë e saj, por gjithashtu do të tjetërsonte vendet e tjera që nuk janë anëtare të BE-së. Kjo do të thotë që ndryshimet në opinione dhe perceptime midis SHBA-së dhe BE-së mund të çonin në një ndarje të NATO-s dhe BE-së. Në të njëjtën mënyrë, BE-ja duhet të jetë më e hapur për bashkëpunim me Aleatët jo-anëtarë të BE-së, në kontrast me qasjen e sotme kufizuese. Mos-diskriminimi do të jetë çelësi për një bashkëpunim të qëndrueshëm NATO-BE. Në fakt duket se

SHBA është e dhënë pas punës me vendet jo-anëtare të BE-së si Turqia, për t'u përballur me sfidat e së ardhmes.

Arsyeja e tretë për vështirësitë e marrëdhënieve NATO-BE ndodhet brenda vetë BE-së. Debati i brendshëm për të ardhmen e PESM nuk ka përfunduar derisa çështja nëse BE duhet të ketë një planifikim të përhershëm dhe zyra qendrore operacionale mbetet e hapur. Kjo është një çështje kyçe, veçanërisht për operacionet ku nevojiten më tepër burime ushtarake. Traktati i Lisbonës ka hyrë në fuqi më në fund dhe paraqet një mundësi të re për ata që kërkojnë të krijojnë zyra të tilla qendrore përmes një Bashkëpunimi të Strukturuar të Përhershëm (BSP).

BSP do t'i lejojë këto vullnete të avancojnë më shpejt për t'a bërë këtë në një mënyrë të institucionalizuar, sesa pasjen nevojë të formimit të një koalicioni të bazuar mbi vullnetet rast pas rasti. Kështu, brenda kuadrit të BSP, gjashtë vendet më të mëdha anëtare të BE-së (Franca, Gjermania, MB, Italia, Spanja dhe Polonia) mund të formojnë në mënyrë hipotetike një lloj blloku mbrojtës siç u favorizua nga Presidenti Francez Sarkozy, ku secili shtet të siguronte 10,000 trupa për një forcë të fuqishme prej 60.000 trupash të reagimit të shpejtë të BE-së; ata mund të formojnë gjithashtu një treg të prokurimit të pajisjeve mbrojtëse. Nëse realizohet, një skenar i tillë do të kishte një ndikim vendimtar në marrëdhëniet NATO-BE.

Vështirësitë e mëtejshme janë të lidhura me ndryshimet në kulturat burokratike të të dy institucioneve. Për shkak të historisë dhe aftësive të tyre, NATO dhe BE kanë instikte të ndryshme institucionale. Kjo në fakt mund të përmendet si një arsye përse të dy organizatat nuk kanë qenë në gjendje të mbyllin hendekun midis Planit të Veprimit të Kapaciteteve Evropiane (PVKE) të BE-së dhe Angazhimit për Kapacitetet e Pragës të NATO-s, megjithëse 21 prej vendeve janë anëtare të të dyjave, BE-së dhe NATO-s. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, ka patur vetëm një operacion të drejtuar nga BE, i cili përdori ekspertizën e planifikimit të NATO-s dhe asetet dhe aftësitë e Aleancës që nga 2004, të quajtur Operacioni Althea në Bosnje dhe Hercegovinë i cili filloi në Dhjetor 2004 pas përfundimit të Forcës për Stabilizim të NATO-s në Bosnje (SFOR). Kjo u bë e mundur sepse situata në terren i detyroi palët të bashkëpunonin. Thjesht nuk kishte më alternativa të tjera.

Ky nuk ka qenë rasti i shembujve të tjerë ku bashkëpunimi nuk perceptohej si i domosdoshëm. Prandaj, sot të dy organizatat nuk bashkëpunojnë plotësisht, megjithëse ato punojnë krah për krah në të njëjtën skenë operacioni si në Kosovë (KFOR dhe

EULEX), Afganistan (ISAF dhe EUPOL) dhe Gjiri i Aden-it larg Somalisë (Mburoja Oqeanike dhe ATALANTA).

Që nga viti 2003, BE-ja ka drejtuar më shumë se 20 operacione ushtarake dhe civile. Midis tyre vetëm dy ishin si lloji i operacioneve të Berlin+ të cilat shfytëzuan asetet dhe kapacitetet e NATO-s. Ka të paktën dy shpjegime për numrin e ulët të operacioneve si Berlin+. Së pari, operacionet e BE-së ishin të vogla në madhësi dhe prandaj të gjitha burimet mund të siguroheshin dhe menaxhoheshin nga BE-ja. Gjithsesi, në shumicën e këtyre rasteve elementi i tyre ushtarak u kufizua. Së dyti, duke parë vështirësitë e shoqëruara në marrëdhëniet NATO-BE, BE-ja ka kërkuar të bëhet autonome sa më shpejt të jetë e mundur.

Turqia dhe PESM

Autoritetet turke përsërisin vazhdimisht se: Turqia nuk është kundër një përforsimi të bashkëpunimit NATO-BE. Përkundrazi, Turqia mbështet parimisht zhvillimin e PESM-së. PESM (ose PSMP sipas akronimit të ri pas Traktatit të Lisbonës) është pa dyshim e rëndësishme për Turqinë. I tillë është edhe zhvillimi i PJSP (Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët). Në fakt, Turqia i për afrohet me rreth 80% të deklaratave dhe qëndrimeve të PJSP. Mund të argumentohet lehtësisht që Turqia ndan me aktorët e përfshirë në PJSP të njëjtat perceptime rreziku, prioritetesh dhe mjetesh për të adresuar sfidat. Për shembull, gjatë përgatitjeve për Dokumentin e parë të Strategjisë Evropiane të Sigurisë në 2003 Turqia u këshillua zyrtarisht dhe vlerësoi faktin që shqetësimet e saj u morrën në konsideratë. Turqia është e dhënë gjithashtu pas multilateralizmit në politikën e saj të jashtme. Si një anëtare e Aleancës Perëndimore për më shumë se 50 vjet, pozicionimi i Turqisë me BE-në është një rrjedhojë normale e këtij mjedisi. Me kë do të bashkëpunojë në mënyrë të sigurtë Turqia, nëse jo me BE-në? Prandaj është e gabuar të perceptohet kërkesa e Turqisë për të marrë një rol aktiv në PESM si një propozim për një hyrje në derën e pasme të BE. Në fakt, Turqia është fqinje me rajone të paqëndrueshme si Lindja e Mesme dhe Kaukazi. Prandaj, çështjet e sigurisë dhe angazhimet ndërkombëtare janë të rëndësishme për Turqinë si dhe anëtarësimi në Aleancën e Atlantikut është i rrënjësor thellë në bërjen e politikës së saj të jashtme. Megjithatë, statusi i Turqisë në Arkitekturën Evropiane të Sigurisë është konsumuar në mënyrë konstante, të paktën institucionalisht, që nga fundi i

Luftës së Ftohtë. Për arsye të kuptueshme, SHBA-ja po kërkon për një ndarje më të madhe të përgjegjësive me Aleatët e saj Evropianë dhe për pasojë roli i NATO-s në çështjet tërësisht Evropiane është në rënie. Për shembull, një çështje që e ilustron këtë është një operacion që vazhdon në Bosnje. Nuk është më një operacion i NATO-s, por udhëhiqet nga BE-ja. Në anën tjetër, Turqia, nuk është ende një shtet anëtar i BE-së. Nuk është e mundur pjesëmarrja e saj në takimet këshillimore të zakonshme të BE-së. Takimet e BE-së nuk janë të hapura për vendet e treta, madje as për aleatët jo-anëtarë të BE-së, as si vëzhgues. Autoritetet Turke deklarojnë se ato as nuk u konsultuan përpara operacioneve të BE-së në Irak dhe në Gjeorgji, të dyja fqinje të drejtpërdrejta të Turqisë. BE-ja përgjigjet se përgjegjësia e saj për të konsultuar Turqinë nëpërmjet marrëveshjeve këshillimore NATO-BE përfshin vetëm operacionet ushtarake ndërsa aktivitetet e ndërmarra në Irak dhe Gjeorgji klasifikohen si operacione civile.

Shkurtimisht, BE-ja nuk e ndjen nevojën të këshillohet me një vend kandidat mbi atë çka po ndodh drejtpërdrejtë me fqinjët e tij. Ky problem mund të mos lidhet me çështjen e Qipros, por faktori Qipro, hyn në lojë në marrëveshjet e Turqisë me Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes, e cila mbetet e varur për shkak të vetos Qipriote. E njëjta gjë vlen për nënshkrimin e një marrëveshje të sigurisë me BE-në mbi shkëmbimin e informacionit të klasifikuar. Për arsye të paqarta, Turqia nuk u këshillua zyrtarisht për zbatimin e raportit të Dokumentit të Strategjisë së BE-së mbi Sigurinë të vitit 2008. Të paktën kjo është tabloja e parë nga këndvështrimi Turk. Gjithçka që BE-ja i ofron Turqisë në lidhje me çështjet e sigurisë është të kontribuojë me trupa – nëse pranohen nga BE-ja, që mund të mos jetë gjithmonë rasti – për operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse, në të cilat kuadri i përgjithshëm politik është përcaktuar tashmë nga BE. Në terma praktikë, gjendja e tanishme ka të bëjë me rastet ku shqetësimeve të Turqisë nuk mund t'i jepet zë nëse nuk është NATO por BE-ja ajo që po merr drejtimin e një situatë të caktuar. Kjo është qartësisht një situatë frustruese për autoritetet Turke.

Ndonëse anëtarësimi i Qipros në BE i ndërlikoi marrëdhëniet e Turqisë me PESH, problemet rreth kontributeve të Turqisë duket se shkojnë më tej. BE-ja nuk është ende gati të jetë më përfshirëse dhe transparente mbi çështjet e PESH-it. Ngurtësia institucionale siguron vetëm një justifikim të mirë. Çështja e vërtetë është mungesa e vullnetit politik për të përfshirë Aleatët jo-anëtarë të BE-së. Prandaj, nuk është e sigurtë që të gjitha çështjet NATO-BE dhe çështjet Turqi-PESH do të zgjidhen

menjëherë nëse apo kur të zgjidhet problemi i Qipros. Pra, është e gabuar që të gjitha vështirësitë që lidhen me bashkëpunimin NATO-BE ti atribuohen Turqisë dhe, për më tepër, të fajësohet çështja e Qipros për të gjitha problemet që shoqërohen me marrëdhëniet Turqi-PESM.

Turqia thjesht po i kërkon BE-së të jetë më e hapur dhe transparente ndaj Aleatëve jo-anëtarë të BE-së. Çfarë është e aplikueshme në praktikë nuk është domosdoshmërisht korrekte politikisht. Turqia mund të lihet praktikisht në skajet e arkitekturës Evropiane të Sigurisë nga ana e BE-së, duke përdorur kuadrin e ngurtë institucional ekzistues të BE-së. Megjithatë, Siguria Evropiane, është e pandashme. Turqia ndjen se ajo po lihet gjithnjë e më tepër mënjanë. Lënia e Turqisë jashtë nuk është një zgjidhje e pranueshme politikisht për të ardhmen e sigurisë Evropiane.

Një rrugë përpara

NATO do të rishikojë Konceptin e saj Strategjik në vitin 2010. Tashmë kanë filluar konsultimet për këtë. Ky ushtrim do të jetë një mundësi për të gjitha palët për të rënë dakord për një sërë parimesh për të ardhmen e mjedisit të sigurisë Evropiane. BE-ja e rishikoi Strategjinë e saj të Sigurisë në fund të 2008 nëpërmjet raportit të implementimit. Nëse të dy institucionet mendojnë vërtet të punojnë më afër njëri-tjetrit, Koncepti Strategjik i NATO-s dhe Strategjia Evropiane e Sigurisë kanë nevojë të plotësojnë njëra-tjetrën. Të 21 anëtarët e BE-së mund t'i japin zë shqetësimeve të tyre gjatë negociatave të Konceptit Strategjik të NATO-s. Në të njëjtën mënyrë, dhe me vullnetin e duhur politik, ata do të jenë në gjendje të rishikojnë më tej Strategjinë Evropiane të Sigurisë duke marrë parasysh Konceptin e ri Strategjik të NATO-s. Prandaj, rishikimi i Konceptit Strategjik të NATO-s ofron një mundësi unike për palët, që të kapërcejnë diferencat e tyre. Në vazhdim të marrëveshjes mbi Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, BE-ja duhet të marrë hapa të përputhshme me të.

Duhet të vendosen një sërë rregullimesh praktike në mënyrë të tillë që të përfshihen të gjithë Aleatët Evropianë jo-anëtarë të BE-së. Marrëveshjet e rishikuara kanë nevojë për një konceptim të ri dhe të hapur. Për shembull, ndarja artificiale mes pjesëmarrjes në operacionet ushtarake dhe civile duhet të marrë fund. Mekanizmat e konsultimit për Aleatët jo-anëtarë të BE-së duhet të jenë efektive. Pa dyshim, vendim-marrja do t'i mbetet BE-së. Por autoriteti i saj nuk mund të dobësohet duke dëgjuar

aleatët e tjerë dhe duke u përpjekur për të adresuar shqetësimet e tyre. Kjo është e rëndësishme veçanërisht nëse aleati në fjalë është një kandidat i BE-së me një vizion për siguri të përbashkët që ka rezistuar mbi 50 vjet.

Can Buharalý është anëtar i Bordit të Qendrës për Studime Politikash Ekonomike dhe të Jashtme, (EDAM)

**Daniel Korski,
Daniel Serwer dhe Megan Chabalowski**

NJË AXHENDË E RE E BASHKËPUNIMIT SHBA-BE PËR SIGURINË

Pas-Luftës së Ftohtë, bota ka parë një zhvendosje nga tensionet dhe konfliktet ndërshtetërore në konflikte të brendshme, mosmarrëveshje etnike dhe sektare, luftëra civile, shtete të dobëta dhe të dështuara, udhëheqësit ushtarakë dhe strehimet terroriste. Ndërhyrja ushtarake për zgjidhjen e këtyre problemeve është një mjet i drejtpërdrejtë dhe i shtrenjtë, që mund të shkaktojë dëme të mëdha dhe mund të mos adresojë shkaqet themelore të konfliktit. Duke pasur një numër të madh trupash të vendosur jashtë vendit, SHBA-ja dhe qeveritë evropiane duhet të forcojnë mundësitë civile për t'i përdorur si një mjet parandalues edhe pas-konfliktit.

Deri më sot, kapacitetet e SHBA-së dhe BE-së në parandalimin e konfliktit dhe të ashtuquajturit misionet "gjithëpërfshirëse" për stabilizim dhe rindërtim janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Tek SHBA la gjurmë eksperiencë e saj nga Lufta në Irak dhe pasojat e saj, ndërsa BE-ja ka punuar që prej Luftërave Ballkanike për ndërtimin e kapaciteteve civilo-ushtarake. Megjithatë në të njëjtën kohë ka pasur një dëshirë në rritje për bashkëpunim praktik transatlantik jo vetëm brenda NATO-s, por edhe midis SHBA-së dhe BE-së.

Një bashkëpunim i tillë është domethënës. Në një sërë rajonesh të paqëndrueshme, bashkëpunimi i ngushtë SHBA-BE mund të sjellë përfitime që nuk mund t'i sjellin bashkëpunimet e ngjashme brenda NATO-s ose lidhjet dypalëshe. Vetëm pak analistë mund të skicojnë një rol më të gjerë të NATO-s në Pakistan apo edhe në Magreb. Në mënyrë të ngjashme është e vështirë për të përfytyruar bashkëpunimin SHBA-Mbretëri e Bashkuar, për shembull, në zhvillimin e një ndikimi të pavarur.

Por ndoshta BE-ja mund të luajë një rol në rajone të tilla nëpërmjet partneritetit të ngushtë, si dhe me anë të angazhimit të madh të SHBA-së. Së dyti, bashkëpunimi SHBA-BE mban premtimin e paraqitjes së gamës së plotë të burimeve qeveritare – madje edhe shoqërore – në detyrën e parandalimit të konfliktit. BE-ja nuk do të jetë një operator me synimin më të lartë ushtarak për dekada, por ajo ka avantazhe që NATO nuk mund t'i gëzojë kurrë plotësisht, të tilla si kapacitetin e ndërtimit të institucioneve civile dhe potencialin për të përzierë asetet civile dhe ushtarake.

Për këto arsye, janë rritur me kalimin e viteve lidhjet burokratike midis SHBA-së dhe BE-së. USAID-i dhe Komisioni Evropian kanë një histori bashkëpunimi në këtë fushë, nëpërmjet bisedimeve dypalëshe dhe përmes diskutimeve nën kujdesin e OECD-së (Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik). Nga ana tjetër, në Ballkan mund të gjenden shembuj të bashkëpunimit për sigurinë. Për shumë vite, SHBA-ja ndihmoi zyrtarët e doganave të Programit të Komisionit Evropian në Bosnje CAFAO dhe zyrtarët e SHBA-së sot janë pjesë e misionit të policisë dhe drejtësisë në Kosovë (EULEX), si rasti i parë i pjesëmarrjes së SHBA-së në një mision formal të Politikës Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM).

Bashkëpunimi në terren u plotësua nga një Plan Pune zyrtar SHBA-BE i nënshkruar në 2007, i cili paraqet fushat për bashkëpunim. Plani është rasti më i rëndësishëm i bashkëpunimit për sigurinë mes SHBA-së dhe BE-së jashtë kuadrit të NATO-s. Prandaj, ai shënon një ndryshim në pikëpamjen e politikë-bërësve të SHBA-së në lidhje me PESM.⁸⁵ Uashingtoni i ka kundërshtuar – dhe i ka bllokuar në mënyrë aktive, për vite me radhë – përpjekjet evropiane për të forcuar komponentët e tij ushtarakë të mbrojtjes me arsyetimin se ato dëmtonin NATO-n. Mirëpo ky qëndrim ka ndryshuar dhe siç vëren Alice Serar, “ka të ngjarë të vazhdojë përmirësimi i qëndrimeve drejt një marrëdhënieje dypalëshetë sigurisë.”⁸⁶

Megjithatë, pavarësisht përvojave pozitive të bashkëpunimit SHBA-BE në terren, në shumë nga pikat e nxehta të botës dhe

⁸⁵ Në një fjalim më 22 Shkurt 2008 në Paris, Ambasadori i atëhershëm i SHBA-së për NATO Victoria Nuland theksoi: “Tani, me 15 misione në tri kontinente, BE-ja ka treguar aftësinë e saj për të ofruar një tërësi e cila është më e madhe sesa shuma e pjesëve të saj”. Parë për herë të fundit në <http://www.america.gov/st/tetran/english/2008/February/20080222183349eafas0.5647394.html>. Shih gjithashtu Esther Brimmer, ‘Seeing Blue: American Visions of the European Union’, Chaillot Paper 105, Paris, EU Institute for Security Studies, 2007

⁸⁶ Alice Serar, ‘Tackling Today’s Complex Crises: EU-US Cooperation in Civilian Crisis Management’, Diplomacy Papers, 4/2009, fq. 3.

në vendet që rrezikojnë më shumë stabilitetin, ai mbetet në rastin më të mirë mekanik dhe episodik. Kur realizohet bashkëpunimi, aktivitetet e SHBA-së dhe BE-së janë shpesh të koordinuara më tepër sesa janë pjesë e një përpjekje të përbashkët reale. Për shembull në Kabul, programi i Departamentit të Mbrojtjes i drejtuar nga SHBA dhe misioni i policisë së BE-së (EUPOL) - të cilët janë duke krijuar së bashku Policinë Kombëtare Afgane – kanë kërkuar që të bashkëpunojnë dhe ndajnë mandatet e tyre, por të dy misionet u zhvilluan të izoluar nga njëri-tjetri dhe ende luftojnë me këtë trashëgimi të ndryshme.

Ka arsye konkrete pse nuk është zhvilluar më tej bashkëpunimi midis SHBA-së dhe BE-së. Një arsye është mentaliteti i mbetur brenda ushtrisë amerikane “NATO e para”, i cili pengon bashkëpunimin tërësor të qeverisë midis SHBA-së dhe BE-së, në krahasim me punën, civil me civil. Ky mentalitet mbetet i ngulitur, pavarësisht ndryshimit të qëndrimit të SHBA-së ndaj PESH. Për të refuzuar një skepticizëm të tillë, BE-ja do të duhet të tregojë se ajo mund të sjellë në tryezë në ato që SHBA i konsideron si çështjet prioritare të sigurisë, kryesisht stabilizimin e Pakistanit dhe misionin e NATO-s në Afganistan.

Nga ana e BE-së, ka pengesa gjithashtu. Një grup i vogël ndërmjetësuesish (por i angazhuar) në burokracinë e BE-së ende sheh ndonjë formë të bashkëpunimit midis NATO-s dhe BE-së si minuese të aspiratave të BE-së për sigurinë, dhe do të punojnë për të penguar çdo lëvizje drejt bashkëpunimit. Kjo pengon bashkëpunimin në këtë fushë, por krijon mosbesim ndërmjet politikëbërësve amerikanë. Edhe më tepër problematik është këndvështrimi i shumë shteteve të BE-së. Ndonëse shumica pajtohen me qëllimin e një Politike të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët (PJSP), disa qeveri të BE-së përkrahin një PJSP më të fortë, të tjerët jo dhe një grup i tretë preferon të vërë theksin në kapacitetin ushtarak të BE-së, më tepër se në kapacitetin civil. Ky këndvështrim i ndryshëm mbi PJSP pengon bashkëpunimin SHBA-BE.

Në përvjetorin e pesëmbëdhjetë të Axhendës së re Transatlantike që do të festohet në mes të 2010 në Madrid, në një samit mes BE-SHBA gjatë Presidencës Spanjolle të BE-së, ekzistonte një mundësi për të përcaktuar një agjendë të re për bashkëpunimin e sigurisë mes tyre.⁸⁷ Ky shkrim ndjek zhvillimin

⁸⁷Axhenda e Re Transatlantike përcakton fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit midis BE-së dhe SHBA-së. Ajo u nënshkrua në Samitin BE-SHBA në Madrid më 3 dhjetor 1995 dhe pasoi nënshkrimin e Deklaratës Transatlantike (DT) në nëntor 1990 ndërmjet Komunitetit Europian (KE) dhe SHBA-së.

e kapaciteteve të SHBA-së dhe BE-së, historinë e bashkëpunimit transatlantik, problemet e vazhdueshme dhe pengesat dhe atë sesi mund të duket një axhendë më e fortë në të ardhmen.

Kapacitetet e SHBA-së

Që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar në më shumë se 17 operacione për rindërtim dhe stabilizim (R & S).⁸⁸ Kjo ka ndodhur pavarësisht një preference të fortë amerikane në përgjithësi për të mos ndërhyrë jashtë vendit, përveçse në rastet e kërcënimeve të qarta për sigurinë kombëtare të SHBA-së, dhe periudhave të gjata në të cilat njëra apo partia tjetër politike iu shmang ndërtimit të kombit. Në dy ndërhyrjet e saj të fundit më të mëdha, në Irak dhe Afganistan, SHBA-ja kishte ndërmend t'i jepte fund operacioneve ushtarake shpejt dhe pastaj të largohej, duke lënë irakenët dhe afganët që t'ia dilnin mbanë vetë. Shtetet e Bashkuara i ka shtyrë nevoja, dhe jo preferenca, në rritjen e kapaciteteve të saj në atë që ajo vazhdon ta quajë “rindërtim dhe stabilizim (R & S)”. Megjithëse përdoret gjerësisht, ky është një emër i gabuar, pasi stabilizimi është vetëm kërkesa më imediate (dhe, sigurisht, duhet të vijë e para) në shoqëritë e “pas-konfliktit” dhe shumë rrallë ndërhyrjet ndërkombëtare bashkëkohore synojnë të rindërtojnë atë që ishte e pranishme më parë (sigurisht as në Irak as në Afganistan). Këto operacione nuk janë vërtetë “pas konfliktit”: konfliktet vazhdojnë zakonisht, megjithëse me fat dhe përpjekje ato mund të bëhen më shumë politike sesa ushtarake në shoqëritë që dalin prej dhunës në shkallë të gjerë.

Zyra e Koordinatorit për Rindërtim dhe Stabilizim (S/KRS) në Departamentin e Shtetit e krijuar në gusht 2004, synohet të bëhet mekanizmi kryesor koordinues për civilët e qeverisë së SHBA-së në operacionet e rindërtimit dhe stabilizimit. Shumica e mirëpriti S/KRS, aq më shumë ushtria amerikane, e cila shpresonte që kjo do të lehtësonte ngarkesën e tyre, e cilësuar ndonjëherë në mënyrë qesharake si “duke bërë dritaret”.

Megjithatë, stafi i tij i përkushtuar dhe me përvojë mbetet ende me 120 anëtarë, shumica prej të cilëve janë caktuar (ose kontraktuar) nga agjencitë e tjera. Financimi është kufizuar:

⁸⁸John E. Herbst, ‘Stabilization and Reconstruction Operations: Learning from the Provincial Reconstruction Team (PRT) Experience’, Statement Before House Armed Services Subcommittee on Oversight and Investigations, Washington D.C., 30 Tetor 2007.

Kongresi i dha S/KRS 45 milionë \$ në vitin fiskal (VF) 09 për S/KRS, por buxheti i tij për VF 10 është \$ 323 milionë (shumica e të cilit do të shkojë për Trupat e Reagimit Civil të diskutuar më poshtë).⁸⁹ Përveç kësaj, S/KRS mund të marrë shuma domethënëse (deri në 200 milion \$ të cilat u autorizuan për VF 09) nga Departamenti i Mbrojtjes, mbi bazën e shqyrtimit rast pas rasti të projekteve të “qeverisë në tërësi” që synojnë stabilizimin dhe rindërtimin.⁹⁰ Edhe me këtë financim, burimet në dispozicion janë qartazi të pamjaftueshme për të drejtuar, koordinuar dhe zhvilluar të gjithë kapacitetet civile të qeverisë së SHBA-së në gjithçka, por në raste të kufizuara, bën që disa të sugjerojnë që një sërë përgjegjësish të S/KRS të transferohen në agjenci të tjera të konsoliduara të SHBA-së.⁹¹ S/KRS ka për të bërë një rrugë të gjatë, përpara se të mund të mbajë shumicën e detyrimeve që aktualisht janë marrë përsipër nga ushtria. Megjithatë, S/KRS strehon përpjekjen më të madhe amerikane të deri tanishme për të operacionalizuar kapacitetin civil të SHBA-së për t’iu përgjigjur situatave të konfliktit.

Trupat e Reagimit Civil (TRC) synojnë t’i ofrojnë SHBA-së operacione të rindërtimit dhe stabilizimit me një kuadër profesionistësh të trajnuar dhe ekspertë të gatshëm për t’u pozicionuar në fillimin e një krize ndërkombëtare. Ky është një partneritet i tetë agjencive qeveritare dhe departamenteve të ndryshme të SHBA-së: Departamentit të Shtetit, Agjencisë për Zhvillimin Ndërkombëtar të SHBA (USAID), Departamentit të Bujqësisë, Departamentit të Tregtisë, Departamentit të Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore, Departamentit të Sigurisë Kombëtare, Departamentit të Drejtësisë, dhe Departamentit të Thesarit. TRC përmban tre komponentë: ushtarët aktivë, trupat e gatshëm, dhe ushtarët rezervë. Komponenti aktiv (TRC-A) do të përbëhet nga 250 persona të punësuar me kohë të plotë, që mund të shpërndahen brenda 48 orëve, për të vënë në zbatim të gjitha aspektet e një misioni ndërveprues për rindërtimin dhe stabilizimin, të tilla si vlerësimet, planifikimi, ngritjen e bazës dhe koordinimin në terren. Komponenti i trupave të gatshëm (TRC-G) do të përbëhet nga

⁸⁹ Departamenti i Shtetit të SHBA, *The Budget in Brief: Fiscal Year 2010*.

⁹⁰ Robert M. Perito, ‘Integrated Security Assistance: The 1207 Program’, Special Report Nr. 207, Washington DC: US Institute of Peace, Korrik 2008.

⁹¹ Frederick Barton and Noam Unger, ‘DRAFT Civil-Military Relations, Fostering Development, and Expanding Civilian Capacity: A Workshop Report’, Center for Strategic and International Studies.

2000 anëtarë, të cilët janë të punësuar me kohë të plotë në agjencitë qeveritare të SHBA-së dhe të specializuar në një aspekt të veçantë të rindërtimit dhe stabilizimit. Ata mund të shpërndahen brenda 30 ditëve. Komponenti i Rezervave (TRC-R) - ende nuk është financuar - do të përbëhet nga 2000 punonjës jo-qeveritarë amerikanë të cilët mund të plotësojnë në numër dhe në ekspertizë TRC-A dhe TRC-G. Ata do të jenë të gatshëm për t'u shpërndarë (si punonjësit e qeverisë së SHBA-së) brenda 45-60 ditësh.⁹²

TRC do të ketë kapacitete të kufizuara, edhe pse ka financim të plotë. Është projektuar që TRC-a të punojë në terren deri në gjashtë muaj. Nga përvoja e mëparshme është e qartë se ekspertiza e saj - në përafrimin e planifikimit, problemeve dhe detyrave nga një perspektivë ndër-institucionale - do të nevojitet më gjatë në shumë raste të tjera. Ka pasur dyshime edhe në lidhje me madhësinë e TRC. *Hans Binnendijk* dhe *Cronin Patrick* të Universitetit për Mbrojtjen Kombëtare, në raportin e tyre për kapacitetet civile të SHBA-së në operacionet komplekse, sygjerojnë se TRC duhet të ketë në dispozicion të saj të paktën 5000 civilë të qeverisë dhe 10.000 rezerva civile të gatshëm për t'u shpërndarë.⁹³ Një shqetësim i tretë, veçanërisht lidhur me temën e këtij shkrimi, është se TRC është i organizuar rreth një misioni të njëanshëm. Nuk ka një plan për mënyrën e veprimit multilateral në rastet e paparashikuara. Ky është një hendek i madh; i cili në qoftë se nuk riparohet mund të kufizojë efektivitetin e bashkëpunimit me BE-në, OKB-në dhe operacionet e tjera. Klima politike aktuale në SHBA nuk sugjeron që SHBA-ja do të jetë e përgatitur për të drejtuar operacionet unilaterale të rindërtimit dhe stabilizimit, me përjashtim të rrethanave më kritike.

Ushtria e SHBA-së vazhdon të mbajë shumicën e detyrimeve, gjë që nuk është e papritur. Operacionet aktuale të SHBA-së në Afganistan dhe sidomos Irak shtrihen kryesisht jashtë fushës së veprimit të S/KRS. Përveç forcimit më të madh por thelbësor të operacioneve diplomatike konvencionale, SHBA-ja ka shpërndarë si në Irak dhe Afganistan, të dy Ekipet e Rindërtimit Krahinor (ERK) civil/ushtarak dhe ekipet e këshillimit ministror, si dhe një numër të konsiderueshëm trajnuesish të policisë dhe

⁹² Zyra e Koordinatorit për Rindërtim dhe Stabilizim, 'Hyrje në Trupat e Përgjigjes Civile'. Parë në 1 Qershor 2009. <http://www.crs.state.gov/index.cfm?fuseaction=public.display&shortcut=4QRB>.

⁹³ Hans Binnendijk and Patrick M. Cronin, 'Civilian Surge: Key to Complex Operations, A Preliminary Report', Washington, DC: The National Defense University, Dhjetor 2008.

monitoruesish të kontraktuar (1200). Më shumë se gjysma e punonjësve të qeverisë amerikane në Irak dhe Afganistan - amerikanë dhe ndërkombëtarë - janë kontraktorë, shumica punojnë me forcat civile e ushtarake për të mbushur hendekun civil të qeverisë së SHBA-së. Ndërsa kontraktorët janë kritikuar shpesh, ndonjëherë me të drejtë, ata ofrojnë disa avantazhe, të tilla si rritjen e kapaciteteve, ekspertizën e veçantë dhe pranueshmëri politike.⁹⁴ Pjesa më e madhe e kësaj përpjekje për ndërtimin e shtetit është *de facto* në duart e ushtrisë amerikane, e cila ofron siguri për ERK por siguron edhe pjesën më të madhe të personelit të ERK, po ashtu dhe shumicën e këshilltarëve ministrorë. Përveç kësaj, Ekipi i parë i Terrenit Njerëzor i Departamenti të Mbrojtjes u shpërnda në 2007 duke caktuar bashkë antropologët civilë dhe shkencëtarët e tjerë socialë me trupat luftarake për të përmirësuar të kuptuarit ushtarak të mjedisit socio-kulturor lokal. Deri në mars 2009, ka pasur 20 Ekipa të Terrenit Njerëzor në Irak dhe gjashtë në Afganistan.⁹⁵ Departamenti i Mbrojtjes ka një fuqi të sajën të konsiderueshme civile rezervë. Kjo është përdorur deri kohët e fundit për të plotësuar pozicionet e ushtarëve kur ata janë vendosur jashtë vendit, por Departamenti i Mbrojtjes ka planifikuar tani t'i dërgojë këta vullnetarë civilë për të shërbyer në Afganistan, ku ata do të plotësojnë mungesat si në Departamentin e Mbrojtjes edhe në Departamentin e Shtetit.

Direktiva e Departamentit të Mbrojtjes **3000.05** i shpalli, në vitin 2005, operacionet për stabilizimin, si një mision ushtarak kryesor (dhe të barabartë) të SHBA-së, krahas operacioneve luftarake mbrojtëse dhe sulmuese.⁹⁶ Ushtria e SHBA-së ka nxjerrë një doktrinë të re për operacionet e stabilitetit⁹⁷, dhe Trupat Detare po punojnë për gjetjen e një homologu (do të ketë edhe një dokument doktrinë i përbashkët). Ushtria e SHBA-së e njeh rolin e civilëve dhe i jep atyre përparësi në funksionet e rindërtimit dhe stabilizimit, por Direktiva e Departamentit të Mbrojtjes

⁹⁴ Robert Perito, 'The Private Sector in Security Sector Reform: Essential But Not Yet Optimized', *USI Peace Briefing*, Washington, D.C.: US Institute of Peace, Janar 2009.

⁹⁵ Karen DeYoung, 'US Moves to Replace Contractors in Iraq', *The Washington Post*, 17 Mars 2009; Vanessa M. Gezari, 'Rough Terrain', *The Washington Post*, 30 Gusht 2009.

⁹⁶ Departamenti i Mbrojtjes së SHBA, 'Directive Number 3000.05: Military Support for Stability, Security, Transition, and Reconstruction (SSTR) Operations', 28 Nëntor 2005.

⁹⁷ US Army, *The US Army Stability Operations Field Manual: US Army Field Manual No. 3-07* (Ann Arbor: The University of Michigan Press, 2009).

thekson gjithashtu se ushtria duhet të jetë gati për të mbushur hendekun nëse mungojnë përpjekjet civile. Ndonëse kapaciteti civil është duke u përmirësuar, kapaciteti ushtarak është ende shumë i nevojshëm.

Kapacitetet e BE-së

Bashkimi Evropian nuk ka kapacitetet ushtarake të SHBA-së. Ai mbështetet në forcat e siguruara nga shtetet anëtare mbi një bazë rast pas rasti. Ekzistojnë planet për një Forcë të Ragimit të Shpejtë që do të jetë e aftë të shpërndajë 60.000 trupa për një periudhë prej 60 ditësh deri në një vit⁹⁸, por nuk është bërë ende asnjë marrëveshje për ta bërë realitet këtë Forcë. Disa krerë Evropianë - veçanërisht Presidenti francez Sarkozy – kanë shprehur interesin në nxitjen e krijimit të Forcës së Reagimit të Shpejtë dhe në zhvillimin e përgjithshëm të kapaciteteve ushtarake evropiane, por shumica duket se janë dakord se pika e fortë e Evropës ka qenë prej kohësh komponenti civil.

Ndërsa qeveria e SHBA-së është duke ndërtuar ende kapacitetin civil për rindërtimin dhe stabilizimin, BE-ja ka krijuar tashmë kapacitete të konsiderueshme. Procesi i zgjerimit të BE-së dhe Politika e Fqinjësisë Evropiane (PFE), mund të jenë një forcë shtytëse që qëndron pas reformave që çojnë në paqe dhe stabilitet, brenda kontinentit Evropian.⁹⁹ PESM – pjesë e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian – drejton planifikimin strategjik dhe operacionet e misioneve të BE-së për menaxhimin e krizave ndërkombëtare, për konfliktet jashtë zonës evropiane. BE, pas nisjes së misionit të tij të parë në 2003, ka realizuar 22 operacione për menaxhimin e krizave, 12 prej të cilëve janë ende në vazhdim, duke përmendur atë të majit 2009.¹⁰⁰ Këshilli Evropian përcaktoi në vitin 2000, katër fushat kryesore të veprimit civil në menaxhimin e krizave: policinë, forcimin e shtetit të së drejtës; forcimin e administratës civile

⁹⁸ Deutsche Welle, 'EU United on Rapid Reaction Force, Divided on DR Congo', DW-World.de, 13 Dhjetor 2008.

⁹⁹ European Council, 'Report on the Implementation of the European Security Strategy: Providing Security in a Changing World', Brussels, 11 Dhjetor 2008.

¹⁰⁰ Council of the European Union, 'European Security and Defence Policy (ESDP)'. Parë më 30 Maj 2009, <http://www.consilium.europa.eu/showPage.aspx?id=268&lang=en>.

dhe mbrojtjen civile.¹⁰¹ BE-ja është duke zhvilluar dhe diversifikuar operacionet e saj në këto fusha, duke forcuar veprimet e policisë së saj, duke zgjeruar hapësirën e sundimit të ligjit dhe duke monitoruar marrëveshjet e paqes dhe të kufijve.¹⁰²

Evropianët janë të fuqishëm veçanërisht në kapacitetet e policimit, duke dërguar në pesë vitet e fundit, gjashtë misione të policisë në zonat e krizës. Misionet e Policisë të BE-së kanë një staf nga Forca e Policisë së BE-së, e cila është një forcë rezervë e përbërë nga 5.000 oficerë të policisë civile, duke përfshirë 1400-anëtarë të Forcës së Reagimit të Shpejtë që mund të nisen deri në 30 ditë pas njoftimit. Ndryshe nga SHBA-ja, e cila nuk ka një forcë policore kombëtare dhe për këtë arsye mbështetet tek kontraktorët, Forca e Policisë së BE-së i merr policët e vet nga një shumëllojshmëri forcash policore Evropiane, duke përfshirë Forcën e *Xhandarmërisë* Evropiane dhe *Karabinierierët* Italianë. Është menduar që ajo të mbulojë një sërë operacionesh të parandalimit të konfliktit dhe menaxhimit të krizave - duke përfshirë garantimin e sigurisë, këshillimit dhe drejtimit - në misionet ndërkombëtare. Misionet që janë në vazhdim përfshijnë EUPM në Bosnje-Hercegovinë, COPPS EUPOL në territoret palestineze, EUPOL Afganistan, dhe EUPOL RD Kongo.¹⁰³

Ndonëse misionet e policisë të udhëhequra nga BE-ja kanë trajnimin dhe ekspertizën e nevojshme për këtë punë, ata nuk kanë gjithmonë sasinë të shprehur në numra. Por po ndodhin zhvillime për ta ndryshuar këtë gjë. BE ka një forcë policie në partneritet me Francën, Italinë, Hollandën, Portugalinë, Spanjën, Rumaninë, Poloninë dhe, më së fundi, Turqinë, Forcën e *Xhandarmërisë* Evropiane (FXhE), që di sesi të veprojë në një mjedis shumëkombësh. FXhE mund të vendosë deri në 800 policë brenda 30 ditëve, dhe të arrijë së bashku me përforcimet deri në 2300. Ajo mund të garantojë siguri të shpejtë civile në situata krize, qoftë vetëm ose nën komandën ushtarake; mund të ofrojë trajnim të kualifikuar, dhe është e aftë dhe e gatshme të veprojë në rrethanat më të vështira: e dobishme veçanërisht

¹⁰¹ European Security and Defence Policy, 'European security and defence policy: the civilian aspects of crisis management', civ/02, Qershor 2008.

¹⁰² European Security and Defence Policy, 'European security and defence policy: the civilian aspects of crisis management', Qershor 2008, civ/02.

¹⁰³ European Commission, 'New peacekeeping force staffed by police officers from across EU', Parë më 1 Qershor 2009. http://ec.europa.eu/justice_home/fsj/police/peacekeeping/fsj_police_peacekeeping_en.htm.

kur BE-ja ka vështirësi në rekrutimin e policive për mjediset e rrezikshme.¹⁰⁴

BE-ja ka një përvojë të rëndësishme që i mungon plotësisht SHBA-së: drejtimi i Ministrive të Brendshme. Ndërsa amerikanët e guximshëm dhe të përkushtuar janë duke drejtuar Ministrinë e Brendshme në Irak dhe Afganistan, asnjë prej tyre nuk ka pasur një karrierë në një Ministri të Brendshme, meqë SHBA-ja nuk i përdor ato në çdo nivel të qeverisë (Departamenti i Punëve të Brendshme i Qeverisë Federale është përgjegjës kryesisht për administrimin e tokave Federale, ruajtjen dhe amerikanët vendas; por nuk siguron drejtimin strategjik të policisë, me përjashtim të Policisë Publike të SHBA-së). Në të kundërt, BE-ja i ka përgatitur, që nga themelimi i saj, 21 Ministrinë e Brendshme për të përmbushur standardet e BE-së. Gjermania ka 17 Ministri të Brendshme (një Federale dhe 16 të rajoneve). Pra, në Evropë ka një rezervuar domethënës ekspertize dhe përvoje që i mungon SHBA-së.

Bashkimi Evropian mund të ofrojë gjithashtu specialistë për sundimin e ligjit me përvojë në operacionet e rindërtimit dhe stabilizimit. Vendet anëtare të BE-së caktuan 631 oficerë, në qershor të 2008 – prokurorë, gjykatës dhe oficerë burgu – në operacionet e administrimit të krizave për sundimin e ligjit. Këto misione synojnë të forcojnë sundimin e ligjit dhe të promovojnë të drejtat e njeriut përmes funksionimit të përshtatshëm të sistemeve gjyqësore dhe disiplinuese.¹⁰⁵ Misioni më i madh civil i BE-së në kuadrin e PESM është misioni që vazhdon në Kosovë, EULEX, edhe pse ajo vazhdon të mbështesë edhe misionin e saj EUJUST Lex në Irak.

Misionet monitoruese të BE-së – të njohura nga Këshilli Evropian si një fushë civile prioritare e PESM, në dhjetor 2004 – shërbejnë si mjet për parandalimin e konflikteve, menaxhimin dhe zgjidhjen, për ndalimin e konfliktit nëpërmjet pranisë fizike. Misioni në vazhdim EUBAM Rafah monitoron operacionet në pikën e kalimit kufitar në Rafah në mbështetje të “Marrëveshjes së Lëvizjes dhe Aksesit” të Izraelit dhe Autoritetit Palestinez. Misioni i Monitorimit Aceh, në 2005 mbikëqyri zbatimin e një marrëveshje

¹⁰⁴ Federiga Bindi, ‘Europe’s Problematic Contribution to Policy Training in Afghanistan’, Washington, DC: The Brookings Institution, 4 Maj 2009

http://www.brookings.edu/opinions/2009/0504_afghanistan_bindi.aspx

¹⁰⁵ European Security and Defence Policy, ‘European security and defence policy: the civilian aspects of crisis management’, civ/02, June 2008; Peter Feith, ‘The Aceh Peace Process: Nothing Less Than Success’, USIP Special Report 184, Washington, D.C.: United States Institute of Peace, Mars 2007.

pajeje ndërmjet qeverisë indoneziane dhe Lëvizjes së Lirë Aceh.¹⁰⁶ Interesi më i madh i BE-së në reformën e sektorit të sigurisë (RSS) është përfshirja më e gjerë territoriale. Ky koncept nuk është i ri, pasi BE-ja ka inkorporuar aspektet e RSS në politikat e saj të zgjerimit dhe zhvillimit. Por BE-ja paraqiti një strukturë të vetme politike për RSS në formën e tre dokumenteve kryesore, vetëm në fund të 2005 dhe 2006, duke përcaktuar një përfaqje holistike që merr parasysh të gjithë sektorin e sigurisë. Struktura mbetet një punë në progres. BE-ja është duke bërë një përpjekje për të rregulluar të metat që pengojnë planifikimin dhe projektimin dhe të zvogëlojë ndikimin e misioneve të RSS dhe të sigurojë që të gjitha misionet në terren të pasqyrojnë përfaqjen holistike të strukturës.¹⁰⁷

Ndërkohë, BE-ja ka vazhduar të sigurojë asistencë për RSS për shtetet e dobëta dhe të dështuara, duke përfshirë edhe dy misionet aktuale të PESHM: EUSEC DR Kongo, ku aktivitetet përfshijnë sigurimin e mbështetjes teknike dhe logjistike për institucionet ushtarake dhe RSS BE Guinea Bissau, ku misioni po ndihmon në zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të vendit.¹⁰⁸

Në përgjithësi, BE-ja është e vendosur të jetë një fuqi civile produktive në operacionet e rindërtimit dhe stabilizimit, por nuk e ka përmbushur ende potencialin e saj. Dobësitë përfshijnë mungesën e kapacitetit civil në shtetet anëtare të BE-së, problemet konceptuale dhe grindjet institucionale midis institucioneve të BE-së në Bruksel.¹⁰⁹ Por ekzistojnë kapacitetet: EULEX-i në Kosovë ka një staf ndërkombëtar prej afërsisht 1600 personash, shumë prej të cilëve mund të përdoren më mirë diku tjetër. Traktati i Lisbonës duhet të ndihmojë BE-në dhe politikat e jashtme të shteteve anëtare dhe, si rrjedhojë, misionet e PESHM bëhen më të qëndrueshme dhe koherente.¹¹⁰

¹⁰⁶ European Security and Defence Policy, 'European security and defence policy: the civilian aspects of crisis management', civ/02, Qershor 2008.

¹⁰⁷ Maria Derks and Sylvie More, 'The European Union and Internal Challenges for Effectively Supporting Security Sector Reform: An overview of the EU's set-up for SSR support *anno* spring 2009', Netherlands Institute for International Relations – Clingendael, Qershor 2009.

¹⁰⁸ European Security and Defence Policy, 'European security and defence policy: the civilian aspects of crisis management', civ/02, Qershor 2008; Daniel Flott, 'European Union Security Sector Reform Missions: The Case of Guinea-Bissau', *European Security Review*, No. 38, ISIS-Europe, Maj 2008.

¹⁰⁹ Daniel Korski and Richard Gowan, 'Can the EU Rebuild Failing States? A Review of Europe's Civilian Capacities', London, UK: European Council on Foreign Relations, Tetor 2009, fq. 24.

¹¹⁰ Giovanni Grevi, Damien Helly and Daniel Keohane (eds), 'European Security and Defence Policy: The First Ten Years', Paris: Institute for Security Studies, 2009.

Bashkëpunimi BE-SHBA

Është e natyrshme të fillojë një bashkëpunim më i madh në parandalimin, stabilizimin dhe rindërtimin nisur nga zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të SHBA-së dhe BE-së. Në fund të 2004, zyrtarë të lartë të SHBA-së filluan të konsideronin idenë që SHBA-ja, ndërsa zgjerohet në aleatët e të njëjtit mendim, duhet të përmirësojë kapacitetet e saj për stabilizimin dhe rindërtimin. Pushtimi i udhëhequr nga SHBA-ja në Irak ishte një lëvizje e shpejtë nga sukcesi konvencional drejt luftës së parregullt me planet dhe burimet e SHBA-së të cilësuar si jo të përshtatshme për këtë detyrë. Komisioni bi-partizan mbi Rindërtimin e Pas-Konfliktit, i cili publikoi raportin e tij në fillim të 2003, tregoi fuqishëm që SHBA-ja të “ndikojë burimet ndërkombëtare/ leverage international resources”, në gjetjen e aleatëve për të ndihmuar me numrin e rritur të detyrimeve të pas-konfliktit. Në Kongres, liderët kryesorë si Senatori Richard Lugar, filluan të nxisin administratën të punojë me aleatët.

Duke marrë parasysh këtë shtytje, diplomatët e SHBA nxitën nga 2004 deri në 2006 bisedimet me OKB-në, NATO-n dhe Sekretariatit e Këshillit dhe zyrtarët e Komisionit në Bruksel. Në tërësi, u zhvilluan katër seanca konsultimesh, në dy vite. Pothuajse një vit pasi Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-së Donald Rumsfeld e ndau Evropën në mënyrë provokative në pjesë “të Vjetra” dhe “të Reja”, një fillim domethënës për politikën e SHBA-së ishte hapja e bisedimeve zyrtare me BE-në. Për këtë arsye ato nuk ishin të pakundërshtuara brenda administratës së SHBA-së. Ashtu siç theksoi një memorandum i brendshëm i Departamentit të Shtetit: “DiM e pa S/KRS si një tejkalim i kufijve të politikës së SHBA-së për bashkëpunimin SHBA-BE dhe ka frikë se forcimi i kapaciteteve të BE-së do t’i shtohet shpenzimeve të NATO-s.”

Por, ashtu siç u shpjegoi ambasadorëve Evropianë në fund të 2006 diplomati John Herbst: “SHBA sheh ende hapësira të ndryshme në kapacitetet ndërkombëtare si dhe ato kombëtare. Duke qenë se paradigma dominuese për përdorimin e forcës në botën e pas-Luftës së Ftohtë janë bërë shtet-formimi, vendosja e paqes ose operacionet e stabilizimit [...], do të jetë e rëndësishme të mbushen këto boshllëqe. Kjo dëshirë praktike, e fokusuar në rezultatet e të vepruarit ofron një strukturë për bashkëpunimin BE-SHBA.”

Në të njëjtën kohë, diplomatët e SHBA-së donin të përfitonin nga një iniciativë të udhëhequr nga Danimarka brenda NATO-s, që u bë e njohur pas Samitit të Rigës si “përqasja gjithëpërfshirëse”,

me synimin për të fokusuar burimet e aleatëve në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet aseteve civile dhe ushtarake. Bisedimet zyrtare të SHBA-së me BE-në u zhvilluan gjatë tre presidencave të njëpasnjëshme të BE-së – ato të Britanisë, Austrisë dhe Finlandës – ku secila synonte që për arsyet e saj të çonte përpara ndërtimin e ESDP (PESM) civile. Për të tre, bashkëpunimi ndërmjet SHBA-së dhe BE-së në menaxhimin e krizave, përfaqësonte një mundësi për të çuar përpara axhendën e tyre. Për ata që ndodheshin brenda institucioneve të BE-së, bashkëpunimi i sigurisë BE-SHBA shihej si shenja e fundit që tregon se BE-ja ka arritur pjekurinë si një aktor i sigurisë. Kështu bashkëpunimi mbi menaxhimin e krizave siguroi rrugën më pak të diskutueshme për një bashkëpunim të tillë, ku shumë zyrtarë të BE-së shpresonin që kjo do të ndihmonte realisht në rrugën drejt bashkëpunimit të mëtejshëm ushtarak SHBA-BE, diçka që Pentagoni e kishte kundërshtuar për një kohë të gjatë.

Duket se ka të paktën tre faktorë shtesë që kanë vepruar së bashku si një katalizator për bashkëpunimin më të ngushtë SHBA-BE mbi “axhendën e konfliktit”: rritja e bashkëpunimit kundër terrorizmit pas 11 Shtatorit, që shtroi rrugën mbi çështjet si ndarja e të dhënave; bashkimi i interesave institucionalë të një numri organizatash të sapo krijuara në administratën e SHBA-së, qeveritë Evropiane po ashtu edhe në Sekretariatën e Këshillit; dhe veçanërisht që prej pushtimit të udhëhequr nga SHBA-ja në Irak, nevoja që politikë-bërësit në të dyja anët e Atlantikut t'i tregojnë aktorëve të brendshëm që bashkëpunimi transatlantik nuk është bërë plotësisht i pamundur si rezultat i këndvështrimeve të tyre mbi Luftën e Irakut.

Këto arsye prozaike për një bashkëpunim më të madh SHBA-BE u zëvendësuan nga një gjuhë më tepër poetike në tekstin e deklaratës SHBA-BE, e cila do të diskutohej në samitin SHBA-BE të 2005, por përfundimisht dështoi të arrihej si marrëveshje: “Ky bashkëpunim ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian – që fillon me parandalimin e deri tek stabilizimi dhe rindëritmi – u themelua mbi vlerat e përbashkëta, pandashmërinë e sigurisë tonë dhe vendosmërinë për të trajtuar së bashku sfidat e kohës tonë.” Zyrtarët e SHBA-së dhe BE-së nuk mund të arrinin marrëveshje mbi tekstin përfundimtar, sepse pala Evropiane mendoi se administrata e SHBA-së donte të rriste kapacitetet civile të BE-së me synimin që ta mbajë jashtë bashkëpunimit ushtarak.

Por u arrit konsensusi përfundimisht në kohën e zhvillimit të samitit SHBA-BE në 2006, ku u ra dakord të avancohej bashkëpunimi mbi ‘përballjen e kërcënimeve globale, duke

përfshirë sigurinë'. Tashmë u mirë-pranua ideja e rritjes së bashkëpunimit mbi parandalimin e konfliktit dhe stabilizimin e pas-konfliktit. Në Bruksel, filluan të shumëfishohen kontaktet ndërmjet zyrtarëve të BE-së dhe SHBA-së – nga niveli i kabinetit deri në nivelin e punës si dhe në fushën përkatëse. Për shembull, zyrtarët e SHBA-së dhe të BE-së takoheshin në dy Stërvitje Shumëkombëshe të drejtuara nga SHBA-ja dhe NATO. U forcuan lidhjet institucionale ndërmjet Sekretariatit të Këshillit të BE-së dhe Koordinatorit për Stabilizimin dhe Rindërtimin. Njësia Politike në Sekretariatit e Këshillit dhe Shtabi i Planifikimit të Politikave në Departamentin e Shtetit filluan të konsultoheshin më rregullisht mbi çështjet e konfliktit, ndërsa bisedimet për shërbimin inteligjent të përbashkët të bazuar në listat vëzhguese të vendeve me rreziqe në rritje.

Në samitin SHBA-BE të 2007, deklarata finale pohoi se “menaxhimi i krizës moderne kërkon një përfaqje gjithëpërfshirëse”: nga pala evropiane kjo gjuhë u pa si një pranim implicit se SHBA-ja dhe BE-ja duhet të bashkëpunonin si në çështjet civile, ashtu edhe në ato ushtarake. Samiti hapi rrugën për një Plan Pune, ose ashtu siç njihet formalisht, një marrëveshje mbi “Dialogun Teknik BE-SHBA dhe Rritjen e Bashkëpunimit në Menaxhimin e Krizës dhe Parandalimin e Konfliktit”. Ajo mbulonte hapësira të tilla si mësimin, trajnimin dhe shkëmbimin e listave të vëzhgimit.

Megjithëse bashkëpunimi politik është zhvilluar vetëm kohët e fundit, lidhjet ishin tashmë të forta veçanërisht në Ballkan, ku BE-ja ka ndërmarrë një rol paqeruajtës të gjerë, duke marrë përgjegjësinë për misionin ushtarak të NATO-s në Bosnje-Hercegovinë dhe rolin më të madh të OKB-së në Kosovë. Në Bosnje-Hercegovinë, edhe pse reforma e policisë drejtohet nga një mision i BE-së, janë drejtuar disa programe të SHBA-së për të mbështetur përpjekjen e udhëhequr nga BE-ja. Për shembull, SHBA-ja dhe BE-ja financuan së bashku Komisionin Gjyqësor të Pavarur të Bosnjes. Në Kosovë, të dërguarit e SHBA-së dhe BE-së (së bashku me një përfaqësues rus) përbënë të ashtuquajturin ndërmjetësimin troika, që synoi të negocionte marrëveshjen në lidhje me statusin final të Kosovës. Për arritjen e pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt 2008, ekspertë të SHBA-së punuan me homologët e tyre të BE-së për të planifikuar prezencën ndërkombëtare të udhëhequr nga BE-ja në shtetin e pavarur dhe tashmë po kontribuojnë në EULEX.

Në një skaj më jugor, në Maqedoni, kanë punuar si aktor diplomatikë të dyfishtë, i dërguari i dyfishtë i BE-së, Erwin Fouéré, dhe ambasadorët e njëpasnjëshëm të SHBA-së në Maqedoni,

përmes lëshimit të notave të protestës për qeverisjen lokale dhe lëshimin e deklaratave mbi çështjet e shqetësimit të përbashkët SHBA-BE. Bashkëpunimi i ngushtë SHBA-BE në Shkup, tregohet përmes programit të USAID-it në Maqedoni, që saktësisht “mbështet hyrjen e Maqedonisë në BE përmes ‘zbatimit’ të programeve të fokusuara në rritjen ekonomike, qeverisjen e mirë, dhe arsimin.” SHBA-ja ka mbështetur për një kohë të gjatë hyrjen e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, dhe tani i lidh programet e saj të ndihmës në arritjen e këtij qëllimi.

Probleme dhe Pengesa

Pavarësisht hapave të mëdhenj SHBA-BE që nga 2006 për të nxitur bashkëpunimin më të ngushtë, një angazhimi të përbashkët për ta bërë këtë, dhe shumë eksperiencave pozitive të bazuara në këtë fushë, mbesin shumë kërcënime. Bashkëpunimi teknik ka qenë i fragmentuar ndërmjet misioneve të PESH jashtë Ballkanit – për shembull në Kabul dhe Bagdad – si dhe me homologët e tyre të SHBA. Megjithëse ekspertët e fushës i kapërcyen disa nga pengesat institucionale, bashkëpunimi *ad hoc* ka treguar se ka limitet e tij, është konsumues i kohës dhe nuk mund të adresojë disa nga problemet themelore në fushat që SHBA-ja i konsideron jetike për interesat e saj kombëtare të sigurisë.

Bashkëpunimi politik real SHBA-BE ka qenë i pamjaftueshëm në fusha ku sipas analistëve pritet të shfaqen konflikte, veçanërisht në Afrikën sub-Sahariane dhe Azi. Shembujt e fundit tregojnë mungesën e bashkëpunimit SHBA-BE në parandalimin e konfliktit. Kur shpërtheu dhuna në Kongon Lindore në mes të 2008, kishte pak tregues të një pozicioni të përbashkët SHBA-BE. Problemet në Nepal mbi integrimin (e dështuar) të luftëtarëve maoistë në ushtrinë e Nepalit nuk çuan në një analizë të bashkuar mes SHBA-BE për situatën.

Nga dhjetë vendet në Indeksin e Shteteve të Dështuara të publikuara në 2008, nga revista Politika e Jashtme, mund të thuhet se ekziston një shkallë e bashkëpunimit SHBA-BE në politikat drejt Sudanit, Irakut, Afganistanit dhe Pakistanit.¹¹¹ Por vendet që mbesin përfshijnë Zimbabve, Kongo, Çad, Bregu i Fildishtë, dhe Republikën Qendrore Afrikane – të cilat me shumë mundësi do të vuajnë nga konflikti i vazhdueshëm në të ardhmen – bashkëpunimi SHBA-BE është në një nivel fillestar dhe tregon

¹¹¹ Shih www.foreignpolicy.com/story/cms.php?story_id=4350

shenja të një bashkëpunimi jo të vërtetë si zhvillimi i analizave të përbashkëta të problemeve, ose hartimin e një sërë strategjish të përbashkëta, gjithëpërfshirëse. Njoftimi rastësor për shtyp SHBA-BE fsheh mungesën e bashkëpunimit real.

Arsyet për mungesën e bashkëpunimit mes shumë rajoneve, në krahasim me Ballkanin, e kanë fillimin në preferencat e hershme politike të SHBA-së për të punuar me ata që SHBA-ja i sheh si partnerë të besueshëm të sigurisë (jo domosdoshmërisht brenda NATO-s) dhe hezitimi i qeverive Evropiane për të përdorur institucionet e BE-së. Në një masë më të vogël, ndryshimet e doktrinave, si p.sh si të ndërmarrësh një reformë policie, kanë qenë një pengesë për bashkëpunimin efikas. Megjithatë, ka pak diferenca në objektivat përfundimtarë: BE-ja dhe SHBA-ja ndajnë angazhimin për sigurinë, sundimin e ligjit, qeverisjen e qëndrueshme dhe zhvillimin ekonomik dhe social.

Megjithëse administrata Bush sinjalizoi në vitet e saj të fundit dëshirën për t'i dhënë fund konkurrencës NATO-BE, një politikë kjo që është përqafuar edhe nga presidenti Obama dhe është ndihmuar nga riintegrimi i Francës në strukturat ushtarake të NATO-s nga Nicolas Sarkozy, historia e rivalitetit institucional vazhdon të pengojë bashkëpunimin e ngushtë SHBA-BE. Ky është rasti si brenda qeverisë së SHBA-së si edhe i BE-së. Një delegacion i Shtabit Ushtarak të BE-së mori pjesë në Eksperimentin Shumëkombësh-5 të sponsorizuar nga Komanda e Forcës së Bashkuar të SHBA-së (JFC), po shumë prej zyrtarëve ushtarakë të SHBA-së ende këmbëngulin në mendësinë 'NATO e para', e cila, megjithëse mund të jetë zbehur për shkak të frustrimeve ushtarake të SHBA-së me rolin e NATO-s në Afganistan, ende përkthehet në një ngurrim për të intensifikuar bashkëpunimin SHBA-BE.

Ngjarjet e jashtme, veçanërisht në Afrikën e Jugut, e kanë kthyer SHBA-në në aleatët tradicionalë ose edhe në një politikë "e të vepruarit të vetëm". Ndonëse një numër qeverish evropiane kanë mbështetur diplomatët në burokracinë e SHBA, Britania ka deri tani numrin më të madh, me ekspertë të vendosur në zyrat funksionale dhe rajonale të Departamentit të Shtetit, po ashtu edhe në Pentagon. Kur gjenerali David Petraeus filloi të rishikojë misionin CENTCOM, ai ftoi pothuajse njëzetë diplomatë britanikë dhe zyrtarë për t'iu bashkuar skuadrës së tij të Vlerësimit të Përbashkët Strategjik. Asnjë qeverie evropiane nuk iu dha kjo ofertë, përveç Sekretariatit të Këshillit ose Komisionit Evropian. Marrëveshja midis Sekretariatit të Këshillit të BE-së dhe Koordinatorit për Stabilizim dhe Rindërtim për të shkëmbyer zyrtarët e stafit ishte bërë e padobishme.

Megjithatë, për bashkëpunimin e pakët SHBA-BE nuk mund të fajësohet vetëm SHBA-ja. Mungesa e angazhimit evropian për proceset e BE-së luan, gjithashtu, një rol të rëndësishëm. Shumica e qeverive të BE-së janë të lumtura të shkojnë drejt një roli më të madh të BE-së në politikën e konfliktit në përgjithësi, dhe presidentat e njëpasnjëshme të BE-së kanë rënë dakord me dokumente dhe deklarata përkatëse. Por kur bëhet fjalë për fusha specifike të politikës, po të njëjtat qeveri të BE-së preferojnë shpesh të mbajnë një lidhje kombëtare me politikën, ose e përdorin BE-në vetëm kur është e përshtatshme.¹¹² Qeveritë evropiane duket se janë të paafta të kenë diskutime reale strategjike mbi çështjet si Rusia, Kina, ose Lindja e Mesme brenda kontekstit të BE-së. Nëse qeveritë e BE-së nuk mund të bien dakord mes tyre, ka pak shpresë për bashkëpunimin SHBA-BE.

Bashkëpunimi ndërmjet SHBA-së dhe BE-së, më tepër sesa ndërmjet SHBA-së dhe qeverive individuale evropiane, është penguar edhe prej një numri pengesash teknike. Deri më sot nuk ekziston asnjë metodë për të ndarë dokumente të rëndësishëm në ndonjë gjë tjetër, përveç takimeve ballë-përballë dhe përmes një zarfi të mbyllur. Megjithëse tani ka një qëllim për të ndarë me homologët e SHBA-së produktet analitike të ndërlydhura së bashku me Qendrën Situacionale të BE-së për politikë-bërësit e BE-së, asnjë burim material themelor mund të ndahet. Për arsye të dukshme, kjo pengon bashkëpunimin. Së fundmi, detyrimi për të zhvilluar analiza dhe strategji të përbashkëta pengohet nga natyra e procesit të bashkë-agjencimit të SHBA-së dhe pengesat e vendim-marrjes së BE-së. Të dyja palët mbërrijnë në takime me një sërë qëndrimesh politike, tashmë të negociuara, ndryshimi i të cilave duket shumë i vështirë.

Një Axhendë e Re

Nëse bashkëpunimi SHBA-BE duhet të përmirësohet, do të kërkojen ndryshime në një numër nivelesh, duke përfshirë politikën, proceset dhe institucionet. Nga të gjitha këto, ndryshimi institucional mund të jetë më i lehtë. Institucionet nuk krijojnë një strategji të përbashkët për shkak të ekzistencës së tyre. Por një strukturë koherente institucionale mund të ndihmonte për bashkëpunimin.

¹¹² Charles Grant dhe Mark Leonard, 'What New Transatlantic Institutions?', Buletini 41, Londër, CER, Prill/Maj 2005, fq. 2.

Me ratifikimin e Traktatit të Lisbonës, institucionet e reja të BE-së – Presidenti i përhershëm i BE-së, “Ministri i ri i Jashtëm” i BE-së dhe shërbimi evropian i veprimit të jashtëm (trup i diplomatik) – mund të krijojnë një strukturë për një bashkëpunim evropian më të madh, një kusht paraprak për përmirësimin e diskutimeve SHBA-BE. Por kjo mund të lehtësojë edhe lidhjet më direkte me SHBA-në. Traktati i Lisbonës siguron një bashkëbisedues më të fortë evropian në formën e “Përfaqësuesit të Lartë”, të cilit i jepet pushtet për të koordinuar politikën e jashtme të BE-së. Sekretari Amerikan i Shtetit dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së duhet të zhvillojnë një plan të konsultimeve të rregullta që, të paktën një prej tyre, duhet t’i dedikohet konflikteve të reja dhe misioneve të pas-konfliktit.

“Përfaqësuesi i Lartë” duhet të mbështetet gjithashtu edhe nga një trup diplomatik evropian, Shërbimi i Veprimit të Jashtëm, që do të bashkojë delegacionet e ardhshme të BE-së. Deri sa delegacioni i KE-së në SHBA është riformuar në një mision më të gjerë të BE-së, është e logjikshme të krijohet një element i stafit, i dedikuar ndaj bashkëpunimit ndërmjet SHBA-së dhe BE-së në vlerësimin e konflikteve të reja dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta. Sipas kreut të misionit, një zëvendës ambasador i BE-së mund të caktohet me detyrën specifike që të mbajë lidhjen mes institucioneve të SHBA-së dhe BE-së në çështjet e konfliktit.

Në një numër vendesh me rrezik destabilizimi, emërimi i një të dërguari të lartë të BE-së, që përfaqëson Sekretariatit e Këshillit dhe KE-në, ofron një mundësi për të replikuar bashkëpunimin ndërmjet SHBA dhe BE, që ekziston së fundmi në Maqedoni dhe në Bosnje-Hercegovinë. Do të ishte e vlefshme identifikimi i dhjetë vendeve që kanë rrezik destabilizimi, ndërkohë që konsultimet mund të zënë vend si në nivel vendor edhe në nivelin e Direktorisë Politike, të alternuar në Bruksel dhe Uashington.

Gjithashtu, marrëveshjet duhen parë në një kuadër të përbashkët strategjik për misionet civile/ushtarake të ndërtimit të shtetit. Mungesa e një kuadri të tillë ka qenë e dukshme veçanërisht në Afganistan, ku ushtria evropiane u caktua si pjesë e një misioni paqeruajtës të miratuar dhe udhëhequr nga NATO (e kufizuar fillimisht në Kabul, nga këmbëngulja e SHBA-së), ndërsa amerikanët ishin duke luftuar ende një luftë kundër-terrorizmit (që tani është shndërruar në kundër-rebelim). Kjo ishte më pak e dukshme në Kosovë, ku shtylla kryesore - edhe pse çalon në një numër aspektesh – i dha të gjithë të interesuarve një sens të qartë të drejtimit strategjik.

Nga një anë, kjo është e kuptueshme – as SHBA-ja, as BE-ja nuk kanë adoptuar formalisht një kuadër strategjik për një mision të stabilizimit dhe rindërtimit – dhe, në anën tjetër, është tërësisht e pakuptueshme: si presim ne të jemi në gjendje të punojmë efektivisht së bashku për qëllime të përbashkëta, pa përcaktuar se cili është qëllimi i dëshiruar i shteteve? Uniteti i drejtimit – e dëshiruar në shumë raste – zakonisht nuk arrihet: SHBA-ja nuk do të vendosë gjerësisht trupat e saj nën ndonjë komandë tjetër civile që nuk është e saja, dhe evropianët shpesh nuk janë të gatshëm për të vendosur civilët e tyre nën një komandë ushtarake. Uniteti i qëllimit është më e mira e mundshme që ne mund të arrijmë, por ne nuk e kemi përkufizuar saktë domethënien e saj. Një grup pune i përbashkët BE/SHBA duhet të ndërmarrë detyrën e përcaktimit të parimeve ndër-sektoriale dhe gjerësisht të aplikueshme, për qëllimin e shteteve që përcaktojnë një kuadër të përbashkët strategjik.

Ky proces nuk do të jetë as i lehtë dhe as i qetë. SHBA-ja ka kohë mjaftueshëm për krijimin dhe mbështetjen e operacioneve të saj ndërinstitucionale – gjerësisht për shkak të konkurrimit ndërinstitucional, kulturave të ndryshme dhe mungesës së vullnetit politik – që bën zhvillimin e një përqsaje të re transatlantike të “gjithë qeverisë” të duket i frikshëm, veçanërisht sepse evropianët kanë “një përqsaje të ndryshme Evropiane për politikën e jashtme dhe të sigurisë”, që mund të duket ndonjëherë e ndryshme nga një përqsaje amerikane.¹¹³ Ndonëse sfiduese, marrëveshjet mbi arritjen e një kuadri strategjik nuk janë jashtë mundësisë: në Institutin e Paqes së SHBA-së *Guiding Principles for Stabilization and Reconstruction* theksohet se ka një sistem të mirë të marrëveshjes mbi qëllimin e shteteve.¹¹⁴ Synimi i shteteve, i theksuar këtu, është skicuar nga një rishikim gjithëpërfshirës i shumicës së dokumenteve strategjike të politikave nga ministritë e mbrojtjes, të çështjeve të jashtme dhe të zhvillimit, amerikane dhe evropiane, dhe nga organizata ndër-qeveritare dhe jo-qeveritare. Kështu që ato nuk përfaqësojnë as një përqsaje strikte amerikane, as një përqsaje strikte evropiane, por janë të përbashkëta në të dyja. Nëse Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s do të adaptojë një set të ngjashëm për synimin e shteteve

¹¹³ Këshilli Evropian, ‘Report on the Implementation of the European Security Strategy: Providing Security in a Changing World’, Bruksel.

¹¹⁴ Instituti i Paqes së SHBA, ‘Guiding Principles for Stabilization and Reconstruction’, Uashington, DC: Endowment of the United States Instituti i Paqes, 2009.

për stabilizimin dhe rindërtimin, kjo do të lehtësojë ndjeshëm tensionet në trekëndëshin NATO/BE/SHBA.

Gjithashtu SHBA-ja dhe BE-ja duhet të marrin në konsideratë krijimin e një Task Force të Parandalimit të Konfliktit, me një sekretariat të përhershëm, të vogël të vendosur në Bruksel, që do të koordinojë shërbimin inteligjent për zhvillimin e konflikteve, të prodhojë analiza të përbashkëta dhe të propozojë strategji të zbutjes së konfliktit për diskutim nga liderët e SHBA-së dhe evropianë. Nëse në marrëdhëniet NATO-BE do të ketë progres, atëherë do të mund të ngrihet një Shkollë për Konfliktin, Pas-Konfliktin dhe Stabilizimin NATO/BE, për të siguruar trajnimin për zyrtarët e vendosur – një lloj Harvard-i për ndërtuesit e shteteve që veprojnë në zonat e luftës. Instituti i SHBA-së për Paqen, ZiF-i Gjerman, Instituti Clingendael i Hollandës dhe të tjerë mund të listohen për të siguruar kurse të përshtatshme dhe të realizojnë trajnime që sigurojnë bashkëpunimin SHBA/BE.

Një institucion i tretë potencialisht i dobishëm do të ishte një Qendër Diplomatike SHBA-BE në Uashington, bazuar në modelin e Fondit Gjerman Marshall, që mund të sjellë diplomatët e SHBA dhe evropianë së bashku në kurse, seminare, dhe programe trajnuese po ashtu edhe të lehtësojë transferimet ndërmjet shërbimeve të ndryshme të huaja. Si pjesë e kësaj, mund të ngrihet një “Shoqëri Marshall-Monnet” për të rinjtë e SHBA-së dhe zyrtarët evropianë nga Komisioni Evropian, Sekretariati i Këshillit, Parlamenti Evropian dhe qeveritë e BE-së, që bazohet në një program që përfshin një *retreat* vjetor, një kurs dhe një tjetër të ngjashëm gjashtë mujor, dhe kurse pune. Një pjesë e rëndësishme e fokusit që duhet të ndjekë Qendra Diplomatike SHBA-BE dhe partnerët e saj, është të trajtuarit të krizave dhe konfliktet. Në lidhje me këtë, SHBA-ja dhe BE-ja mund të ndërmarrë një rekrutim dhe trajnim specifik të 100 planifikuesve civilë, përmes ofrimit të kurseve në vendet e SHBA-së dhe BE-së dhe përvojave në planifikimin ushtarak.

Skepticizmi i vazhdueshëm i SHBA-së për dobishmërinë e bashkëpunimit transatlantik mund të tejkalohet vetëm përmes përmirësimit të kapacitetit dhe efektshmërisë së BE-së. Të punuarit me BE-në vështirë të cilësohet prioritet për administratën e re të SHBA-së, deri sa BE-ja të ofrojë mbështetje në fushat që janë të rëndësishme për SHBA-në, ose të shpenzojë para dhe të dërgojë më tepër ekspertë në vendet botërore që janë në konflikt. Situata në Azinë Jugore ka gjasa të mbetet një prioritet për sigurinë kombëtare të SHBA-së, për dekadën e ardhshme. Për të avancuar më tej

bashkëpunimin SHBA-BE, do të jetë thelbësore një angazhim më i madh Evropian në këto dy vende.

Ministritë e brendshme në Pakistan dhe Afganistan janë të një rëndësie të veçantë. Ka një arsye të fortë që Evropa të luajë një rol primar në zhvillimin e institucioneve civile që i japin drejtim strategjik policisë dhe forcave të tjera të brendshme të sigurisë, ndonëse shumica e pengon ndarjen e punës si në Uashington, ashtu dhe në Bruksel. BE-ja duhet të konsultohet me SHBA-në për skicimin e një trupe asistence në Ministrinë e Brendshme të Pakistanit, ndërsa në të njëjtën kohë SHBA-ja konsultohet me BE-në mbi çfarë është bërë me Ministrinë e Brendshme Afgane. Ky lloj ndërveprimi do të ndihmojë të ngrihen të drejtat e njeriut dhe standardet e tjera në të dyja ministritë paralelisht, me zgjerimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes civile.

Së fundi, SHBA-ja dhe BE-ja duhet të zhvillojnë një axhendë të qartë për parandalimin e konfliktit dhe menaxhimin e krizës brenda OKB-së.¹¹⁵ Në disa prej rajoneve të paqëndrueshme të botës, nuk do të jenë vetë ushtarët e SHBA-së ose diplomatët evropianë ata që do të thyejnë armëpushimet, zonat e demilitarizuara të policisë ose dhe stafin e misioneve të rindërtimit të pas-konfliktit (edhe pse SHBA-ja dhe BE-ja do të vazhdojnë njësoj të marrin përsipër kostot). Barra do t'i bjerë kryesisht OKB-së, e cila në këmbim do të mbështetet nga kontributet në Azi dhe Afrikë. Kjo e bën më të rëndësishme për SHBA-në dhe BE-në që t'i bashkojnë forcat si në ndërtimin e OKB-së, ashtu edhe në zhvillimin e kapacitetit botëror, ndërsa bien dakord për qasje të përbashkëta aty ku ka më tepër mundësi të ndodhë konflikti, veçanërisht në Afrikën sub-Sahariane.

Duke marrë parasysh uljet dhe ngritjet e marrëdhënieve të sigurisë SHBA-BE, duke përfshirë mosmarrëveshjet mbi konfliktet si në Luftën e Bosnjës në mes të viteve 1990 dhe pushtimin e Irakut të udhëhequr nga SHBA-ja në 2003, ka pasur një rritje të dëshirës nga të dyja palët për një bashkëpunim më të madh praktik mbi parandalimin e konfliktit dhe menaxhimin e krizës jo vetëm brenda një strukture të NATO-s, por edhe në mënyrë direkte midis SHBA-së dhe Bashkimit Evropian (BE). BE-ja dhe SHBA-ja, në mundësinë që i ofrohet nga pesëmbëdhjetë vjetori i Axhendës së Re Transatlantike në mes të 2010, duhet të formojnë një axhendë të

¹¹⁵ Simona Lipstaite, 'EU-US Cooperation in International Peace and Security: Bilateral versus Multilateral Dialogues', Bruges Regional Integration & Global Governance Papers 2/2009.

re bashkëpunuese me fokus parësor mbi parandalimin e konfliktit dhe bërjen e kapaciteteve të tyre përkatëse për stabilizimin “gjithëpërfshirës”, si dhe misionet e rindërtimit që ndërveprojnë dhe mbështeten reciprokisht.

Daniel Korski është hartues politikash tek European Council on Foreign Relations, Daniel Serwer është Zv-President i Centers of peacebuilding innovation dhe Megan Chabalowski is studiese tek United States Institute of Peace.

SUMMARY

NATO's NEW STRATEGIC CONCEPT: A view from the Western Balkans

Under the framework of the Regional Conference on “**NATO's NEW STRATEGIC CONCEPT A view from the Western Balkans**”, the Institute for Democracy and Mediation (IDM) in cooperation with its regional partners in the Western Balkans – Center for Security Studies (Sarajevo), Analytica (Skopje), Kosovar Center for Security Studies (Prishtina), CEDEM (Podgorica), Croatian Atlantic Council (Zagreb) and Atlantic Council of Serbia (Belgrade) – carried out a series of mini-surveys with approximately 233 respondents. The survey sample includes eminent representatives of media, academic and civil society, decision / policy – makers, business sector, governmental and independents experts and practitioners who are familiar with or involved in the public and specialized debate on NATO's transformation challenges and the new Security Concept. The survey has been carried out in all seven countries in the period January – February 2010 with an average of 30 – 40 respondents in each country. Given the chosen sample, the survey data may be interpreted as indicative only for a general population of opinion makers, civic and academic society, policy and decision makers.

Jean Jacques de Dardiel

Whither the Euro-Atlantic Partnership: Partnership and NATO's New Strategic Concept

In July 2009, NATO launched a process which should lead to the adoption of a new Strategic Concept. In defining its future referential framework, the Alliance will no doubt dwell on contemporary trends, such as the ever fastening globalisation of international relations and the widening spectrum of threats. In taking such evolutions into account, it would do well in vying for additional flexibility and pragmatism, instead of trying to define a rigid framework of action that would rapidly become obsolete as unforeseen events will constantly call for redirections. The Alliance should fully develop its comprehensive approach so as to interact coherently with international organisations, partner states and civil society. Only thus will it muster wide support for its operations and set up the preconditions for viable exit strategies. In doing so, NATO could build on the assets developed through the Partnership for Peace and its institutional and political framework, the Euro Atlantic Partnership Council. Indeed, EAPC partner nations can contribute a variety of means to secure peace, security and post conflict reconstruction, whose usefulness, not to be measured in terms of military assets alone, should grow as international security challenges take on ever more varied forms. Hence NATO should not dilute a tried and successful PfP/EAPC construct in bundling up all other countries associated in one way or the other with NATO's workings and operations into a one tutti-frutti new Partnership Forum. Instead, NATO should differentiate between different types of partners, all the while focusing more closely on the added value and underestimated opportunities of partnership. Indeed, partnerships should be at the core of NATO's ambitions, and not only be seen as a somewhat burdensome and ambiguous sideshow.

Florence Gaub

NATO: Peacekeeping in the Holy Land? A feasibility study

This paper provides an analysis of the implications for a possible NATO stabilization force in Palestine. Although the idea is attractive to some who would like to prove NATO's global peace-enforcing capacity, the chances are that this endeavour

would turn bad and tarnish NATO's image in more ways than one. Thus, this paper attempts to shed light on the operational feasibility (not to say dangers) of such a mission, and whether it can be accomplished with a reasonable timeframe, and comes to a negative conclusion. On the assumption that success would be the only option if NATO wants to get involved in the resolution of a conflict that is older than itself, the analysis focuses on the operational rather than political feasibility. The reason for this is not disregard for the political aspects which are obviously crucial: the purpose of this paper is an operational one, and there are already numerous publications covering the political framework of peace in the Middle East. In any case, this mission would need thorough preparation, careful planning, sufficient staffing and planning, a significant amount of political will, and would leave a very narrow margin for success.

Trine Flockhart

NATO and the (Re) Constitution of roles:

“Self”, “We” and the “Other”

The popular perception of the role of NATO was famously defined by NATO's first Secretary General, Lord Ismay, as “keeping the Russians out, the Americans in and the Germans down”. NATO's role is still essentially to keep its members safe from threats to ensure the cohesion of the transatlantic relationship, and to transform relations between former foes. However, behind this alluringly simple description of NATO, lie complex “self”, “we” and “other” definitions and perceptions of roles and relevant functional tasks. This paper seeks to unravel some of the complex processes of constituting and re-constituting NATO's roles. By utilizing a combination of role theory and social identity theory the paper traces how NATO has been engaged in complex and simultaneous processes of having a role set defined for it, whilst also being deeply involved in constructing its own identity and the identity of its member states, prospective member states and partners.

Thomas Renard & Sven Biscop
A Need for Strategy in a Multipolar World:
Recommendations to the EU after Lisbon

This paper analysis the impact of the Lisbon Treaty in the foreign policy of the European Union. In a world that is increasingly complex and multipolar, the EU must act strategically. The main argument of the paper is that in order to avoid becoming an irrelevant international actor, Brussels needs to (1) develop a grand strategy to define the true purpose of its foreign policy; (2) forge solid strategic partnerships with key global players; and (3) contribute to the building of a new effective multilateral system which takes into account the new global structure of power.

This strategy will inevitably be conditioned by the global environment (interpolarity) but it should not be entirely dependent upon that environment, i.e. the strategy should aim at shaping the global environment as much as it will be shaped by it and avoid the trap of mere reactivity which has defined EU foreign policy so far. In the words of Brigadier-General (Ret.) Jo Coelmont, “while the EU is playing ping pong, the others are playing chess”. With Van Rompuy and Ashton, Europe was offered a new King and a new Queen. So let’s play chess!

Can Buharalý, EDAM
Better NATO-EU relations require more sincerity

Following an agreement on a new NATO Strategic Concept, the EU needs to take compatible steps. A number of practical arrangements need to be put in place in such a way as to embrace all non-EU European Allies. The renewed arrangements need a new and open mindset. The artificial distinction between participation in military and civilian operations for instance need to come to an end. Consultation mechanisms for non-EU Allies must be genuine. Obviously, the decision-making will lie with the EU. But its authority cannot be undermined by listening to other allies and trying to accommodating their concerns. This is particularly relevant if the ally in question is a candidate to the EU with a vision for shared security that has endured over 50 years.

The process of reviewing NATO’s Strategic Concept in 2010 and the process of consultations will be an opportunity for the parties to agree on a number of principles for the future of the

European security environment. The EU reviewed its Security Strategy at the end of 2008 through the implementation report. If the two institutions genuinely consider working closer with each other, the NATO Strategic Concept and the European Security Strategy need to complement one another. 21 EU members are able to voice their concerns during NATO Strategic Concept negotiations. In the same vein, and with the requisite political will, they should be able to further review the European Security Strategy taking into account the new NATO Strategic concept. Therefore, the review of the NATO Strategic Concept offers a unique opportunity for the parties to bridge their differences.

Daniel Korski, Daniel Serwer dhe Megan Chabalowski A New Agenda for US-EU Security Cooperation

Post-Cold War, the world has seen a shift from inter-state tension and conflict to intra-state concerns, ethnic and sectarian strife, civil wars, weak and failed states, warlordism and terrorist havens. Military intervention to resolve these problems is a blunt and expensive tool, one that can cause significant collateral damage and may not address the conflict's underlying causes. This paper traces the development of US and EU capabilities, the history of transatlantic cooperation, the continuing problems and obstacles and what a more robust future agenda might look like. The EU and US ought to shape a new cooperative agenda with a primary focus on conflict prevention and making their respective capacities for 'comprehensive' stabilization and reconstruction missions interoperable and mutually supportive.

There have been ups and downs of the US-European security relationship, including stark disagreements over conflicts such as the Bosnian War in the mid-1990s and the US-led invasion of Iraq in 2003, there has been growing desire on both sides for more practical collaboration on conflict prevention and crisis management not only within a NATO framework, but also directly between the US and the European Union (EU). If the NATO Strategic Concept were to adopt a similar set of end states for stabilization and reconstruction, it would significantly ease tensions around the NATO/EU/US triangle. Yet despite positive experiences of US-EU cooperation in the field, in many of the world's hotspots and in the countries most at risk of instability, it remains at best mechanical and episodic.

In a number of unstable regions, close US-EU cooperation could bring benefits that similar cooperation inside NATO or

bilateral links alone will not. Thus, the EU could probably play a role in such regions through close partnership with the large US engagement. A greater European commitment in these hotspots will be crucial to advance broader US-EU cooperation.

This paper analyses some of the reasons why US and EU cooperation has not developed further such as: the residual 'NATO-first' mentality within the US military and the differentiated view on Common Foreign and Security Policy (CSFP). When cooperation does take place, US and EU activities are often coordinated rather than part of a genuinely joined-up effort.

If US-EU cooperation is to improve, changes will be required at a number of levels, including of policy, process and institutions. Of these, the institutional change may be the easiest. A coherent institutional structure for cooperation could help. On the other hand, the Lisbon Treaty provides for a stronger European interlocutor in the shape of the 'High Representative', who is given power to coordinate EU foreign policy. Unity of purpose is the best we are going to get, but we have not been adept at spelling out what it means. A joint EU/US working group should undertake the task of defining widely applicable end states and cross-cutting principles that constitute a common strategic framework.

The US and EU should also consider creating a US-EU Conflict Prevention Task Force, that would produce joint analyses and propose conflict-mitigating strategies for discussion by US and European leaders. Unity of command – clearly desirable in many instances – is usually unachievable: the US will not generally put its troops under any civilian command other than its own, and Europeans are often unwilling to put their civilians NATO/EU School for Conflict, Post-Conflict and Stabilization could be set up to provide training for deploying officials. Another potentially useful institution would be a US-EU Diplomatic Centre in Washington, on the model of the German Marshall Fund, which could bring US and European diplomats together on courses, workshops, and training programmes as well as facilitating secondments between the different foreign services. Finally, the US and the EU need to develop a clear agenda for conflict prevention and crisis management. While continued US skepticism of the utility of transatlantic collaboration can only be overcome by improving EU capacity and effectiveness.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE EUROPIANE DHE TË SIGURISË - 15

Formati: 15.5x24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 22 40 116
Tiranë, 2010